

BIBLIOTEKA
SHTETIT

814-34

T 88

NESHAT
TOZAJ

TAKIMI I FUNDIT

NOVELË



8JH-32

T88

NESHAT TOZAJ

TAKIMI I FUNDIT

Novelë



313.1

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

Vetura ndaloi përpara godinës dhjetëkatëshe të institutit. Përkthyesi, Georgi, që e ngiste vetë makinën, zbriti dhe përplasi me forcë derën. Kur po matej ta mbyllte me çelës, iu kujtua çanta që e kishte lënë mbi ndenjësë. Ndërkaq nga dyert anësore zbritën Mistoja dhe Iliri. Ata tani ishin më të shpenguar; kishin hyrë në muajin e dytë të kursit të kualifikimit në këtë institut të huaj dhe deri diku ishin njohur me qytetin, ose, siç thoshte Iliri, me fasadën.

Në orën tre ngjitën shkallët pa këmbyer asnjë fjalë. Georgi u hoq pak mënjanë dhe portieri, një plak simpatik që i xixëllonin sytë kur thoshte «Albania», u hodhi një sy kalimthi fletëhyrjeve. Dy muaj kishin mjaftuar që ata të njiheshin me të. Iliri, me atë shikimin e thellë, në sytë e tij lexonte vazhdimisht edhe ndjenjën e frikës. Portieri i trembej veçanërisht Georgit. Këtë gjë Iliri e kishte vënë re mirë; madje ai dinte edhe shkakun: në ditën e dytë të punës në institut Georgi kishte nxjerrë, fare pa dashur, në vend të fletëhyrjes, një dokument tjetër, në fotografinë e të cilit ai kishte dalë me uniformë ushtarake. Në fillim Iliri e kishte simpatizuar Georgin dyzetyjçar për shtatin mbi mesataren e tërë energji, për flokët tepër të thinjur për moshën, për fytyrën shumë shprehëse e, veçanërisht, për njo-

huritë e tij. S'kishte fushë shkence ku Georgi të mos e thoshte fjalën e vet. Ai dinte mjaft gjëra edhe për makinat llogaritëse elektronike, për të cilat po specializoheshin «dy kolegët shqiptarë», siç i quante ai. Që kur pa atë fletëhyrjen, Iliri ishte tepër i ftohtë në bisedat me të. Edhe Mistoja, i sinjalizuar për këtë fakt, qe frenuar mjaft.

Ata hynë në ashensor dhe Georgi shtypi butonin për në katin e shtatë.

— Drejtori i institutit na pret më tetë, — tha ai dhe i hodhi sytë orës së tij të shtrenjtë.

— Do të jeni dhe ju?! — e pyeti Mistoja thjesht për mirësjellje.

— Jo ... më është bërë zakon të flas në shumë. ... kam disa punë të tjera. Veç kësaj, drejtori e ka zët të ketë të tjerë. ... Ju mund të bisedoni me të frëngjisht, — dhe buzëqeshi.

Ndërkaq sinjali i katit të shtatë qe ndezur dhe ashensori u ndal.

— Punë të mbarë! — uroi Georgi dhe iku në drejtim të kundërt me ta.

Ata të dy i shoqëroi për në kabinet sekretarja e drejtorit, një mesogrua me fustan të shkurtër, e lyer tej mase. Kabineti ishte i gjerë, gjithë dritë. Në fund, në një tryezë të madhe rrinte drejtori. Ai dukej mjaft i vogël në gjithë atë tryezë. Sa i pa të porsaardhurit, u ngrit më këmbë dhe u nis në drejtim të tyre me një hap tepër energjik.

— Hajdeni, djema, hajdeni, — tha ai duke u shtrënguar duart fort.

Iliri, duke ndezur cigaren që i dha ai, pasi qenë rehatuar në kolltukë, nuk ia shqiste sytë. Ja, pra, kush ishte autori i atyre punimeve shkencore me aq vlerë në fushën e aplikimit të matematikës në

ekonomi. Një njeri që në dukje nuk ta mbushte syrin.

Ndërkohë Georgi që kthyer nga rruga dhe ishte futur në një zyrë, pranë asaj të drejtorit. I kyçur nga brenda, me kufjet në vesh, ndiqte me interes bisedën e drejtorit me dy shqiptarët dhe e regjistronte atë në një magnetofon të vogël portativ, që sapo e kishte nxjerrë nga çanta.

— ... E njihni Pëllumb Ferrën? — dëgjohej zëri në kufje.

— Po, e kemi pasur profesor. Po ju si e njihni?

— Kemi studjuar bashkë në Moskë. Ka qenë student i shkëlqyer.

Një çast u bë pushim. Georgi priste me ankth. Ky drejtor duhej hequr prej kohësh që andej. Bindjet politike të tij ishin të kundërta dhe ai i thoshte krejt hapur. Por, edhe pse ishte «jashtë», këtë ia dedikonte famës së tij si shkencëtar. Kështu që, çdo veprim me të ishte pezulluar. Por Georgi mbledhte prova, prandaj nuk hyri me dy të huajt në zyrë. Ai e dinte mirë dobësinë e profesorit për shqiptarët. Buzëqeshi pak dhe mendoi: vërtet që nuk hyra, por ama jam plotësisht i pranishëm në bisedën e tyre. Dhe zgjati dorën për të mbushur me uiski gotën e sapozbrazur, por ndërkaq u dëgjua zëri i drejtorit:

— Ajo që më tërhiqte më shumë te Pëllumbi nuk ishin aq aftësitë intelektuale, sesa patriotizmi i flaktë dhe vlerat e tij si njeri. Me se merret tani?

— Punon në Akademinë e Shkencave...

Georgi ndezi një cigare. «Akademi! Ka gjithë bota akademi, kanë dhe këta!». Por ajo notë mos-përfilljeje u zhduk sakaq, kur iu kujtuan të dhënat që kishte mbledhur nga bashkëpunëtorët shkencorë

të institutit. «Hëm, edhe keq nuk duhet të jenë. Jo, veçanërisht për këtë Ilirin ata kanë mendim shumë të mirë, megjithëse në fillim të jepte përshtypjen se ishte leshko. Veçse është tepër fanatik, gati i papërpunueshëm: as raki, as cigare, as femra. Asket i vërtetë. Më ndryshe është ky Mistoja, më impulsiv, veçse duket ca i paaftë. Me të, në të vërtetë, diç mund të bëhet, por këtyre kolegëve të mi thuajse u mungon fare guximi.»

Biseda e tyre qe e gjatë, dhe shiritat e magnetofonit ishin mbushur nga të dyja anët. Prapa mbeti vetëm shishja e boshatisur e uiskit dhe tavlla e mbushur plot me bishta cigaresh.

2.

Georgi u ul në karrigen afër shefit dhe ndezi cigaren. Pas përshëndetjeve të para në dhomë ra heshtja. Ai shikonte nga dritarja jashtë, por mendjen e kishte te shefi i tij; kishte një armiqësi të heshtur midis tyre. Shefi ishte më i ri në moshë dhe në specialitetin e zbuluesit nuk kishte shkëlqyer. Kishte ardhur aty drejt nga puna me rininë. Edhe niveli i tij intelektual ishte i ulët. «Është tepër ordiner, — thoshte me vete Georgi, por nuk guxonte ta diskutonte këtë as me shokun më të ngushtë. Ku i dihej? Fundja, ç'punë i prishte shefi? Atij ia kishin nevojën, dhe kjo mjaftonte. Paratë?! Eh, le të marrë ai më shumë, unë di t'i nxjerr ato edhe nga guri. Kjo më mjafton».

Edhe shefi nuk e shikonte dot Georgin. I dukej se ai e përbuzte tej masës, jo drejtpërdrejt, por me dy fakultetet që kishte kryer dhe me katër gjuhët

që dinte. Ai kishte bredhur gjithë botën, dhe shefat më të lartë e kishin me sy të mirë. Për çdo punë të rëndësishme, me gjithë përpjekjet e tij për ta errësuar, ata kërkonin Georgin.

— Pa hë, le ta dëgjojmë, po jo të gjithë, — tha shefi disi me përbuzje.

Georgit i erdhi plasja, megjithatë ai e nxori magnetofonin. Në mes të shiritave ishin ngjitur disa copa letrash me numra.

— I kam seleksionuar, — tha ai, dhe shkeli butonin.

Biseda jepej me altoparlant. Dera që mbyllur, dhe veshja speciale e mureve dhe e derës pengonin daljen e zërit. Nisi fragmenti i parë i bisedës:

Mistoja: E lirë është jeta këtu. Kanë përvojë dhe fuqi ekonomike të madhe.

Iliri: Ashtu të duket. Ne kemi dietë të lartë, po punëtori nuk mund ta përballojë jetesën. Kjo është thjesht propagandë. Ti mos harro huat që kanë marrë, mos harro ngritjet e çmimeve...

Mistoja: Ndoshta, por ama duket që standarti i jetesës është i lartë.

Iliri: Kjo është një botë në rënie, ti mos shiko anë të veçanta. Këtu mund të të hyjë shumë në punë mesatarja e thjeshtë aritmetike...

Georgi shtypi butonin. Pastaj ai solli një bisedë tjetër.

Mistoja: Mjaft studjove, hajde të dalim tani.

Iliri: Jo, është ende shpejt. Do të dalim në orën tetë. Kështu e lamë me fjalë.

Mistoja: Unë nuk rri dot më, s'më zë vendi. Më ka marrë malli për gruan.

Iliri: Edhe mua. Por këtu kemi ardhur të mësojmë. Veç kësaj, duhet përfituar sa më shumë. Ti

e shikon dhe vetë që herë pas here na nxjerrin pengesa: Filan bashkëpunëtor shkon me shërbim, tjetrit i sëmuret nëna, dikush shtrohet në spital. Dhe këto ndodhin kur ata duhet të punojnë me ne.

Mistoja: Ama, e kolme ajo vogëlushja, Eva. Si të duket ty?

Heshtje.

— Hë pra, si të duket?

Iliri: Si dhelpër pa bisht më duket. Lërmë të studjoj, dreqi e mori, dhe kontrolloje mirë veten!

Mistoja: Ti mbete tërë jetën peshkop. Mirë ta kishin ngjitur këtë emër në universitet. Për ty asgjë nuk ekziston në këtë botë, veç librave.

Iliri: Edhe mua më pëlqen e bukura, edhe unë kam zemër, por nuk jargavitem si ti. Le ta lëmë këtë bisedë dhe po ta përsëris: kontrolloje mirë veten.

Mistoja: Mjaft më bëre moral. Studjo. Unë po zbres të pi një kafe.

Iliri: Jo, do të zbresim bashkë.

Georgi shtypi përsëri butonin. Pastaj shiriti xhiro i me shpejtësi, dhe shefi, që e ndiqte me kujdes, kur pa që kaloi një nga ato shenjat prej letre, tha:

— Kalove një bisedë.

— Nuk është gjë, — u ngut Georgi dhe ndërkaq u skuq lehtë e iu drodh dora. Ai e kishte fshirë atë fragment bisede, në të cilën Iliri e porosiste Miston të sillej më me kujdes me Georgin... Georgi që trembur për vdekje. Po ku dreqin ta linte fletëhyrjen për në drejtori! Atij i telefononin shpesh dhe e kërkonin në zyrë. Por shyqyr që incizimet i bënte vetë, se, ndryshe, do ta pësonte keq.

— Unë mendoj se është koha të veprojmë, — tha shefi, pasi dëgjoi fragmentin e fundit.

— Edhe unë i atij mendimi jam, por, para së gjithash, duhet të vijë nëpunësi ynë nga Shqipëria. Atij i kemi ngarkuar disa detyra.

— Është nisur, — tha shefi thjesht, por në një mënyrë që Georgi të nënkuptonte se ai nuk qe më axhami në punët e zbulimit.

Georgi e kuptoi mirë këtë, por ama ai dhe shefat më të lartë e dinin se propozimin për të sjellë nga Shqipëria punonjësin e tyre, që shërbente aty si atashe shtypi, e kishte bërë pikërisht ai, Georgi. Ishte kjo arsyeja që deklarata e shefit atij iu duk për t'i nxjerrë gjuhën. Georgi nxori paqetën «Arbëria» dhe i zgjati një shefit.

— Shqiptare?, — pyeti ai jo pa interes.

— Po, janë të mira, — tha Georgi dhe ia lëshoi paqetën mbi tavolinë. Ai e mori dhe, si lëvizi kokën në shenjë falenderimi, e futi në xhep. Duke dalë jashtë, Georgi kujtoi atë fjalën e urtë që e thoshte rëndom babai i tij plak, se qylin e ka qejf dhe mbreti, dhe buzëqeshi me përbuzje.

3.

Bashkëpunëtori shkencor pa orën dhe ndërpreu leksionin.

— Do të më lejoni të ha mëngjesin, — tha ai dhe, pa pritur përgjigje, nxori ushqimet nga bufeja në mur.

Ishte e treta ditë që punonin me këtë njeri akull të ftohtë, që dukej më shumë si një mekanizëm. Deri tani ai i kishte futur në disa shtigje që ata i njihnin shumë më mirë se ai dhe, me gjithë vërejtjen me shumë takt që i kishin bërë, vazhdonte me

atë ritëm. Iliri nxori një cigare dhe e ndezi. Sikur i kishte shpeshtuar cigaret këtë periudhë. Por ato duket se e qetësonin, tek e mbyste malli për çdo gur të Shqipërisë.

Mistoja gjeti rastin dhe doli ngadalë për në kabinetin ku punonte Eva. Trupi elegant, sjelljet tepër femërore, ata sytë e saj gjithë zjarr i faniteshin kudo që ndodhej. Herë-herë ai përpiquej ta hiqte mendjen prej saj, por shpesh kjo që e pamundur. Hyri në kabinet gati pa u ndier. Ajo që përkulur mbi mikroskop dhe montonte një mekanizëm të imtë të makinës llogaritëse. Mistoja u ndal një çast dhe po admironte profilin e përgjysmuar të saj. Ajo duket e ndjeu se duart që mbanin mekanizmin, u drodhën, por nuk e ngriti kokën. Ai u kollit për t'i tërhequr vëmendjen dhe u skuq deri te veshët sepse, për dreq, iu kujtua e shoqja.

Eva ngriti kokën dhe, si e zënë në faj, buzëqeshi me çapkënllek.

— Qenkeni ju?

— Po, — u përgjigj Mistoja, që nuk e njohu dot zërin e vet. Vizioni i së shoqes humbi dhe atij i erdhi ajo siguria që i duhej në një rast të tillë.

— Përse u skuqët si vajzë? — e ngacmoi ajo.

— Unë?! — bëri sikur u habit Mistoja.

— Ju më dukeni tepër i ftohtë. Kisha përshtypje tjetër për ju shqiptarët.

— Jeni e gabuar. Ruani përshtypjet që keni pasur!

— Ju bëni një jetë asketi. E dini si më dukeni me atë kolegun tjetër? Tamam si binjakët siamezë. Kur do të veçoheni, më në fund? Koha po kalon.

Mistoja i kërkoi leje të ndizte një cigare. Duke nxjerrë shtëllungat e tymit, ndërkaq e kuptoi se kjo

vajzë, për kokën e vajzës, po i bënte një propozim të hapur. Ai ngurrimi i tij duket se u fut në një zgavër të errët, dhe ai e ndjeu veten të lirë.

— Do mundohem ta shlyej mendimin tuaj të gabuar, — nisi të fliste ai.

— Kur? — pyeti ajo me padurim.

Mistoja vuri re buzët e saj të kuqe e të freskëta dhe atje mbërtheu shikimin për një kohë të gjatë. Ajo e kuptoi dhe buzët iu drodhën lehtë.

— Sot, po qe se keni kohë të lirë, — shqiptoi më në fund ai.

— Atëherë po vij përpara hotelit tuaj në orën shtatë të mbrëmjes. Të tjerat m'i lini mua në dorë.

Ai u nis të ikte dhe, kur hapi derën, ktheu dhe një herë kokën pas. Ajo po e ndiqte me një shikim të ndezur dhe i dërgoi një të puthur me dorë.

4.

Iliri, ashtu kureshtar, për të mësuar gjithçka, edhe atë që s'e kishin në program, nisi të hynte gjithnjë e më shpesh nëpër sallat, me gjithë pengesat që i nxirrnin. Por ai nuk tërhiqej; herë luante rolin e naivit e herë të njeriut tepër kureshtar. Instituti ishte mjaft i madh, megjithatë Iliri krijoi një përshtypje pak a shumë të plotë për punën që bëhej aty. Aty nuk mund të mos vije re tërë atë personel, që në mjaft raste i shikoje të rrinin edhe pa punë, edhe të merreshin me vogëlsira. Për «kolegët shqiptarë», siç i quanin, kishte mendime nga më të ndryshmet. Por Iliri tashmë e kuptonte fare mirë se, herë haptas e herë në mënyrë të fshehtë, ata i shikonin me një farë antipatie e mospërfilljeje.

Iliri i shikonte me ngulm dhe, nga sjelljet dhe qëndrimet e tyre, përpiquej të zbulonte edhe njeriun e vërtetë, njeriun e ndershëm, paçka se mund të ishte i frikësuar. Dhe të tillë kishte ndeshur. Përshtypje të veçantë i kishte bërë një bashkëpunëtor shkençor, Peteri, një burrë tridhjetetë-dyzet vjeç, me trup të lartë e të mbushur, me sy të kaltër, leshverdhe dhe tepër babaxhan, që i shikonte kaq miqësisht, sa që atyre u kishte rënë në sy që në takimin e parë. Peteri ishte me zë në fushën e matematikës së aplikuar dhe ia kishin nevojën por, në të njëjtën kohë, dukej sikur kolegët donin ta pështillnin me një cipë të trashë akulli, që të mos i afroheshe dot. Ilirin diçka e tërhiqte fort drejt këtij njeriu, ndoshta shikimi i tij aq i çiltër, ndoshta dëshira për të shkëmbyer mendime në fushën e specialitetit të tij, për të mësuar diçka të re, të cilën dukej se ai me gjithë qejf dëshironte t'ua jepte.

Një ditë Iliri u ndodh ballë për ballë me Peterin në korridor. U përshëndetën dhe u afruan drejt njëri-tjetrit. Pastaj Peteri i shtrëngoi fort e ngrohësisht duart dhe, duke mos ia lëshuar për një kohë të gjatë, i tha:

— Nuk do të vini në sektorin tim? Keni ç'të mësoni, mua do të më pëlqente shumë. — Ai nuk ia ndau shikimin Ilirit, derisa ky i dha përgjigjen:

— Do të kërkojmë të vijmë, do të dëshironim. Ne interesohemi edhe për sektorin tuaj.

Dhe u ndanë përsëri miqësisht.

Kur Iliri kërkoj të dëgjonin dy ditë leksione tek Peteri, zëvendës drejtori i institutit e pa ftohtë.

— Ah, tek Peteri. Nuk keni ç'të mësoni atje. Ai, më falni, në të vërtetë më tepër fantazon, sesa ka dijëni për specialitetin e tij.

Me gjithë këmbënguljen me mjaft takt të Ilirit, zëvendës drejtori, me ata sy dhelparakë që t'i drejtonte mjaft rrallë kur bisedoje me të, nuk pranoi. Megjithatë Iliri nuk u tërhoq, bisedoi si rastësisht me drejtorin dhe mori aprovimin e tij.

Dhe ja, tani rrinin në një kabinet mjaft të pastër, ku dukej dora e njeriut tepër të kujdesshëm. Peteri qëndronte përballë tyre. Ai i shikonte me radhë herë njërin, herë tjetrin dhe nuk po fillonte dot. Ilirit, tani që po e shikonte për një kohë të gjatë dhe nga afër, se si i dukej ai njeri; kishte diçka në tërë qenien e tij.

Peteri ishte i mallëngjyer. Në zërin e tij kishte emocion të fortë. Atmosfera u ndez shpejt, por Iliri e ndiente që Peteri diçka donte të thoshte, veç atyre që shpjegonte. Në pushim, si zakonisht, Mistoja u shkëput si krejt rastësisht, dhe ata mbetën vetëm. Ndezën nga një cigare. U vendos një çast qetësie. Peteri nxori nga xhepi një copë letër të bardhë dhe e vuri në mes të fletores. Iliri e vështroi me dyshim, por, kur pa frikën në sytë e tij, e lexoi me një frymë:

«Jam një mik i vendit tuaj. Dëgjoj radion dhe lexoj literaturë. Ju lumtë! Ruhuni nga Georgi. Mos bisedoni me mua në këtë dhomë.

Peter».

Pastaj nxori çakmakun dhe e dogji, duke e shikuar në sy Peterin, që, sa më shumë digjej letra, aq më i qetë dukej. Iliri priste të ndodhte diçka, por kjo as që i shkonte ndër mend. Ç'qëndrim duhej

të mbante? Një gjë e kishte fare të qartë: t'i ruhej çdo provokimi. Por a kishte të drejtë ta konsideronte provokim një sjellje të tillë? E mendoj për një kohë të gjatë. E përse ta merrte për të keq. Fundja, që Shqipëria kishte plot miq në botë, ai e dinte. Dinte gjithashtu që Georgi qe një njeri, nga i cili duhej pasur kujdes. Ai s'e harronte shikimin gjithë frikë të rojës plak, sa herë që kalonte Georgi. «Por mos vallë ky njeri është futur nga Georgi për të mësuar si reagojmë ne pas pakujdesisë së tij me dokumentin?!» Kjo pyetje e beftë e bëri akoma më të kujdesshëm.

Ndërsa Peteri, ndonëse edhe ai vëzhgonte se si do të reagoje Iliri nga gjesti i tij, tani e ndiente veten të qetë. Sa shqetësime kishte kaluar derisa arriti në këtë çast! Peteri qe bir i një metalurgu që kishte luftuar me armë në dorë kundër nazistëve dhe tradhtarëve të vendit. Ai i kishte dhënë Peterit shkollë e bashkë me të i kishte futur në rremba gjakun e tij. Ende pa i mbaruar studimet e larta, një ditë i ati bëri me të një bisedë sy në sy. Ai i tha se e kishin përjashtuar nga partia, sepse nuk qe dakord me vijën politike të saj. Peteri dëgjonte si i shastisur. Çdo të ndodhte me të?! Gjithçka! Por ai qe i bindur në ndershmërinë e t'et dhe që atëherë nisi të shikonte me sy kritik gjithçka që ndodhte në vend. Nga universiteti nuk e përjashtuan, ndoshta ngaqë ishte shkëlqyeshëm me mësim, por medaljen e artë nuk ia dhanë. Peteri erdhi e u mbyll disi në vetvete dhe për çdo gjë, sipas porosisë, bisedonte vetëm me të atin; policia politike qe bërë shumë brutale, provokatorët e saj vepronin krejt hapur. Por një vit më parë në jetën e tij kishte ndodhur diçka që e kishte nxjerrë nga ai kaos, që e ndihmoi

në përpjekjet e tij për të kuptuar situatën politike. Dhe kjo ndodhi krejt rastësisht. Peteri vërtiste radion nga stacioni në stacion dhe papritur dëgjoi të flitej në gjuhën e tij. Ishte Radio Tirana. Dhe qysh atëherë nisi ta dëgjonte atë vazhdimisht e vazhdimisht. Të dielave e dëgjonin së bashku me të atin. Nisi edhe të incizonte emisionet dhe i ridëgjonte herë pas here e mendohej për to. Sepse ndiente një kënaqësi të vërtetë nga ato lajme! Fryma e sinqeritetit, logjika e fortë, informacioni i saktë bënë që ajo megjulla që e vishte me aq kujdes, nisi t'i shpërndahej. Por i ati ia fshiu shiritat dhe e ndaloi të bënte një punë të tillë të rrezikshme. Peteri u bind. Por ai donte të bënte diçka dhe këtë dëshirë ia tha atij. «Duhet luftuar, — i tha i ati, pas një pauze të gjatë, — por duhet luftuar me mençuri. Ty të duhet të përcaktosh qëndrimin përfundimtar. Edhe te ne ka forca të reja, që kanë filluar të organizohen. Ti duhet t'i gjesh vetë ato. Por jo aty, në institut. Ato duhen kërkuar gjetkë, te punëtorët. Ata janë kocka e Partisë». Peterin kishte nisur ta brente gjithnjë e gjithnjë kjo dëshirë.

Dhe ja, Peteri takoi dy shqiptarë, bij të asaj Partie të guximshme, zërin e së cilës po e ndiente tërë bota. Ai që matur disa herë t'ua komunikonte ndjenjat e tij dhe më në fund vendosi, i bindur se nuk do t'i ndodhte asgjë. Dhe asgjë nuk ndodhi.

Iliri uli shikimin mbi tavllën e duhanit ku letra që djegur, pastaj shkroi rrëmbimthi në fletore: «Ju kuptoj. Ju lumtë, ju faleminderit!» Si e lexoi Peteri, ai e shoi përsëri me ngut. Që nga ajo ditë ata duheshin vetëm me sy, sepse edhe Peteri ruhej nga Georgi.


Mendimet e Antonit ishin përqëndruar në një pikë: te kërkesa për të raportuar në qendër për detyrën që i ishte ngarkuar. Ai nuk kishte asnjë dëshirë të largohej në këtë situatë nga ambasada, qoftë edhe për pesë ditë, siç e kishin urdhëruar me teleshkruesin e mallkuar. Ai as vetë s'e kuptoi si qe ngritur nga tavolina e punës e kishte shkuar deri te dritarja. Jo, nuk donte të largohej. Grindjet me ambasadorin po ia hanin shpirtin që prej një viti. Sapo ishte larguar ambasadori i vjetër, me të cilin shkonte shumë mirë, Antoni kishte ndier një boshllëk të tmerrshëm, që s'ishte tjetër veç paralajmërimi se punët do të shkonin keq. Që ditën e parë të takimit me ambasadorin e ri, një burrë rreth të pesëdhjetave, që dukej qartë se sapo e kishte zhveshur uniformën ushtarake e që petku i diplomatit nuk i shkonte fare, ishte bindur për para ndjenjën e vet. Sjellja e tij ishte për të ardhur keq. Brutal deri në poshtërsi, ai po ua merrte shpirtin të gjithë punonjësve të ambasadës. Dhe fatkeqësia më e madhe ishte se Antoni duhej t'i mbante lidhjet drejtpërdrejt me të. Për këtë kishte marrë urdhër të prerë nga qendra. Ashtu i pamësuar siç qe me punët e zbulimit në një vend si Shqipëria, jepte urdhra dhe kërkonte llogari sikur Antoni të qe komandant toge dhe jo zbulues. Në fillim kishte menduar se eprori i tij do t'i përshtatej situatës dhe do të nxirrte konkluzionet e duhura për vështirësitë e punës në Shqipëri, por kjo nuk kishte ndodhur. E Antoni trembej se mos digjej dhe e përcillnin si person të padëshirueshëm. Dhe hajde të kthehesh pastaj me këtë motivacion në atdhe. Nga një anë

Antoni donte të jetonte pesë ditë i qetë, larg këtij njeriu, që, në vend të zemrës, do të kishte me siguri ndonjë send tjetër, por ai e dinte se, kur të kthehej, kushedi ç'telashe e kurthe do t'i ngrinin. Në fillim Antoni mendoi të ankohej te drejtori në qendër, por, falë maturisë së tij, nuk e bëri këtë pa u informuar më parë për marrëdhëniet e drejtorit me ambasadorin. Kur mësoi për lidhjet e tyre familjare, humbi çdo shpresë dhe iu nënshtrua fatit.

Antoni ndezi një cigare dhe, si mori materialet që i duheshin, e mbylli kasafortën, pasi kishte sajuar më parë një grackë, në mënyrë që ta kuptonte nëse do ta kontrollonin gjatë mungesës së tij. Grackat ai i ngrinte mjaft mirë. Jo më kot, dreqi e mori, e kishin lavdëruar në shkollën e zbulimit dhe jo më kot e dërguan pikërisht këtu, në Shqipëri.

Antoni përgatitej për udhë. E shoqja nguli këmbë për ta shoqëruar deri në Rinas, por ai nuk pranoi. Porositë e saj të pafund ai i shënoi me kujdes. . .

Në makinë nuk shkëmbeu asnjë fjalë me shoferin. E dinte se ai falej tri herë në ditë për padronin. Kur aeroplani u ngrit nga pista, i kërkoi stjuardesës një aspirinë «Bajer» dhe një gotë me ujë mineral. Mendimi se do të kthehej në atdhe dhe do të takonte të afërmit i vërshoi me vrull dhe ai e ndjeu veten më të qetë. Kujtoi pastaj gjithë peripecitë që kishte hequr për të grumbulluar të dhënat për atë shqiptarin që kishte shkuar për specializim. Ai që përpjekur t'i verifikonte ato me saktësi, dhe ai dinte ta bënte shumë mirë këtë, por këtu teoria nuk i kishte pirë ujë. E keqja ishte se në Shqipëri burimet ishin tepër të varfra. Antoni mund të thoshte, por vetëm me vete, se ato nuk mund të quheshin më burime, por kroje që kishin shterur dhe, me ato



pak pika që mund të rridhnin, më shumë të ndiznin etjen, sesa ta shuanin. Kohët e fundit shpesh e më shpesh Antonit i vinte plasja që ishte futur në zbulim dhe nuk kishte zgjedhur një specialitet tjetër, pa telashe, aq më tepër që ai i kishte pasur të gjitha mundësitë, me atë rreth miqësor e familjar që kishte. Por tashmë ishte vonë. Ai që futur në këtë valle dhe duhej ta hidhte deri në fund. Po cili do të ishte fundi?!

6.

Antoni rrinte si mbi gjemba në kolltukun me lëkurë gri të zyrës së drejtorit. Në kohën që po sistemonte shënimet, drejtori, që atë ditë ishte veshur me uniformën e gjeneralit, bisedonte me dikë në telefon. Antoni hodhi shikimin nga Georgi. Shikimet e tyre u kryqëzuan dhe Antoni vuri re dashmirësinë e Georgit. Kjo i dha kurajë. Ndërsa shefi i Georgit luante me një stilolaps dhe nuk shikonte asnjëri. Me drejtorin ai e kishte punën në vijë.

— Fillo, po shkurt dhe qartë, — i tha drejtori Antonit, sapo uli dorezën e telefonit.

— Kandidati...

— Jo kandidati, por objekti, — e ndërpreu drejtori me nervozizëm.

— Objekti punon në një institut që merret me aplikimin e matematikës. Studimet i ka kryer në Shqipëri. Në shkollë ka qenë mesatar. Në fillim, sipas të dhënave, ka qenë pedagog në një rreth, pastaj, në saje të martesës me një vajzë që e ka të atin drejtor në një ndërmarrje të rëndësishme, është transferuar aty. Shfletova ato pak punime të

tij, u konsultova edhe me një specialist dhe rezultoi se ato nuk kanë ndonjë vlerë të veçantë shkencore, por thjesht publicistike. Nuk është studjor, i pëlqen jeta e lehtë. Me të shoqen shkon mirë. Nuk është në Parti. . .

— Po tjetri?

— Negativ, — u përgjigj fare shkurt Antoni.

— Ju? — tha gjenerali duke iu drejtuar Georgit.

— Të dhënat për të dy përputhen.

— Mirë. Përpilo informacionin e hollësishëm, — iu drejtua gjenerali Antonit, — ndërsa ti, Georg, më bëj planin e detajuar të operacionit, ku të përfshihen të gjitha masat. Do të vish të më raportosh personalisht. Qartë?

— Si urdhëroni, — tha jo pa krenari Georgi.

— Ju, Anton, do të qëndroni sa të përfundojë gjithë veprimi. Do të ketë detyra edhe për ju. Fundja, kjo punë është, në radhë të parë, në interesin tuaj. Ka pyetje?

— . . .

— Atëherë shkoni. Shpejtoni veprimet. Ka mbetur vetëm një muaj kohë. . .

7.

Mistoja hyri në ashensor. Brenda ishte dhe një burrë i moshuar, me të cilin nuk shkëmbeu asnjë fjalë. Kur u hap dera, në hollin e hotelit, njeriu i parë që vuri re, ishte Eva. Ora ishte shtatë plot. Ai e takoi jo pa emocion.

— Ku do më çosh, — e pyeti ajo, pa ia shkëputur dorën dhe pa ia ndarë atë shikimin e ndezur.

— Këtë mos e kërkoni nga unë, — i tha ai i joshur, — tani jam në dorën tuaj.

— Keni të drejtë. Atëherë po shkojmë në shtëpinë time. Do të jemi vetëm, — nxitoi të shpjegohej ajo, kur pa ndryshimin e menjëhershëm të qëndrimit të Mistos, — mos u frikësoni, — dhe e kapi për krahu.

Mistoja nuk kundërshtoi. «Fundja, kush më njeh...», mendoi ai dhe hipi në veturën e saj...

Vetura hyri në rrjedhën e dendur të shëtitores kryesore, dhe Mistoja ndezi një cigare. Ai shikonte dritat e reklamave shumëngjyrëshe që të verbonin, kur papritur ndjeu dorën e butë të Evës. Gishtat e të dyve u shtrënguan. Ai afroi buzët te faqja e saj që digjej dhe i pëshpëriti: «Kujdes, mos na përplasësh». Këtë e tha kaq qetësisht, sa edhe vetë u habit. I dukej sikur me këtë deli vajzë njihej tërë jetën.

8.

Iliri u zgjua. Gjumi e kishte zënë në shtrat me gjithë rroba, kur ishte duke lexuar. Kokën e kishte plumb të rëndë dhe ndiente nevojë të flinte akoma. Hodhi sytë nga krevati tjetër e vuri re që ishte i paprishur, dhe Mistoja s'qe aty. U ngrit në bërryla dhe mbi kanën e ujit pa një fletë letre të shkruar me bojë të kuqe. U ngrit dhe e mori në dorë.

*«Peshkop i dashur,
Më pihej një kafe dhe nuk mund ta prish-
ja gjumin tënd letargjik. Po dal të bëj një
shëtitje këtu rrotull. Studim të mbarë!
Mistoja.»*

Iliri në fillim qeshi, por, kur pa se ora ishte njëmbëdhjetë, mbeti disi i çuditur. «Qenka bërë natë, — mendoi i shqetësuar. — Ku dreqin të ketë shkuar?» U çapit deri te lavamani dhe u hodhi dy grushta ujë syve, pastaj u vesh dhe doli. Në holl nuk kishte njeri, edhe në kafe e në restorant po ashtu. Kur u mat të dilte përjashta, derën ia zuri një zdap i gjatë me pamje si të gorillës. U hoq mënjanë dhe i hapi rrugën, por zdapi dukej se nuk ngutej. Më në fund kaloi.

Kontrolloi vendin përreth hotelit, por Mistoja nuk dukej gjekund. «Ku dreqin të ketë shkuar», mendoi i shqetësuar, teksa ngjiste shkallët. Kur ktheu kokën prapa, vuri re përsëri atë zdapin që dukej se e ndiqte. «Po ky, ç'dreqin ka që më vjen prapa?!» mendoi gjithë nervozizëm dhe hyri brenda. U ngjiti në dhomë, por edhe aty nuk i rrihej. Si të bënte?

Kjo shkëputje e Mistos nuk po i pëlqente fare. U ul në krevat dhe nisi të mendonte me nge. Natyrisht, nuk i vinte aspak mirë që po shkonte nëpër mend ca gjëra të çuditshme, po, fundja, ai nuk ishte i verbër. Në sjelljet e Mistos dhe nga bisedat me të disa gjëra s'i kishin lënë përshtypje të mirë. Atij i pëlqente të vishej mjaft mirë, mburrej që kishte ditur ta vërtiste ndonjëherë dhe që «i kishte bërë naftën» punës së mësuesit «në një rreth të humbur», tregonte si e kishte marrë lehtësisht provimin e frëngjishtes etj. Iliri një ditë i kishte thënë haptazi, por me mjaft takt, se disa gjëra, ndonjëherë, mund të fitohen me ndërhyrje, por shkenca kërkon vetëm punë, ndryshe ajo nuk fitohet. Po Mistoja kishte shtrembëruar buzët.

Iliri priti akoma dhe dy orë. Për herë të parë

e vlerësoi telefonin që kishte në dhomë dhe zgjati dorën të lidhej me ambasadën por shpejt e tërhoqi. Përse t'i alarmonte? Le të priste dhe ca. Por pastaj ndjeu t'i rëndoheshin përsëri qepallat dhe, në mënyrë krejt të pavullnetshme, ra në gjumë të thellë.

Në mëngjes, kur i doli gjumi, vuri re Miston që po flinte fare i qetë. U gëzua kur e pa, po shpejt u kujtua. U ngrit me rrëmbim nga krevati dhe iu afrua, i hoqi mbulesën e, kur e pa ashtu të mbledhur kruspull, i erdhi keq dhe e mbuloi përsëri. Pastaj vendosi të rruhej. Kur e kishte bërë fytyrën mirë e mirë me shkumë, vuri re me habi në pasqyrë se mollëzat e faqeve i dukeshin të kërcyera jashtë, sytë të futur thellë dhe shpatullat të ngushta. Vetëm atëherë, kur ishte në moshë të re e kur kishte filluar të ndiente, në fillim turbull, e më vonë fare qartë, se kishte rënë në dashuri, e kishte parë veten dendur në pasqyrë. Iu kujtua Diana dhe vajza pesëvjeçare dhe ndjeu një rrëqethje që ia përshkoi tërë genien. Pastaj i shkoi përsëri mendja te Mistoja. Sa e kishte shqetësuar! «Po ku dreqin të ketë qenë mbrëmë? A thua të ketë bërë ndonjë budallallëk me atë Evën... si shumë më foli atë ditë për të...» Hapi rubinetin dhe uji rodhi me shumë forcë. Pastaj nisi të vërshëllente një melodi gazmore për të zgjuar Miston. Dhe me të vërtetë ai lëvizoi.

Iliri zgjati kokën nga e ndara e murit dhe me një ton shumë gazmor e përshëndeti:

— Mirëmëngjes, pëllumb, ku u zhduke mbrëmë?

Mistoja fërkoj fort sytë dhe, si u ngrit shesh në krevat, iu përgjigj:

— Dola për një shëtitje dhe rastësisht u takova me atasheun tonë të tregtisë...

— U shqetësova shumë, — tha Iliri, tani i pen-

duar për tërë ato që i kishin shkuar nëpër mend... — dhe desha të telefonoja njëherë në ambasadë, por pastaj se si më kapiti gjumi.

— S'do të kishe bërë keq, megjithëse unë të kisha lënë një shënim... — u përgjigj fare i qetë Mistoja dhe u hodh nga krevati.

— Rruaju, jemi vonë dhe mos m'u shkëput tjetër herë pa më njoftuar...

— Kot shqetësohesh, unë nuk jam i vogël, — u përgjigj disi i fyer Mistoja.

— Jo, kam të drejtë të shqetësohem. Jemi vetëm dhe... në vend të huaj.

— Vërtet jemi vetëm, por dimë dhe ta kontrollojmë veten, — tha Mistoja, duke e shprehur fare hapur nervozizmin.

Iliri, me fytyrën kthyer nga dritarja, përpiqej ta largonte vëmendjen nga kjo ngjarje aspak e këndshme.

9.

Doganieri vuri gjyslykët dhe nisi të shqiptonte me radhë sendet që ndodheshin në valixhe dhe në çantë. Iliri afroi edhe një pako tjetër të madhe.

— Edhe këto janë të miat.

Doganieri plak, si një instrument i saktë, dinte t'i vlerësonte shumë mirë njerëzit që kalonin përpara tij. Ja dhe ky djaloshi që nuk ta mbushte syrin, në bagazhin e tij kishte më shumë libra dhe fare pak sende. Aty-këtu dukej ndonjë send zbukurimi.

Pastaj i hodhi një shikim gjithë respekt Ilirit dhe i preu dokumentin.

— I paske bërë paratë libra, mor djalë.

— Epo, për të mësuar vajtëm, xhaxho, — iu përgjigj me çiltërsi Iliri dhe, si mori bagazhin, shkoi të takonte gruan dhe vajzën që prisnin përjashta...

— Do qëndrojmë akoma? — pyeti Diana me padurim, duke i hedhur një shikim të ëmbël e të shpejtë.

— Ja, sa të vijë dhe Mistoja. Nuk bën të ndahemi, — tha ai dhe kërkoi nëpër sallë të shikonte të shoqen e tij. — Përse nuk qëndrove me të? — e pyeti pastaj papritur Dianën.

Ajo ngriti supet si e zënë në faj.

— Po ne nuk njihemi, jemi takuar vetëm një herë...

Iliri kërkoi një nëntekst në fjalët e së shoqes. Iu duk sikur kishte diçka që nuk shkonte në këtë mes, por nuk i tha asgjë. Ndërkohë e shoqja e Mistos që ngritur në këmbë, dhe Iliri dallonte qartë vijat e trupit të saj të gjatë e pak të bëshëm nën fustanin e ngushtë. Ajo ishte veshur me të vërtetë me shije dhe bënte përshtypje në sytë e të tjerëve. Aty për aty Ilirit iu kujtua se Mistoja kishte blerë plot plaçkurira për të shoqen, dhe kjo duhet të ishte arsyeja që po e vononin në doganë. Ajo po lëvizte poshtë e lart nga padurimi.

Më në fund, Mistoja doli, u takua me të dhe i bëri shenjë Ilirit.

— Do të më duhet të paguaj, kam sjellë mbi normativën, — tha ai kalimthi. — Edhe këta të doganës kërkojnë qimen në vezë, sikur dalim çdo ditë jashtë shtetit...

Mistoja nuk ishte i qetë. Kishte më shumë se një orë që ishte ulur në tavolinë dhe akoma nuk kishte filluar nga puna. Në mendjen e tij asgjë nuk ishte e qartë, çdo gjë i dukej e turbullt, e mjegullt. I vërtitëshin si fugë copa fragmentesh, monologjesh, pyetjesh, kritikash. Dhe gjithë kjo drej histori nisi pikërisht nga ai informacioni i doganës. Ta dinte ashtu do të kishte hequr dorë nga ato mallrat e tepërta. Në drej të venin ato, sepse po i rrezikonin shumë gjëra. Një koleg, që ai e dinte për shok të ngushtë, kishte arritur deri atje sa ta pyeste: «Na thuaj hapur, ku i gjete paratë që solle kaq plaçka?» «Kurseva», qe përgjigjja e Mistos. «Kurseve? Bukur besa, por, sado që të kurseje, nuk mund të sillje plaçka dy herë më shumë se dieta».

Eh, si transformoheshin njerëzit! Për këtë mendonte tani Mistoja. Çuditej me Kiçon, që i kishte dhuruar dhe një çakmak me gaz. Trokiti dera. Brenda hyri Kiçoja dhe, pa përshëndetur, u ul në karrige.

— Nuk të pandehja të tillë burracak, — i tha Mistos, si ndezi cigaren me çakmakun që i kishte dhuruar ai vetë.

— Ç'kërkoni ju të gjithë nga unë? — pyeti me nervozizëm ai.

— Akoma nuk e ke kuptuar? Pyetjet që të kemi bërë, janë fare të qarta. Ne kërkojmë të na kthehesh shëndoshë në gjirin tonë. Ja ç'kërkojmë.

— Po ç't'ju them unë?! I kurseva, ku do t'i gjeja tjetër?, — fytyra e tij shprehu shqetësim dhe përvuajtje.

— Lëri këto. Më vjen turp për ty, më vjen keq që nuk të kam njohur mirë. Sidoqoftë unë erdha të të këshilloj edhe një herë si shok. Trego hapur. Shko bisedo sinqerisht me sekretarin e organizatës-bazë të Partisë. Asgjë nuk ka për të të ndodhur.

Kiçoja, si tha këto fjalë, heshti. Ai e kishte akoma në dorë çakmakun e vërtiste atë nëpër duar dhe, më në fund i nguli shikimin e tij tepër të pastër Mistos.

— Veç kësaj që të thashë, po të kthej dhe dhuratën tënde. Është më mirë kështu. Mund ta pranoja vetën po të isha i bindur në pastërtinë tënde, — i tha dhe, si heshti një çast, doli nga zyra.

Mistoja e mori çakmakun nga tavolina, e vërtiti një copë herë nëpër duar, ashtu i menduar, pastaj e përplasi me sa fuqi pati në murin përballë. Dhe iu kujtua rrëmbimthi se atë çakmak ia kishte dhuruar Georgi. Pas një çasti u pendua për këtë veprim; nga zyra tjetër mund ta kishin dëgjuar përplasjen e çakmakut në mur. U ngrit dhe doli për në kafe. Flegrat e hundës i hapeshin me forcë, nuk ngopej me ajër dhe kushedi si ishte bërë në fytyrë, sepse kalimtarët i hidhnin ca vështrime të çuditshme. Ndiente nevojën të pinte diçka të fortë. Konjaku duket se e bëri efektin dhe, mbas ndonjë gjysmë ore, Mistoja qëndronte në kolltuk, në kafe, dhe me sytë e përqëndruar në një pikë diç mendonte për të dalë nga situata. Por mendimi dukej se kishte ngecur në vend...

Ngjiti ngadalë shkallët e pallatit dhe, para se të fuste çelësin në derë, i hodhi një sy orës. Ishte dhjetë e gjysmë. Nuk ndiente të ftohtë, por, kur po vërtiste çelësin, i shkuan të rrëqethura. Si do t'i thoshte Orjetës për vonesën dhe për erën e al-

koolit? Ndezi dritën e korridorit. Në shtëpi kishte qetësi. Siç dukej, Orjeta kishte rënë të flinte, në kundërshtim me zakonin e saj kryeneç për ta pritur. Shtyu ngadalë derën e dhomës; ajo nuk ishte në shtrat. Pastaj hyri në kuzhinë. Mbi tavolinë i tërhoqi vëmëndjen një copë letër, në të cilën ai njo-hu shkrimin e saj.

Të pritëm bashkë me mamanë deri më 9,30...».

«Më mirë që ka ikur», — mendoj. — Le ta bëjmë ballafaqimin nesër në drekë. Ballafaqim! Ama, e bukur fjalë! U mbush jeta plot ballafaqime». Pastaj iu kujtua përsëri këshilla e Kiços për të vajtur te sekretari i partisë dhe u mërzit edhe më tepër. Mori shishen e konjakut në frigorifer dhe u ul në divan pa u zhveshur. Si ktheu një gotë me fund dhe ndezi një cigare, u ngrit rrëmbimthi, kërkoi diçka nëpër librat, e gjeti atë që i duhej dhe vajti te telefoni. Mbas asaj bisede ai e ndjeu përsëri mëndjen të kthjelluar, të aftë për të gjykuar. Duke vërshëlyer, u nis të bënte një dush.

11.

Kur i thanë se e priste Iliri poshtë, Mistoja u gëzua sinqerisht. Ai tashmë e ndiente veten mirë, i ishte kthyer ajo ndjenja e humorit, megjithëse e kishte disi më të përmbajtur dhe, të thuash atë që është, Iliri ishte vërtet djalë i mirë, me kulturë dhe me të ardhme. «E pse të mos e kesh shok?!» Mistoja, tek zbriste shkallët e qortonte veten ashpër që nuk ishte kujtuar më parë e që nuk ishte takuar me të e, pse jo, edhe që nuk i kishte vajtur për një vizitë në shtëpi tok me Orjetën.

Ai pa shpatullat e ngushta të Ilirit dhe çantën e tij të zezë që e mbante gjithnjë me vete.

— Ilir, — i foli gati me entuziazëm, duke shpejtuar hapin drejt tij.

Iliri u kthye rrëmbimthi, dhe, në kundërshtim me natyrën e përmbajtur të tij, nxitoi ta takonte. U përqaftuan fort.

— Ku humbe ti, — e pyeti me qortim Iliri, pa i lëshuar krahun.

— Edhe ti ke humbur, — u hakmor Mistoja dhe i futi krahun. — Do të shkojmë të pimë ndonjë gjë, — shtoi ai.

Kur ishte duke pirë kafën, Mistos i vajtën sytë te kostumi prej stofi të thjeshtë i Ilirit, te jakka e këmishës që nuk ishte në modë dhe te kravata që nuk i shkonte fare me kostumin. Edhe sytë i dukeshin shumë të lodhur. «Ka mbetur fshatar», — mendoi Mistoja me vete dhe, si për ta larguar këtë mendim, e pyeti:

— Me se po merresh?

— Kam një problem aplikimi. Është me vlerë për ekonominë. Kam studjuar plot materiale, kam eksperimentuar në një uzinë.

— Ç'është kjo? — u interesua Mistoja.

— Në dukje është fare e thjeshtë, punë llamarine, por, po t'i biesh kalemit, janë mijëra lekë që i kursehen shtetit.

— Po ti sikur nuk ke mbaruar për kovaçanë, — i tha Mistoja, për ta nxitur të tregonte edhe më tepër.

— Ashtu është, — tha mendueshëm Iliri, — por ama, kam mbaruar për ekonomi. Dhe, kur ekonomisti shkrihet me kovaçin, dije se del diçka e mi-

rë aty, — tha duke qeshur dhe nisi të shpjegonte duke shkruar në kapakun e kutisë së cigareve me një shkrim të imtë, po të sigurtë. Shpjegimet ishin aq të qarta, saqë edhe Mistoja, që nuk e njihte problemin, u entuziazhua.

— Ti s'e merr me mend çfarë ndihme më kanë dhënë punëtorët. Edhe jashtë orarit kanë qëndruar. I kemi bërë bashkë, të gjitha, — përfundoi ai.

Mistoja ra në mendime. I vinte mirë për Ilirin që punonte e merrej me diçka, e cila në dukje ishte e rëndomtë, por i vinte edhe keq për të. Ajo pamja e tij e jashtme, gjithnjë e lodhur, tregonte se ky njeri nuk interesohet sa duhet për jetën dhe, me siguri, do t'ia kishte bërë skëterrë jetën edhe së shoqes. Kur mendoi këtë, Mistoja kujtoi Orjetën. Jo, ajo kurrë nuk do ta kishte lejuar të merrej me një punë të tillë, torturuese...

— Po ti, me se merresh, — ia ndërpreu fillin e mendimeve Iliri. Ai e vërente me ata sytë e tij kureshtarë tepër të zgjuar, që të ftonin të bisedoje me çiltërsi.

Mistoja s'dinte ç't'i përgjigjej. E me se merrej në të vërtetë ai? Me asgjë. Ata muajt e parë pas kthimit nga jashtë shtetit ishte marrë me mbylljen e plasaritjeve të doganës. Iu kujtua ajo ditë kur kishte trokitur në zyrën e sekretarit të Partisë. Ai e kishte pritur me dashamirësi dhe e kishte dëgjuar me shumë kujdes. Mistoja i kishte thënë troç se ato para ia kishte dhënë një emigrant shqiptar, i shpërngulur që para Çlirimit. Atë njeri e kishte njohur në ambasadën tonë dhe në dy-tri takime kishin krijuar marrëdhënie të ngrohta. Në fund, kur do të

ndaheshin, ai i kishte dhënë paret, me gjithë kundërshtimin këmbëngulës të Mitos. Ja, kjo që e gjitha. Përse nuk kishte treguar që në fillim?! Ja, se i vinte rëndë, i vinte turp nga shokët, nga kolektivi. Por Partisë, që e rriti dhe e dërgoi edhe për specializim, nuk mund t'ia mbante fshehur këtë gjë. Mallrat e tepërta nuk do t'i merrte. Në drejt të shkonin ato...

Pasi kishte mbyllur këtë çështje, ai e kishte kaluar kohën duke punuar në një gjendje apatie. Vetëm pasditeve kishte krijuar variacionet e duhura me Orjetën.

Por të gjitha këto Mistoja nuk mund t'ia thoshte Ilirit. E për se do t'i hynin në punë atij?

— Punë — shtëpi, — iu përgjigj Ilirit. — Kam nisur t'i përsëris me kujdes leksionet që morëm andej, po konsultoj dhe literaturë. Kam skicuar dhe një artikull për te «Shkenca dhe jeta».

— Po sendet në doganë, i tërhoqet?

Kjo pyetje i erdhi befas, ai u shqetësua dhe ia nguli shikimin hetues shokut, po në fytyrën e tij nuk lëvizte asnjë nerv. «Jo, — mendoi, — kjo pyetje me siguri është e zhveshur nga çdo prapamendim. Iliri është i prerë për formula, por jo për fenomene që nuk përqasen me to».

— Ohu, i zhdoganova. Një telefon atje ku duhej dhe... lëshoi një vërshëllimë dhe bëri një gjest me dorë, që donte të thoshte se çështja lëvizi me vrull përpara, pa asnjë pengesë.

Kjo ishte mënyra më e mirë, sipas tij, për të shpërndarë mjegullën që mund të krijohet në situata të caktuara. Mistoja e dinte se Iliri nuk kishte

ndër mend t'u hynte pyetjeve, si e qysh ishin zhvilluar ngjarjet.

Ilirit iu thye zemra nga kjo bisedë. Ai kërkoi me sy kamarieren. Në tavolinë ra heshtja, një heshtje e rëndë plumb, prej së cilës të dyja palët dëshironin të çliroheshin sa më shpejt.

12.

Erikoja kishte mërguar që në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare. E kishte tërhequr pas vetes xhaxhai. Ende kërthi, Erikoja kishte provuar mbi shpatullat e tij punën e rëndë të minierës, pastaj qe rregulluar në një oficinë. Pas aksidentimit të xhaxhait, ai mbeti krejt vetëm. Për të u kujdes një vendas që e afroi dhe e këshilloi të ndiqte shkollën. Erikoja mbaroi studimet e larta, krijoi atje familje dhe i rralloi shumë letrat që dërgonte në familje; ndryshimet ishin kaq të mëdha e të shpejta, sa që ai nuk dinte kush i kishte mbetur gjallë në Shqipëri. Ai qe shumë i lidhur me familjen e tij, për të bëhej copë. Por edhe të ardhurat i kishte të mjaftueshme. Një ditë, fare rastësisht, ai u ndodh në një dyqan, ku i tërhoqën vëmendjen një burrë e një grua që flisnin shqip. U afrua, u njoh me ta, dhe që atëherë u bë mik i ambasadës. Aty ishte, siç thoshte dendur ai, si në shtëpinë e tij. Më vonë u njoh me studentët shqiptarë, me të cilët u lidh shumë. I ftonte ata shpesh në shtëpi, mësoi këngët e reja shqiptare, dëgjonte rregullisht emisionet në gjuhën shqipe. Por, me ndryshimin e marrëdhënieve shtetërore, studentët u larguan, dhe ai i dendësoi vizitat në ambasadë.

Një ditë, si edhe herë të tjera, ai kaloi përpara policit i qetë, dhe i ra ziles. E priti Femi, atashu tregtar.

— Sot nuk na ke marrë në telefon dhe, kush vjen pa ftuar...

— E gjen të shtruar, — ndërhyri shpejt Erikoja.

— Je drejt vetë, — i tha Femi duke e përqaftuar. — Shkojmë në dhomën time, se nuk ka njeri tjetër këtu.

Dhoma ishte e rregulluar fare mirë. Pas pak e shoqja e Femiut solli kafe dhe një shishe konjak.

Erikoja e mori shishen në dorë dhe, si e afroji më pranë vetes, fërkoji me gishtin tregues tri yjet e etiketës.

— E kemi të mirë këtë konjak, — tha ai.

— Po, — pohoi Femi, — por jo për ta admiruar në shishe, — dhe i mbushi gotat.

Erikoja e ktheu gotën si me drojtje.

— Si i ke nga shtëpia?

— Mirë, po ti ke marrë haber nga Shqipëria, si janë andej?

— Mirë, faleminderit.

Në heshtjen që ra, Erikoja i hodhi një sy dhomës, ku dukej kudo dora e kujdesshme e gruas. Pastaj i ngelën sytë mbi divan, ku që vendosur një album dhe ca fotografi të shpërndara andej-këtej.

Femi e vuri re interesimin e tij.

— I ka shpërndarë gruaja, po i sistemonim në album.

— A mund t'i shikoj?

— Posi. — Dhe të dy u afruan te divani. — Më duhet të të shërbej si ciceron.

— Është detyrë për të zotin e shtëpisë, — tha Erikoja dhe filloi t'i shikonte ato një nga një me interesim; njihte shumë nga shqiptarët që kishin qënë aty, në ambasadë. Ai entuziazmohej, disave u mbante mend dhe emrat, përmendte ndonjë shaka të tyre, ndonjë cilësi, ndonjë çast të bukur nga takimi me ta. Dhe, ç'është e vërteta, kishte plot mbresa. Ja dhe një fotografi ku kishin dalë tetë vetë. Midis tyre Mistoja dhe Iliri.

— Ja dhe Mistoja, djalë xhanan dhe i mençur. Na nderojnë djem të tillë, — tha Erikoja.

— E njohe ti Miston!, — u çudit Femiu.

— Posi, i vajta në institut. Xhevahir, jo shaka! Po me Ilirin nuk u takova dot. Mistos i bëra dhe një peshqesh të vogël. Më hyri në zemër ai djalë. Femiu sollti gotat e konjakut.

— Imë shoqe po na prish punë me këto fotografite, por ne kemi detyrën tonë.

Erikoja qeshi me zë të lartë nga kjo shaka, pastaj përplasën gotat. Pas ndonjë ore ai u ngrit të ikte, dhe Femiu e përcolli deri te dera e jashtme. Kur u kthye brenda, një valë zemërimi që mezi e kishte përmbajtur, i shpërtheu me tërë forcën. Erikoja kishte gabuar: në fotografi, në vend të Mistos, kishte treguar Ilirin dhe kjo ishte fatale për të.

13.

Femiu zbriti nga makina në sheshin «Skënderbej» dhe u nis më këmbë për në shtëpi; vinte fill nga aerodromi. Ky kthim në atdhe ishte planifikuar që më parë; ai do të merrte pjesë në nënshkrimin

e marrëveshjes tregtare me shtetin ku ishte me shërbim.

Në çantë kishte letra të shokëve të ambasadës për familjet e tyre. Atij i duhej t'i takonte të gjithë, t'i shikonte, t'u jepte letrat. Këtë Femi u konsideronte detyrë ndaj shokëve. Atje në ambasadë ai grusht i vogël shqiptarësh ishte si një familje e vetme. Udhëtimi për në Shqipëri ishte gëzim për të gjithë të tjerët. Pregatiteshin letrat, ndonjë dhuratë simbolike për fëmijët dhe të afërmit, pastaj vinin kërkesat për vogëlimala nga Shqipëria. Dikush donte një libër, tjetri cigare, një i tretë një album. Femiut i erdhi për të qeshur kur iu kujtua porosia e ambasadorit për miell misri dhe djathë nape. Dëshirë e çuditshme, por e kuptueshme për një lab që e kishte kaluar fëmijërinë në male...

Kur ishte liruar disi nga punët e shumta, iu kujtua se kishte edhe një detyrim të vogël: u kishte bërë disa fotografi Ilirit dhe Mistos. Kërkoj në telefon Ilirin dhe la me të një takim...

Njohja jashtë shtetit ndryshon çuditërisht nga çdo lloj njohjeje. Ilirit iu duk se takoi një shok, një mik, një vëlla. Ata u përqaftuan fort.

— Si i gjete njerëzit?

— Faleminderit, mirë. Më thanë se i kishte takuar, se i merr shpesh në telefon... Nëna nuk të heq nga goja.

— Ç'thua, — tha gjithë turp Iliri, — unë nuk e harroj dot kurrë gjithë atë që keni bërë për ne. Kur takoheshim me ju, e ndienim veten si në shtëpinë tonë.

Iliri, i qetë në dukje, kishte, megjithëse rrallë, disa shpërthime të çuditshme. Ja edhe tani, atij iu kujtuan ata tre muaj që kaloi jashtë shtetit. Ambienti

atje vetëm në dukje ishte miqësor, ndërsa, në të vërtetë, nuk ishte aspak e vështirë të konstatoje se prapa asaj etikete false fshiheshin mendime dhe qëllime të këqija. Ja pse ai nuk mund t'i harronte kurrë takimet me shokët e ambasadës, por veçanërisht, kur binte fjala për Femiun, ai thoshte: ishte një njeri që e dinte mirë punën e tij. Me këto fjalë ai donte të shprehte kaq shumë, sa ishte e pamundur t'i merrje me mend.

— Po Mistoja si duket, — deshi të dinte Femiun, i cili nuk mund ta kuptonte dot Ilirin pa Miston.

— Është mirë. Gjithnjë ashtu, i hedhur e i vrullshëm, gjithnjë elegant, thembra e tij e Akilit kjo, gjithnjë i dashuruar shumë pas së shoqes, por jo aq sa duhet pas shkencës.

Iliri e tha mendimin e tij në atë gjendjen e gëzueshme, por papritmas u pendua. Mos vallë kish subjektivizëm në vlerësimin që i bëri?

— Ke të drejtë, kështu më duket edhe mua, — e qetësoi Femiun, i cili duket se e kuptoi shqetësimin e tij. — Mendimet tona në këtë pikë përputhen.

— S'e merr me mend sa u shqetësova atë natë që u vonuat bashkë. Doja edhe ta kërkoja, por seç kisha një dëshirë të çuditshme për gjumë.

— Unë nuk jam vonuar ndonjëherë me të, — tha Femiun, pasi u mendua një copë herë të mirë. Iliri mbeti si i habitur, s'dinte ç'të thoshte.

— Ndoshta ka qenë ndonjë rast tjetër, s'e kujtoj mirë tani. Epo, gëzuar e suksese në punë, — deshi ta mbyllte këtë bisedë Iliri.

— Me Miston kam ndenjor njëherë pak si tepër, por paradite, kur ti kishe shkuar bashkë me Zianë për të çuar pakon e atij studentit nga Lezha. Atëhe-

rë po, — u përgjigj shkoqur e si i menduar Femiu.

— Nejse, — tha Iliri, — kushedi...

— Para se të ikja, takova Georgin. Më dha të fala veçanërisht për ty. Më tha se ju kujton gjithmonë dhe ju uron suksese në punë.

— Pse këto të fala të posaçme?

— As unë nuk e di.

— Po për Miston? — pyeti me kureshtje Iliri.

— Edhe për atë, por m'u duk sikur këtë e bëri thjesht për etiketë. Mos patën ndonjë mosmarrëveshje ata të dy?

— Ndoshta Mistoja, që kur i tregova për pakujdesinë e Georgit, kur nxori dokumentin ushtarak, ka mbajtur qëndrim të ftohtë ndaj tij. Ndërsa unë në asnjë rast nuk i lashë shkak. Midis nesh zhvillohej një lojë e heshtur.

— Mundet, — tha mendueshëm Femiu. — Si thua, ngrihemi? — tha pastaj ai, si i hodhi një sy orës.

— Si të duash. Megjithëse unë do të dëshiroja të rrinim dhe më gjatë, — tha Iliri. — Si thua, do të na dalësh ndonjë mbasdite nga shtëpia? — shtoi pastaj ai.

— Nuk të premtoj dot, por, po të më krijohet kohë sado pak e lirë, do vij me kënaqësi.

14.

Iliri, i veshur me pizhama, po rrinte në kuzhinë. E shoqja vuri vajzën në shtrat dhe erdhi e ndënjë afër tij; e shikonte të shqetësuar. Tek ai ajo e dallonte fare mirë këtë gjendje, por këtë radhë ajo

dyshoi se nuk kishte të bënte aspak me ndonjë nga ato studimet e tij. Në raste të tilla ai bisedonte edhe me të, kurse tani ai sepse rrinte si i mbyllur në vetvete, ndaj nuk guxoi edhe ta pyeste. Iliri lëvizi i shqetësuar nga vendi. Prania e një tjetri aty në dhomë e bezdiste, donte të mbetej vetëm për vetëm me mendimet e tij. I vinte shumë keq për të shoqen, e kuptonte pozitën e saj e megjithatë nuk dilte dot tej kufijve të zakonit të tij për t'i mbajtur mendimet të fshehta.

— Po shtrihem, — i tha ai pa takt dhe shkoi në dhomë.

Ajo mbeti aty vetëm. Një si lëmsh i madh iu mblodh në grykë dhe i pengonte frymëmarrjen. Dhë ndjeu dëshirën të çlirohej sa më parë, ndaj u përpoq të sillte ndër mend gjithçka kishte ndodhur kohët e fundit, por nuk po gjente asnjë pikë të errët. Mos kishte ndodhur gjë midis tyre? Sigurisht jo. U ngrit e shkoi dhe ajo në dhomë. Kur e pa ashtu me sy të mbyllur, kujtoi se Iliri po flinte, dhe e ndjeu veten të lehtësuar...

Po Ilirin nuk po e zinte gjumi. Takimi me Femiun, biseda me të e bëri të mendohej mirë. «Pra, Mistoja, atë natë që u vonua, nuk paskësh qenë me Femiun. Po me kë kishte qenë, atëherë? Me këdo tjetër, por me Femiun jo. Kjo do të thotë shumë. Po unë ç'bëra... I besova atij si ndonjë çupërlinë dhe nuk njoftova për atë që ndodhi. Ama, mirë e paskam kryer detyrën si komunist... Po me kë të ketë qenë atë natë? Mos vallë me atë, Evën... Si shpesh më fliste për të... Një drej e merr vesh, por, sidoqoftë... nuk është treguar aspak i sinqertë...»

Papritur Ilirit iu kujtua ai shënimi që i kishte lënë Mistoja atë natë mbi një libër të hapur. Iu bë sikur atëherë, pasi e kishte lexuar, shënimin e kishte lënë po aty dhe librin e kishte mbyllur. U ngrit nga krevati pa bërë zhurmë dhe në majë të gishtave shkoi në korridor, te biblioteka. E gjeti librin dhe e kontrolloi me një frymë, po shënimin nuk e gjeti. Pa me radhë tërë librat dhe fletoret, por përsëri asgjë.

«Pse i duhej të trillonte kaq pa mend», — mendoi Iliri.

U ngrit dhe shkoi në kuzhinë. Ndjeu nevojën të pinte një kafe. . . Ashtu i kredhur në mendime priste mëngjesin.

15.

— . . .Neve na duhen të dhëna rreth planeve të tyre ekonomike, rreth rezervave të tyre. . . që të ndërtojmë marrëdhënie të tilla, në mënyrë që prej tyre të kemi sa më shumë fitime dhe t'i sabotojmë. Ju punoni keq.

Këto fjalë i drejtoheshin nënkolonel Georgit, që ishte thirrur me ngut nga drejtori i zbulimit.

Këtë stuhi Georgi nuk e priste, ai e dinte mirë mendimin që kishte drejtori për të. Për një çast i shkoi mendja se mos në drejtim të tij po vinte një furtunë e pregatitur me mjeshtëri nga shefi, që mund ta rrëmbente dhe ta vërviste kushedi se ku, si ndonjë copë ashkël.

— Ne po punojmë sipas planit të aprovuar prej jush, — donte ta bënte ortak Georgi.

— Doni të më bëni bashkëfajtor në ngathtësinë tuaj, Georg? Bravo ju qoftë! Po më flisni sikur erdhët dje në zbulim, drejtpërdrejt nga bangat e shkollës.

— Nuk e pata me atë kuptim, ju kërkoi të falur, — u nxitua të tërhiqej ai. — Po puna është se Antoni akoma nuk ka mundur të hyjë në kontakt me agjentin tonë në Shqipëri. «Falma mëkatin, Anton!», mendoj me vete Georgi.

Drejtori ra në grackën që i ngriti Georgi. Atij iu kujtuan vetëtimthi dy-tri shënime të ambasadorit në Shqipëri, që e karakterizonin Antonin si frikacak, të lëkundshëm e pa inisiativë.

— Me çfarë drejtin merret ai buf, mos vallë admiron ndërtimin e socializmit në Shqipëri, apo ndoshta shikon si po na hedhin baltë shqiptarët me atë propagandën e tyre me përpjesëtime tmerrësisht të çuditshme? — Drejtori nxori stilografin, shkroi diçka me nervozizëm për një kohë të gjatë dhe ia zgjati shënimin Georgit. — Të jepet me teleshkruer. Le ta shikojë pastaj Antoni se ç'do të thotë zbulim. Ai mendon se në zbulim mund të pranohen zonjushat prostituta.

Georgi e kuptoi se biseda kishte marrë fund dhe, si nderoi ushtarakisht, u largua. Në korridor i hodhi një sy shënimit. Antonit i ishte ngritur kurthi dhe, fatkeqësisht, për këtë kishte ndihmuar vetë ai, Georgi. Por, kur mendoi se mund të ishte vetë viktimi, e largoi me një të qëlluar të fortë ndjenjën e keqardhjes: «Mëkatet për ne njerëzit e shkretë janë», mendoi ai dhe u nis për në sallën e teleshkruesve.

— Ama, edhe ai artikulli im në «Shkenca» sikur u botua me porosi, tamam në çastin e duhur. Si thua ti, Ori? — e pyeti Mistoja të shoqen.

— ...

Në kafe kishte shumë njerëz, dhe tymi i duhanit kishte krijuar një re të dendur kaltëroshe, që Orjetës po i zinte frymën. Ajo e shikoi me vëmendje të shoqin. Kur ishte njohur për të parën herë me të, asaj i kishte pëlqyer tej masës, por gradualisht kishte filluar të zbulonte tek ai ca vese që gjithnjë e më qartë nxirrnin krye dhe tregonin se pamja e tij e jashtme nuk ishte në harmoni me cilësitë e vërteta. Atij po i zhvilloheshin ca prirje të çuditshme, i pëlqente vetja si shumë, dhe sedra e tij kërkonte vetëm përkëdhelje e asgjë tjetër. Në jetën e tyre të shkurtër bashkëshortore kishin pasur mjaft grindje të vogla, të cilat, në fillim, Orjeta nuk i vinte re, por kohët e fundit sikur ishin shpeshtuar. Ajo ishte në përgjithësi tepër e mërëzitur dhe rrallë, shumë rrallë, i harronte të gjitha, e Mistoja i delte përpara syve me ato cilësitë që kishte krijuar në përfytyrimin e saj, kur ishte vajzë ende e papjekur. Megjithëse qe betuar se këtë mbrëmje të vogël do ta kalonin pa u grindur, asaj nuk iu durua kur e dëgjoi atë të mburrej.

— Aty kishin botuar dhe shumë të tjerë, dhe punime më me vlerë, por nuk besoj të mburren kështu si ti.

Shikimi i saj ishte i ftohtë dhe Mistoja e dallonte fare qartë përbuzjen, të cilën ajo as që mundohet ta fshihte.

«Ka hak kjo, — mendoj Mistoja, i zemëruar, — tani është siguruar shumë mirë. Unë mund të merrja cilëndo femër tjetër, dreqi ta marrë, po ç't'i bëja asaj province të humbur». Edhe marrëdhëniet me të vjehrrin sikur qenë ftohur. Ai qe burrë i përmbajtur, tepër i dhënë pas punës, po Mistos i dukej se ai nuk e nxirrte qimen nga qulli. «Po si atëherë më ndihmoi të vija në Tiranë? Me siguri do t'i ketë ngrënë shpirtin e shoqja, ajo grifsha... Edhe Orjeta asaj i ka ngjarë, s'i ka lënë gjë...»

— Unë nuk mburrem, vetëm konstatova një fakt. Në qoftë se ty nuk të pëlqen artikulli, të tjerët nuk të kanë asnjë faj. Mistos iu kujtua papritur Eva dhe harroi se ku ishte, aq të gjalla qenë kujtimet e asaj periudhe, kujtime të ndërprera keqas dhe të rregulluara sërish, paçka se mbi baza të reja. «Tani që çdo gjë u normalizua, me siguri do të më dërgojnë prapë me shërbim, dhe do ta vërtis në mënyrë të tillë që të shihem përsëri me Evën», mendoj ai.

Ky mendim e zbuti për së tepërmi dhe buzëqeshi me vete. Por, kur ndeshi në shikimin e ftohtë të së shoqes, i ngriu e qeshura në buzë. Në vështrimin e saj të ngulët dalloj stuhinë. «Në drejt të vejë», — tha ai me vete. — Më mirë të ngrihem dhe të dalim në bulevard. Po qe se do të kërkojë të shkojë nga e ëma, do të di si ta organizoj këtë copë kohë. Fundja, unë jam gjallë dhe kam gjithçka që më duhet».

Orjeta, sapo hyri në shtëpi, la çantën mbi makinën larëse dhe hyri në kuzhinë e u ul fare e kapitur. I dukej se në jetën e saj po ndodhte diçka e çuditshme: zhgënjimi nga një gjë që të është dukur krejt ndryshe.

— Të shoh të mërzhitur, moj bijë, — i tha e ëma, duke fshirë duart me përparësen dhe u ul pranë saj në minder.

Orjeta nuk foli. Ajo nuk e shpjegonte dot se si kishte ardhur në shtëpi. Këmbët i ishin bindur thujtë vetvetiu atij zakoni të vjetër. Ajo pa atë shikimin gjithë keqardhje të s'ëmës, dhe gjendja shpirtërore iu rëndua edhe më tepër.

— Nuk kam gjë, mama, — tha ajo pa e parë në sy, — veçse ndjehem pak e lodhur.

— Nga puna po vjen kështu?

— Drejt e nga puna.

— Po Mistoja do vijë? — pyeti e ëma, disi e shqetësuar, sepse i duhej t'i shtonte ndonjë gjë tryezës.

— Jo, nuk e lajmërova. Thashë t'ju shikoj njëherë, pa edhe vetë nuk do të rri.

— Ç'thua kështu, moj bijë, ti je e lodhur, të ka marrë uria. Jo, nuk të lë mamaja ty të ikësh, — tha ajo dhe u ngrit duke lëshuar atë «ohen» e saj, me të cilën Orjeta kishte nisur të mësohej këto kohët e fundit.

E ëma u ngrit të pregatiste ndonjë gjë, ndërsa Orjeta shkoi nga dhoma e pritjes. Sa hyri te dera, mërzia iu shtua akoma më tepër: ajo kishte qënë dhoma e saj e vajzërisë. Megjithëse tani në të rrinte i vëllai, Orjeta prapëseprapë gjente në të plot

kujtime të periudhës së vajzërisë, të asaj moshe kur ajo qe krejt e lirë dhe ëndërronte «të fluturonte» në jetë.

«Jo, unë nuk po fluturoj, — mendoj me dhembje Orjeta, — ndoshta nuk i kisha gati për fluturim krahët, ata janë ende të dobët. Me mua po ndodh si me atë zogun që gënjehet, bie nga foleja dhe mbetet në mëshirën e të vegjëlve, derisa të kalojë aty ndonjë njeri i kujdesshëm dhe ta vërë përsëri në fole».

Orjeta u ul në karrige pa fuqi dhe, me bërrylat mbështetur mbi tavolinë, vuri kokën midis pëllëmbëve të duarve. Ashtu si e mpirë ajo dëgjoi zilen e derës së jashtme me një të rënë të zgjatur. Ishte sinjali i babait. U ngrit, fshiu sytë dhe shkoi t'i hapte derën.

— O, kush na paska ardhur, kush na paska ardhur! — tha i ati, i gëzuar dhe e pushtoi të bijën me mall.

Ajo e ndjeu veten të lehtësuar dhe donte ta zgjaste sa më shumë atë çast përçafimi. I vinte mirë ta mbështeste kokën në gjoksin e t'et. Por ai e shkëputi nga gjoksi dhe ia vuri të dyja pëllëmbët nën gushë, si për ta parë më mirë. Atij iu desh vetëm një kryqëzim shikimesh që të kuptonte se tek e bija diçka nuk shkonte.

— Po Miston ku e ke, — tha ai me zë të lartë, duke e kapur për krahu të bijën.

— Kam ardhur vetëm, — tha Orjeta me zë të ulët, duke hyrë bashkë me të në kuzhinë.

— Po ai?

— Do të ketë shkuar në shtëpi, — u përgjigj ajo pa e shikuar.

— U ulën në tryezë. E ëma nisi të shtronte

drekën. Orjeta i shmangej shikimit hetues të t'et, megjithëse atje, në dhomën e saj të vajzërisë, i qe mbushur mendja se pikërisht atij, babait, duhet t'ia shpjegonte gjendjen e saj. Ajo e ndiente se ishte babai ai njeriu i mirë që do ta ndihmonte zogun të fluturonte. Orjeta, megjithëse nuk kishte oreks, nisi të hante, ashtu me zor, që prindërit hëpërhë të mos i mërziste.

Kur e ëma solli kafen, dhe babai sa ndezi cigaren e nisi ta thithte me tërë mushkëritë, Orjeta mendoi se ia arriti qëllimit, por pikërisht atëherë ai e pyeti:

— Pa më thuaj, si i ke punët, ç'ka ndodhur midis jush?

Orjeta nuk e priste këtë pyetje kaq të hapur, pa hyrje.

— Ja, diçka nuk shkon midis nesh, — tha ajo me sytë ulur, — kam nisur të kuptoj se ai nuk është ashtu siç mendoja.

I ati, duke ndezur cigaren që i qe fikur, nisi të mendohej.

«Po, vajza ka të drejtë. Me të vërtetë tek ai njeri ka diçka që nuk shkon, diçka të fshehur brenda tij, nën lustrën e jashtme, që mundohet ta mbulojë. Edhe vetë e kam vënë re një gjë të tillë. Ai në fillim dukej një djalë kokulur, me pikësynime të përcaktuara për jetën, i dashur e i respektueshëm».

Në fillim, kur e bija i pati treguar për dashurinë e saj, ai nuk e kishte pritur mirë. «E ku e njohu Orjeta atë djalë kaq shpejt?» Pa dyshim, kjo qe një njohje e përciptë. Ai kishte menduar se e bija do të lidhej me një njeri tjetër, kushdo që të ishte, por që do ta njihte për një kohë të gjatë, në shkollë e në punë. Por në fillim edhe atij i kishte pëlqyer

Mistoja, me ato sjelljet në dukje të çiltra e disi të matura. Ai kishte pyetur edhe për familjen e tij, edhe për rrethin familjar dhe nuk kishte dëgjuar gjë të keqe. «Le të martohen, — kishte menduar, — fundja, nuk është e thënë që dashuria e vajzës paktjetër duhet të kalojë nëpër atë rrugë që mendoj unë». Veç kësaj, edhe e shoqja s'e kishte lënë rehat. Asaj i kishte pëlqyer dhëndri me ta parë dhe s'donte ta zgjaste më tej fejesën e vajzës. Por këto kohët e fundit ai kishte plot rezerva për sjelljen e Mistos.

— Po mirë, — tha ai, duke shtypur cigaren në taketuke, — i keni diskutuar së bashku këto gjëra?

— I kemi diskutuar, si jo, por atij i pëlqen vetëm vetja.

— Por ti duhet t'i flasësh prapë e prapë, derisa ai të të kuptojë dhe duhet të bisedosh me të më me kujdes e jo të acarohesh. Fundja, midis burrit e gruas ndodhin edhe grindje, edhe keqkuptime.

— Por nuk janë të tilla, unë nuk e kam fjalën për ato, — tha Orjeta, duke i mbajtur lotët me vështirësi.

Ai nisi përsëri të mendohej, tashmë për Orjetën. Sa kohë i ishte dashur atij të punonte me të, ta pregatiste për jetën. Edhe kur u fejua, ai kishte ngulur këmbë që ajo të mos interesohej të qëndronte në Tiranë, por të shkonte tek i shoqi. Le ta nisnin jetën bashkë atje. Dhe Orjeta ishte dakord. Asaj i pëlqente të shkonte, e këtë dukej se e thoshte me sinqeritet. Por ishte në mes e shoqja; ajo gjithnjë ankohej e thoshte se s'mund ta kuptonte dot se si mund ta kishte vajzën aq larg. . . Dhe e kishte bindur,

më në fund. Por tani, më shumë se kurrë, ai e kuptonte që kishte gabuar e ndoshta do t'i duhej ta shlyente këtë gabim.

18.

— Ama, të vështirë e keni punën, por të nderuar. Ju zgjedhin me kokrra misri.

Lulëzimi e pa me kujdes shokun e dikurshëm të fakultetit, që tani punonte në një kooperativë bujqësore. Ishte kryellogaritar.

— Të gjitha punët kanë vështirësitë dhe kënaqësitë e tyre, — u përgjigj thjesht Lulëzimi.

— Po, megjithatë, ndryshe jeni ju, — nuk donte të tërhiqej tjetri.

— Jo, jemi krejt të zakonshëm, — buzëqeshi Lulëzimi. Thinjemi, vyshkemi, na zë ulçera, shqetësohemi për kalamanjtë...

— Po. Më vajti ora për mbledhjen. Ne vijmë rrallë këtu në Tiranë dhe vetëm kur na thërrasin për ndonjë punë.

Lulëzimi mbeti vetëm. Takimi me shokun e futi në ato shtigjet e bukura të jetës së dikurshme të studentit. Iu kujtua ajo koha e aksionit në Malësinë e Madhe.

Iu kujtua dhe dita e emërimit... Në fillim që habitur kur nuk e kishte parë emrin në listën e të emëruarve. Në dekanat i kishin thënë pastaj se që emëruar në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Atje e kishte pritur një burrë i thyer në moshë, me pamje të lodhur, por me dy sy të zinj, të dashur e tepër depërtues.

— Do të punojmë së bashku, — i tha ai, duke

i shtrënguar fort dorën.

— Po...

— Mos u shqetëso. Unë e fillova këtë punë kur kisha vetëm katër klasë shkollë. Ti i ke të gjitha. Atë që të mungon, do ta përvetësosh shumë shpejt, — i tha tjetri, që ia pikasi shqetësimin.

Qysh atëherë kishin kaluar disa vjet.

Lulëzimi u ngrit, pagoi kafet dhe u nis për në zyrë. Ai e donte punën, por, kur ishte pak më i ri, nuk mendonte se do të qe kaq i lidhur me të. I kujtohej i ati, i cili dikur, sa hante bukë e i hidhte një sy gazetës, ngrihej e shkonte në punë. Lulëzimi atëherë çuditej gjithnjë me babanë. Por ja që e njëjta gjë po ndodhte tani me të.

Ai hyri në zyrë dhe nxori materialin nga kasa-forta. Kësaj dosjeje i kishte vënë pseudonimin «I verbri». Në zgjedhjen e pseudonimeve ai thujse ishte bërë mjeshtër. Vetëm nga pseudonimi i një dosjeje mund të kuptohej përmbajtja dhe objekti i saj.

«I verbri»! Kjo dosje ishte hapur në bazë të një të dhëne të papritur, por edhe tepër të zakonshme; ajo ishte fryt i qëndrimit vigjilent të njerëzve tanë. Një qytetar kishte ngritur dorezën e telefonit dhe, para se të formonte numrin, kishte kapur një vazhdim bisede midis dy burrave, njëri prej të cilëve e fliste shqipen si i belbër e me një theks të huaj. Qytetarit i kishte bërë shumë përshtypje dhe e denoncoi që atë natë.

Lulëzimit nuk iu desh shumë kohë që të përcaktonte shtetësinë e personit që i jepte këto udhëzime. Për këtë e ndihmoi emri i Eriko Albanëzit, që ishte përmendur gjatë bisedës telefonike.

Po kush ishte shtetasi ynë, që kishte këto shqetësime në lidhje me doganën? Lulëzimit iu desh të

shkonte edhe atje. Kontrabanda ishte një nga çështjet për të cilat ai interesohej së tepërmi. Por, nga përvoja e punës së sigurimit, ai e kuptonte se ajo, në shumicën e rasteve, nuk qe diçka e thjeshtë: pas saj fshihej veprimtaria e spiunazhit. Zakonisht kontrabanda ishte faza e parë, nëpër të cilën kalonte kandidati, pas saj atij i propozohej herë hapur e herë tërthorazi, duke e tërhequr gradualisht në veprimtarinë armiqësore. Lulëzimi e kuptonte se detyra e tij ishte delikate. Për të ruajtur pastërtinë e njeriut tonë, ai duhej ta zbulonte e ta parandalonte që në fazën e parë veprimtarinë e tij në kundërshtim me ligjet.

Por ai u çudit kur mësoi se Mistoja, të cilin ai e njihte si djalë të pregatitur e nga familje e mirë, kishte sjellë mallra mbi normativë. Natyrisht atij nuk i shkoi aspak mendja për keq, jo se nuk kishite ndonjë bazë, por thjesht për besimin që gëzonte ky djalë. Në raste të veçanta, te ndonjë nga ata që shkonin jashtë shtetit me shërbim, nxirrte krye shpirti i makutit për plaçkurina. Njerëz të tillë i neveriteshin. Këta gjenin mundësi e bënin plot allishverishe për të shuar makutërinë e tyre.

Prandaj Lulëzimi i qe vënë punës. Ai kishte mësuar se Mistoja, i detyruar nga shokët, në mbledhje kishte thënë se këto ia kishte dhënë si dhuratë një shqiptar i emigruar, që njihej edhe si mik i vendit tonë. Deri këtu nuk kishte ndonjë të keqe shumë të madhe.

Lulëzimi u kujtua pse kishte dalë atë mbasdite në zyrë. Atij i kishte kërkuar një takim Iliri, të cilin e kishte njohur atë ditë që ai kishte marrë pasaportën për të udhëtuar jashtë shtetit. Më parë pati dëgjuar të flitej për të. Po tani për se donte të bi-

sedonte me të? Hamendjet e çonin vazhdimisht te materialet e dosjes «I verbri». U hodhi atyre edhe një sy dhe doli ta priste.

Iliri dukej shumë i emocionuar. Në sytë dhe në të gjitha lëvizjet e tij dallohej ajo brenga e nje-riut që kërkon një rrugëdalje.

— Ndoshta këto që do t'ju them nuk kanë ndo-një bazë shumë të shëndoshë, por unë gjykova se du-het të bisedoj me ju. Është më mirë t'i dini... — Ili-ri heshti. Ai i kishte menduar gjatë ato që do të thoshte, ndërsa tani e humbi fare me këto gjëra të palidhura që po i thoshte oficerit të sigurimit.

Lulëzimi e kapi hutimin e tij.

— Është më mirë të thoni në fillim thelbin e problemit, — e këshilloi Lulëzimi, duke i ndezur atij cigaren që e vërtiste në dorë, — pastaj të shkëm-bejmë mendimet.

— Është fjala për Miston, atë djalin me të cilin shkova atëherë për specializim.

— Bukur. A keni ndonjë shqetësim në lidhje me qëndrimin e tij atje?

— Ja si është puna, — dhe Iliri i shpjegoi me hollësi për atë natë që Mistoja qe vonuar de-ri në mëngjes. Tani mendimet e tij rridhnin mjaft qartë, kujtonte hollësi, në dukje të panevojshme, por që Lulëzimit dukej se i interesonin shumë, prandaj përpiquej të mos i shpëtonte asgjë.

— Si e justifikoi mungesën?

— Më tha se kishte qenë me Femiun, atasheun tonë të tregtisë. Por dje, në bisedë e sipër, Femiun më tha të kundërtën. Unë nuk i rashë fare në sy, por, të më besoni, që dje jam shumë i shqetësuar. Ndoshta po i bie më qafë kot.

— A ka pasur shoqëri me ndonjë student tonin atje, ose me ndonjë shqiptar tjetër të emigracionit, — donte të dinte Lulëzimi.

— Nuk ka pasur ndonjë gjë të veçantë.

— Ju nuk u njohët me Eriko Albanëzin?

— Unë dëgjova të flitej për të në ambasadë, por nuk patëm rast të njiheshim me të. Të them të drejtën, s'kishim shumë mundësi të dilnim, se programi ishte shumë i ngjeshur dhe koha e shkurtër.

— Po me ndonjë femër? — pyeti Lulëzimi, duke buzëqeshur si me turp.

— Më kishte folur nja dy herë për një vajzë. Dukej se i pëlqente të bisedonte me të. Quhej Eva.

— Nuk të ka thënë ndonjë gjë konkrete?

— Jo, — nxitoi të përgjigjej Iliri.

— Mirë bëtë që erdhët. Do t'i kemi parasysh këto gjëra. Ju e kuptoni dhe vetë se armiku mundohet të çajë në këtë drejtim. Mund të jetë diçka serioze, por mund të jetë dhe ordinere. Sidoqoftë, ju bëtë shumë mirë që na e thatë se...

— Më falni që po ju ndërpres, por harrova t'ju them se atë shënimin që më kishte lënë atë natë e futa në një libër, këtë e kujtoj shumë mirë. E kërkova para se të vija te ju, por nuk e gjeta.

— Ju thatë se kishit shumë gjumë atë natë. Ju ndodh shpesh kjo?

— Nuk më ndodh. Si rregull, mua më mjaftojnë 5-6 orë gjumë, jam mësuar kështu. Po dreqi e merr vesh, mund të kem qënë dhe shumë i lodhur.

— Mirë, shoku Ilir, — i tha Lulëzimi, duke e përcjellë deri jashtë, — edhe një herë ju falem nderit. Do të shihemi përsëri.

Antoni ecte poshtë e lart në zyrën e tij të madhe. Zhurma e hapave të tij mbytej nga qilimi tërë push. Ishte shumë i shqetësuar, i vinte të bërtiste, të zihej me dikë, ose të bënte ndonjë marrëzi çfarëdo. E gjithë kjo gjendje e vështirë shpirtërore, i gjithë ky tallaz, kjo egërsi ishte shkaktuar nga ajo kërkesa e qëndrës për të marrë takim dhe për t'i dhënë detyrat «kafesë». «Si është e mundur të më ngarkojnë një detyrë të tillë idiote, — mendonte me vete Antoni, — a mund të bëhet kjo në një situatë të tillë?! — Kjo nuk është punë zbulimi, është thjesht një marrëzi, një sadizëm. Si mund të merret kaq shpejt në lidhje agjenti pa u sistemuar, pa u qetësuar, pa menduar për gjëndjen në të cilën ndodhet. Kjo është një periudhë e domosdoshme, nuk është një kërkesë formale». Antonit i vinte më shumë inat me Georgin, kolegun e tij, tek i cili kishite shumë besim, që pranonte të jepeshin udhëzime të tilla. Fundja, ai u kishte dërguar disa informacione që, megjithëse pak të zbeta, këtë e kuptonte edhe vetë, prapëseprapë hidhnin dritë mbi gjëndjen në Shqipëri.

Po Antoni do ta zbatonte urdhrin e qëndrës, megjithëse ishte i bindur se, po të dështonte, përgjegjësia do të mbetej mbi të. Për këtë do ta ndihmonte e shoqja. Fundja, me këtë rast ajo kryente jo vetëm një detyrë shtetërore por, në radhë të parë, detyrën bashkëshortore, se «po të demaskohem unë, ç'fitim ka ajo?» — mendonte ai. Ndërkaq ndaloi përpara dritares së mbyllur dhe vuri re një mizë që përplasej në xhamin e pastër. «Nuk e kupton, — mendoj, — por edhe unë vetë i ngjaj kësaj mize;

megjithëse e ndiej që kam përpara një pengesë të fortë, përsëri duhet të përpiqem ta kapërcej. Ndryshimi midis nesh është vetëm se miza vepron me instinkt, kurse unë, përveç instinktit, nxitem dhe nga frika.

Antoni doli nga zyra dhe hyri në garazh. Ai ndenji atje plot një gjysmë orë duke u menduar e duke pirë cigare. E shoqja erdhi, ndezi makinën dhe u nisën. Antoni, i mbuluar me batanije, ishte shtrirë në ndenjësën e pasme. Gjithë puna ishte që, në qoftë se e ndiqte sigurimi shqiptar, të mendonte se në makinë ishte vetëm e shoqja. Ai e ndjeu që u larguan nga polici roje i ambasadës dhe hynë në rrugën e gjerë. Shpejtësia e makinës u rrit; e shoqja ishte e zonja në timon. Pastaj u ngrit, hoqi batanijen dhe pa përjashta. Nga pas dukeshin dritat e një makine. «Me siguri janë ata», — mendoi ai dhe u maskua përsëri, por makina u kthye dhe humbi.

— Duhet të ketë qenë ndonjë makinë e rastit, — tha e shoqja, që e kuptoi ankthin e tij dhe e ktheu makinën majtas. Gomat vërshëllyen dhe ai u mbajt që të mos përplasej.

— Gati, — tha e shoqja.

Antoni hapi derën. Shpejtësia u ul menjëherë dhe ai u hodh nga makina në një vend të pandriçuar mirë. Vështroi majtas e djathtas dhe buzëqeshi me shkathtësinë e së shoqes, që e nxori aq mirë nga situata. Ndezi një cigare dhe u nis për në liqenin artificial. «Takimet në vend të hapur janë plot avantazhe», mendoi ai i gëzuar dhe u nis me hap të ngadalshëm. Ai qe pregatitur enkas për këtë takim; kishte vënë një palë mustaqe të zeza e të trasha që të binin në sy, kostumin e kishte të zakonshëm, ndër-

sa flokët i kishte krehur ndryshe. E shoqja e ambasadorit ishte, dreqi e mori, mjeshtre për maskimet. Atë punë ajo e bënte me kënaqësi, se tërë ditën s'kishte punë tjetër, veç merrej me atë qenin e saj të mallëkuar. Antoni pa dy vetë që ecnin drejt tij dhe, si thithi cigaren, nisi të vërshëllente melodinë e një kënge shqiptare nga ato të moçmet. Kur ata u afruan, zemra i rrahu si një shpendi të plagosur; por ata, të zënë në bisedën e tyre, nuk e çanë fare kokën për të. Pasi vëzhgoi disa herë se mos i ishte qepur prapa ndonjë «bisht», u bind se askush nuk interesohet për të dhe hyri në park, gjithnjë si një njeri që kishte dalë për t'u çlodhur. Donte akoma dhe dhjetë minuta të takohej me «kafenë». Vëzhgoi edhe një herë me kujdes vendin dhe u bind që lëvizje nuk kishte fare. Ishte kohë e ftohtë, hëna ndriçonte pak. «Kohë e bukur për dashnorët» — mendoi ai në çast, — por parku megjithatë është bosh... Aq më mirë, — tha me vete, dhe u ul në një stol e nisi të shikonte hënën që thërrmohej në degët e pemëve. — Ç'mrekulli! Këta kanë me të vërtetë natyrë të bukur!» Ndërkaq veshi i mprehtë i tij kapi fëshfërimën e lehtë të gjetheve të thara dhe ktheu kokën në atë drejtim, por në fillim nuk dalloi asgjë. Megjithatë nuk e largoi shikimin andej dhe pas pak dalloi siluetën e një njeriu. Antonit i hynë të rrëqethura në trup. Po sikur të mos qe «kafëja», po një punonjës i sigurimit? Natyrisht ai edhe për këtë qe menduar; me vete mbante edhe një lehtënjoftimi shqiptare të përgatitur me kujdes, kish-te sajuar, si të thuash, edhe «biografinë» e tij. Në qoftë se ata do të ngulnin këmbë ta merrnin me vete, atëherë do të nxirrte pasaportën e diplomatit. Kur Antoni ndezi cigaren, tjetri i qe afruar.

— Ju lutem, ta ndez. . . — i foli silueta.

Antoni e njohu zërin gjithë emocion të «kafesë» dhe u qetësua. I zgjati edhe atij një cigare dhe u ulën të dy për të biseduar më me qetësi. . .

Pas një ore Antoni shkoi në hotel «Dajti». Atje gjeti makinën e tij, hapi derën me çelësin rezervë, ndenji të priste të shoqen. Morali i agjentit ishte çuditërisht i lartë. Ai nuk i quante për gjë këto kontakte, përkundrazi, i pëlqente kjo jetë e dyfish-të dhe ishte gati të jepte të dhënat që i kërkoheshin. Ai mund t'i studjonte me kujdes revistat teknike dhe prej tyre të nxirrte listën e pajisjeve që duheshin porositur në vendin e Antonit. Çfarëdo makinerie mund të qe, mjafton që të bëhej tregti. Antoni qe munduar t'ia ulte pak atë entuziazmin, e këshilloi të ishte i matur në marrëdhënie me të tjerët, të mos bënte asnjë koment për jetën jashtë shtetit, sepse mund ta pësonte, dhe, veçanërisht, të forconte lidhjet me njerëz që mund ta ndihmonin për zbatimin e detyrave.

Pas një gjysmë ore e shoqja doli në derën e hotelit. Antoni ndezi dritat e shkurtra, sinjal ky i lënë që më parë; ajo hyri në makinë dhe u nisën. Kur i ishin afruar ambasadës ajo e pyeti:

— Si dole?

— Mrekulli, — u përgjigj Antoni krenar edhe për të shoqen dhe u struk prapë nën batanije. . .

20.

Mistoja hyri gjithë qejf në shtëpi. Sa hapi derën e kuzhinës, ndjeu t'i përplasej në fytyrë një afsh i ngrohtë. Kishte mërdhirë. Jashtë frynte një erë

e ftohtë, me një shi të hollë. Mistoja ndjeu erën karakteristike të mishit të pjekur dhe e shpjegoi menjëherë atë boshllëkun që ndiente gjatë gjithë kohës që ishte me Kiçon, me të cilin tani mbante marrëdhënie të ngrohta si më parë.

— Zhvishu, — i tha Orjeta me zë të butë, kur i pa këpucët të lagura, — do të na bësh pis.

— Këtu qënka shumë ngrohtë, — tha ai, i dembelosur, por megjithatë doli jashtë. Pas pak hyri brenda i veshur me pizhama. Flokët i kishte krehur me kujdes dhe, megjithëse i kishte fshirë, i rrinin ngjitur pas koke.

— Kam një surprizë për ty.

Orjeta ngriti kokën dhe e pa me dyshim. Kish ca kohë që po kalonin një periudhë qetësie midis tyre.

— Ç'është kjo?

— Gjeje.

— Të lutem mos më lodh.

— Jo, nuk dua të të lodh. Do të shkoj me një shërbim jashtë shtetit. Të kisha thënë se, po u plotësua pasaporta, është njëloj sikur të thuash «hapi derën së mirës». Je e gëzuar?

— Natyrisht. Por nuk dua më nga ato telashet e doganës. — Orjetës iu kujtua biseda me babanë.

— Mos u shqetëso për këtë. Unë nuk jam më fillestar... — por buzëqeshja iu shua sakaq, kur vuri re si u ndez flaka në sytë e saj. «Është një lustër kjo harmonia jonë, — mendoi Mistoja, — një lustër që mundohet të mbulojë të çarat e mëdha. Vetëm fëmija në qoftë se u jep fund këtyre kontraktave. Po a do t'u jepte me të vërtetë fund?»

Mistoja kish kohë që i kishte flakur tej ato parimet e besnikërisë bashkëshortore. Ai lutej vetëm për një gjë: të bënte një jetë formale me të shoqen, le të ishte kjo hipokrizi, por, ama të mos ishte i lidhur ashtu si skllav pas saj. «Eh, duhet të kesh dy jetë që ta sakrifikosh njëren për parimet», — mendonte Mistoja. Ai u ngrit e shkoi te bufeja për të marrë shishen e konjakut.

— Kam disa simptoma gripi, — deshi të shfaqësohej ai përpara së shoqes.

— Si shpesh të vizitojnë ato viruset e gripit, — e thumboi ajo dhe, e pakënaqur, doli nga kuzhina. Pas pak u kthye me një lëmsh leshi ngjyrë trëndafili dhe me shtizat.

Mistoja, kur pa shtizat në duart e holla e delikate të saj, i shkëlqyen sytë. «Hë, — mendoj, — e gjeta çastin për normalizimin e marrëdhënieve dhe tani duhet ta shfrytëzoj me kujdes».

— Për vajzën? Gjëpura, ç'merresh me to! Këtë rrugë do ta shfrytëzoj vetëm për vajzën, e kam planifikuar. Po mendoj t'i marr dhe karrocën, se... ç'karroca janë ato që prodhohen këtu! Ti vetëm më gjej ndonjë katalog, se të tjerat i rregulloj vetë.

Orjeta e pa për një çast vëngër. Iu kujtua edhe një herë biseda që kishte bërë me babanë dhe, tek e shikonte ashtu me flokët e lëpirë, me shishen e konjakut përpara, mezi e përmbajti veten.

— Do të bëje më mirë të mendoje më shumë për punën, sesa për rraqet, — i tha ajo.

— Ne po diskutojmë këtu për kohën time të lirë dhe për xhepin tim; atje, në zyrë, me eprorët e mi, kam plot kohë të merrem me problemet e punës. Por kam vënë re se si shumë ke filluar të

bezdisesh nga ca mendime të miat, që s'janë tjetër veçse në interes të familjes.

— Kam të drejtë, sepse vetëm tani, kur shprehe një mendim, e përmende kaq herë «interesin». Ja, për këtë nuk më vjen aspak mirë, dhe dije se nuk duam të përsëritet më ajo historia me doganën. — Zëri i Orjetës ishte shumë i ashpër.

— Cilët ke parasysh kur thua «ne»? — e pyeti Mistoja me një ton tashmë të hapur armiqësor. — Mos përfshin këtu edhe babin e mamën? E di, ata janë shumë parimorë, prandaj e kanë shtëpinë të zbrazur, si kishë. E di që të yshtin në vesh, sepse ne për dy-tri vjet e kemi bërë shtëpinë krejt moderne. Të të vijë turp që flet kështu.

— Gjellën e ke mbi sobë, — i tha ajo dhe doli nga kuzhina.

— Helmin, thuaj, — bërtiti Mistoja dhe përplasi gotën e konjakut në murin përballë.

Orjetës iu duk se bashkë me gotën, edhe asaj iu thye diçka përbrenda. U shtri në krevat e mbytur nga dënesat.

— Përse të më ndodhë kështu, përse!?!...

Mistoja u ngrit dhe, i tërbuar nga inati, bridhte lart e poshtë nëpër kuzhinë.

«Ja dhe jeta familjare, ja dhe shoqëria, ja dhe liria. Liria! Njeriu nuk është i lirë të bëjë si të dojë. Po ta kthejë kokën majtas ose djathtas, e godasin me tërë forcën. Kështu ma bëri kolektivi e organizata e Partisë për ca plaçkurina që solla, kështu ma bëri Këçoja, shoku i ngushtë, gjoja, kështu ma bëri dhe vjehri, njeriu parimor, dhe ja tani, grua-ja... Pse drejtin nuk më lënë të qetë ta ndërtoj jetën ashtu siç dua vetë! Hajde pastaj të mos pëlca-

sësh». Dhe u afrua te tavolina, por, kur u kujtua që e kishte thyer gotën, rrëmbeu shishen e nisi të pinte me të.

Natën vonë i doli gjumi dhe e pa veten të shtrirë në divan; këmbët nuk i ndiente fare, i kishin hyrë një palë të dridhura e koka i qe rënduar. Kur u ngrit të merrte ndonjë mbulesë, vuri re se kishte vjellë.

21.

Në mëngjes nuk i folën njëri-tjetrit. Lëviznin në shtëpi si dy hije; secili mundahej t'i shmangej shikimit të tjetrit, secili bluante mendimet e veta. Dhe kjo prishje ndodhi pikërisht para nisjes së tij. Orjeta u përgatit për në punë dhe, kur doli te dera, diç mërmëriti nëpër dhëmbë, diçka që mund të kuptohej si «rrugë të mbarë!». Mistoja priste që ajo t'i fliste e para, por kur e pa që iku, ai përsëri nuk e ndjeu veten mirë. Iu duk sikur një dorë e padukshme ia hoqi gjithë energjitë dhe, duke mos e duruar dot këtë gjendje, u ul pa fuqi në divan. Pastaj gjeti forca të afrohej deri te dritarja. E pa Orjetën që u fut në turmë me hapa të ngathët. «Pse dola në dritare, — mendonte, — kush e kërkon Orjetën, unë, apo ajo sedra ime?» Po s'e zbuloi dot. U kujtua se duhet të ikte për në aeroport, mori valixhen dhe përplasi derën me forcë. Ai mendoi se, sapo të shkëputej aeroplani nga pista, do të shkëputeshin dhe ato fije të padukshme që e lidhnin me të shoqen dhe... me gjithçka...

Orjeta kishte hapur dokumentet pa qejf dhe për-

piqej që nëpërmjet punës të largonte ato mendime ogurzeza që e mundonin. Por qe e pamundur. Për të njëqindtën herë kujtonte se ishte gabuar në zgjedhjen e shokut të jetës, se kishte rënë viktimë e papjekurisë së saj. Po ç'të bënte tani! A duhej të vazhdonte më kjo gjendje? Të ndahej?... Po turpi, opinioni... po fëmija... Ç'faj kishte fëmija? Iu kujtua ajo natë kur ndjeu për të parën herë lëvizjet e foshnjës. Ky është çasti kur çdo grua ndien lumturinë më të madhe në jetë, kur do ta ndajë atë patjetër me njeriun e saj më të afërt, me shkaktarin e kësaj lumturie. Po atë natë ata sapo ishin grindur...

Ndërsa kujtonte këto, Orjetës iu ngatërruan mendimet, filluan t'i mjegulloheshin dhe për një çast iu duk se po shkiste në një humnerë të thellë e të pafund, nga e cila në fillim ndjeu tmerr e llah-tar, por gradualisht u mësua me gjendjen, nisi ta ndiente veten të gëzuar e të lumtur dhe u lëshua me tërë kënaqësinë drejt së panjohurës...

Kur hapi sytë dhe pamja e mjegulluar nisi t'i kthjellohej, ajo pa një tavan shumë të bardhë, mure, krevate... E kuptoi që ndodhej në spital, po përse?

— Ku jam? — tha ajo. Zëri iu duk si i huaj dhe sytë i rëndonin. — Ku jam? — tha prapë dhe përsëri nuk e njohu zërin e vet.

— Mos u shqetëso, moj xhan, ti je fare e re. Me siguri do të lindësh të tjerë, — dëgjoji një zë shumë të ëmbël.

— Sot mora vesh se Orjeta kishte dështuar, —
i tha Diana Ilirit.

Ai ngriti sytë nga libri dhe lëvizi pak nga vendi. U duk shumë i shqetësuar.

«I çuditshëm është ky Iliri, — mendoi Diana, — shumë i çuditshëm, dhe sa është dobësuar! Ky jeton me shqetësimin e të tjerëve.

— Duhet shkuar! — këtë mendim ai e tha me tonin e një urdhri. — Aq më tepër që s'e ka as të shoqin.

— Po ka prindët, — nxitoi të thoshte e shoqja.

— Dëgjomë mua, sëmundja bëhet më e lehtë kur të vijnë të tjerët.

— Mirë, — tha Diana, — shkojmë nesër.

— Nesër! Ama ç'grua që kam dhe unë, — tha me shaka. — Sot le të shkojmë, tani...

Eva po i kalonte ditët në limonti. Asgjë e re, asgjë që të tërheq. Jeta ishte bërë e shtrenjtë dhe ajo nuk e ndiqte dot as modën. Ngandonjëherë i mbushej mendja të martohej dhe t'ia linte atë barrën e rëndë të veshjes të shoqit, por këto ishin vetëm mendime. Ajo nuk mund të bënte një budallallëk të tillë! Për atë martesë ishte një kurth, një fatkeqësi që u binte mbi kokë atyre njerëzve dritëshkurtër e të brishtë që nuk ecnin dot me këmbët e tyre. Sidoqoftë ajo mundohej të thithte sa më shumë nga nektari i jetës. Falë studimeve dhe miqve, ajo kish-

te mundur të përcaktonte qëndrimin e saj në jetë; i vinte të qeshte me ato mendimet e mykura të ca vajzave të rëndomta për virgjërinë. Bukur i kish thënë një mik i saj, ndoshta i treti ose i katërti, i cili në një çast intim bëri budallallëkun e pafalshëm t'i propozonte të martohej. Po, bukur e tha: «Virgjëria s'është gjë tjetër, veçse një nocion». Këto për Evën qenë gjëra krejt pa rëndësi, e rëndësishme ishte vetëm kjo: të jetoje mirë dhe pa e çarë kokën për asgjë, se jeta vetëm një herë jetohet.

Mendime të tilla tek ajo kishin depërtuar nëpërmjet rrethit të saj shoqëror, ishin rrënjosur e shkrirë një me qënien e saj.

E humbur në këto arsyetime pa fund për jetën, ndjeu t'i digjeshin gishtërinjtë nga cigarja. E lëshoi mbi qilim dhe pastaj e kapi me kujdes për ta vendosur mbi taketuke. «Eh, — mendoj, — jetë pa variacion!» Dhoma ishte me pak mobilje të vendosura pa shije. Veçse muret ishin të pasura. Në to vareshin disa piktura të kohës, dhuruar nga një mik i saj piktor. Ai i kishte hequr një nga një ato piktura që më parë i quanin të realizmit socialist. Piktura! E ç'vlerë kishin ato? Hiç asgjë! Një fotografim i keq i realitetit. Sot, kur ka dalë fotografia me ngjyrë, i iku koha kësaj pikturë. Bile dhe Rembrandti ose Mikelanxheloja po të ishin gjallë, do ta kishin flakur tej penelin dhe do të merreshin me artin e vërtetë...

Këto mendime ia ndërpreu zilja. Eva u habit, nuk priste njeri. Kush të qe vallë? Mos ndonjë nga ata të parët? Ç'mërzi! Si u ndal pak përpara pasqyrës e u bind se çdo gjë ishte në rregull, hapi derën.

Përballë saj qëndronte Georgi.

— Si është vogëlushja jonë e zgjuar? — pyeti ai dhe, pa e ftuar njeri, hyri në dhomë e u ul mbi një kolltuk, doreza e djathtë e të cilit lëvizte nga vendi.

— Ju falemnderit, — belbëzoi ajo, disi e hutuar. «Siç duket, këta ma paskan përsëri nevojën. Mos vallë ndonjë rast tjetër?!» Ajo e kuptonte që ishte e bukur, e zgjuar... por i vinte ca rëndë kur e përdornin si grep për të zënë ca peshq të rrallë. «Po të jetë ndonjë rast si ai i fundit, nuk është keq», — mendoi dhe nxori nga bufeja një shishe uiski dhe dy gota me fron të lartë. Duhej pritur mirë Georgi.

— Të mora një javë leje, — i tha ai, duke e ngritur gotën dhe, si e ktheu deri në fund, shtoi: — një punë që do të të sjellë kënaqësi dhe një honorar plotësisht të pranueshëm.

Eva u ul kundruall tij dhe i zgjati kutinë e cigareve.

— Dhe tani të kalojmë në problemin tonë, — tha Georgi me ton serioz e duke përplasur buzët e skuqura gjith tul dhe nxori nga çanta një tufë fotografish e i hodhi mbi tryezë. — Në fillim duhet të rikujtosh me hollësi të gjitha çastet, skenat. Kjo është e domosdoshme që të mos takohesh me të si me një të huaj, por si me një njeri tëndin. Kupton?

Eva lëvizi kokën hijshëm dhe mori në dorë tufën e fotografive. Nuk mund t'i shikoje ato pa u skuqur, aq më shumë në praninë e një tjetri, dhe Evës iu ndez fytyra.

Georgi e pikasi gjendjen shpirtërore të saj, u ngrit dhe doli nga dhoma. Pas pak Eva ndjeu të kërciste dera e banjës. Ajo e mblodhi veten dhe ajo

ndjenja e turpit u tërhoq derisa u fshek me kujdes diku. Vëndin e saj e zunë kujtimet e ëmbla...

— E vlen të shihem përsëri me të, — tha Eva me zë të lartë, duke i lënë fotografitë me kujdes mbi tavolinë.

Georgi hyri brenda në çastin e duhur, u afrua, ndenji në kolltuk dhe hapi magnetofonin e tij portativ. Eva dëgjonte zërin e vet me vështrimin të përqëndruar në një pikë dhe mahnitej me efektin e jashtëzakonshëm që i shkaktonte dialogu.

Pastaj u ngrit rrëmbimthi dhe shkoi të vishej, ndërsa Georgi u rehatua në kolltuk, mbushi edhe një gotë me uiski dhe e piu për shëndetin e psikologjisë, të kësaj shkence që bënte çudira, po që se e zotëroje mirë.

24.

— Përfunduar një marrëveshje me leverdi, — tha Mistoja, duke u mbështetur në ndenjësën e prapme të veturës. — Ti e vërtite mirë, nuk më besohej se do të arrihej ky rezultat.

— Ç' thua, ti e njeh mirë zanatin tënd. Manovro ve mirë me reklamat dhe katalogët e tyre, — u përgjigj pa e parë Femiun, që qëndronte pranë shoferit.

— Nesër më duhet të iki. Të them të drejtën, u mërzita. Të fortë jeni ju që qëndroni me vite në vende të huaja.

Femiun nuk u përgjigj.

Mistoja ndezi një cigare dhe nisi të vërente kalmimtarët. Ai e shikoi disi me përçmim atë qafën e Femiut, që shtrëngohej fort nga këmisha e bardhë,

dhe pjesën pa flokë prapa kokës. «Edhe mirësjellja ka një kufi, — mendoj Mistoja, — ky m'u qep tërë këtë ditë dhe nuk m'u nda. Pa le, insistoi të flija edhe në ambasadë. Këtu je më i sigurt, ndryshe po të ishe me një shok», — kishte arsyetuar Femi. Dhe Mistoja, donte s'donte, pranoi.

Pastaj sytë e tij u bënë ëndërrimtarë dhe në fytyrë i ra një nur i bukur. Kujtoi Evën. Eh, ç'fëmër gjarpërushe. Dhe sa të freskëta i kishte ajo kujtimet e dashurisë. Atij i vinte turp që, i zënë me telashet e tij, e kishte lënë ca pas dore dashurinë e tyre. Natyrisht Mistoja e kuptonte se këtu ishte dora e sjelljeve tepër xhentile të Georgit. Ai mundi të shkëputej dy-tri herë nga Femi për të kryer detyrimet e tij. Sugjerimet e Georgit për marrëveshjen ai i zbatoi pikë për pikë dhe nuk i doli keq. U krijua përshtypja se marrëveshja ishte e leverdishme. Kjo ishte pjesa më e rëndësishme e planit. Por Mistoja shikonte dhe leverdinë e vet në këtë çështje. I hodhi përsëri një shikim qafës së Femiut dhe u tremb nga mendimet e tij. Jo, këtë sekret duhet ta merrte me vete deri në varr. Duhej treguar i matur, të përdorte mirë artin e zotërimit të dy gjuhëve, se, ndryshe... Ai nuk do të bënte më ato gabimet idiote të takimeve të organizuara me aq mendjelehtësi. Jo, kjo nuk kishte për të ndodhur më...

— Ti akoma nuk bleve ndonjë gjë simbolike për në Shqipëri, — ia ndërpreu mendimet Femi, duke u kthyer nga ai e duke e parë me një shikim të përqëndruar.

— Gati harrova, — u përgjigj Mistoja, — besoj se do të më shoqërosh sot mbasdite. Megjithëse, të

themi atë që është, këtu nuk ka ndonjë gjë të veçantë, — shtoi ai, duke ia shpërblyer po me atë shikim të përqëndruar e hetues.

— Tani të ndalojmë të pimë ndonjë gjë freskuese, — i tha Femi shoferit dhe i tregoi vendin ku do të linin makinën.

25.

— Le të pushojmë pak, — i tha Lleshi Ilirit dhe stakoi sharrën elektrike.

Të dy u ulën mbi pishën e prerë dhe nisën të dridhnin cigare. Ilirin gjithnjë e kishte tërhequr puna e sharrëxhinjve; donte të bënte aty një studim.

Nga përvoja e dinte se për zgjidhjen e një problemi, më shumë se kushdo tjetër, të ndihmojnë ata që do të merren me vënien e tij në jetë, kështu që ai kishte zgjedhur një nga brigadat e sharrëxhinjve dhe kishte ardhur të punonte me ta. E kishin caktuar ndihmës me Lleshin, një njeri babaxhan, me trup të drejtë e të fuqishëm si vetë pishat.

Që në fillim Iliri u kishte shpjeguar shokëve të brigadës qëllimin e studimit. Ata e shikonin me respekt, por jo pa një farë habie, sepse vetëm këta dy vjetët e fundit i kishin rritur normat 25 përqind. Megjithatë i premtuan se do ta ndihmonin.

Ishte dhjetor. Pishat, ashtu të ngarkuara me dëborë, dukeshin sikur qenë stolitur gati për festën që po afrohej. Në fillim Iliri e ndiente shumë të ftohtët, por tani dukej se i ishte përshtatur atij, nuk i bënte fare përshtypje, ndoshta ngaqë nuk i kishte dëgjuar kurrë sharrëxhinjtë të ankoheshin.

Ai çuditej në fillim me ta, sapo dilnin nga fjetorja, ata ecnin me ca lëvizje të lira, pa u nxituar, «për t'u nxehur», futeshin gjithë oreks në mensë, i këputnin ndonjë thumb kuzhinierit dhe niseshin për në punë.

— Çfarë pune të ka bërë babai, o Ilir, — e theu heshtjen Lleshi.

Iliri e shikoi kushedi për të satën herë atë fytyrë të kuqërremtë të Lleshit. Ai e donte shumë këtë njeri fjalëpak. Qëllonte që ata punonin tërë ditën dhe nuk ndërronin biseda të gjata me njëri-tjetrin.

— Ka qenë bujk, — iu përgjigj ai. — Po pse pyet, — shtoi pas pak për t'i dhënë çikë bisedës.

— Jo ashtu, pyeta, — tha Lleshi, që thithi fort cigaren e i hodhi sytë andej nga qenë shpërndarë shokët, nëpër pyll. Pastaj heshti.

Iliri e ndjeu veten ngushtë. «Mos vallë më pyeti sepse mendon që po punoj keq», — i shkoi nëpër mend dhe u shqetësua.

— Në fillim, kur erdhe me mua, mendova se nuk do ta përballoje dot këtë lloj pune, — tha Lleshi, duke shikuar drejt përpara. — Ne kemi një fjalë të urtë këtej nga malësia: «mikun e presim sipas kllejikut dhe e përcjellim sipas kokës», — heshti një çast dhe nisi të dridhte edhe një cigare tjetër, — prandaj të pyeta për punën e babait.

— Eh, — tha Iliri i zënë ngushtë, — është shpejt akoma të gjykosësh për mua...

— Moti i mirë duket që në mëngjes, — e ndërpreu Lleshi. — Veç për një gjë po çuditem: si do ta bësh ti këtë studim se, të them të drejtën, un nuk shoh as të shkruash, as të lexosh.

Ilirit i erdhi për të qeshur singerisht me çiltërsinë e tij. Pastaj nisi t'i shpjegonte... Lleshi, duke parë shënimet në atë bllok të vogël të xhepit, gjithnjë e më shumë po kuptonte ato që i thoshte. Më në fund, si heshti Iliri, Lleshi i tha:

— Ehu, or burrë i dheut, ku të paska shkuar mendja! E ne mendojmë se s'kemi asnjë rezervë për të shfrytëzuar. Po me inxhinierin tonë a ke biseduar?

— Posi... Ai edhe më ka ndihmuar... — i tha Iliri duke buzëqeshur.

— Qenke dreqi vetë, — i tha dhe u ngrit në këmbë, ndërsa edhe sytë i qeshnin. U ngrit dhe Iliri. Lleshi bëri një hap përpara, e pushtoi fort për shpatullash dhe, si e ngriti peshë, e vërtiti rreth vetes. Iliri mbeti si i shastisur dhe, ashtu i kapur fort pas Lleshit vigan, e la trupin të lirë. Pastaj, pasi e lëshoi, i dha një të tundur një pishe të vogël, e shkundi borën prej saj dhe e shikoj Ilirin me dashuri.

— Ja, unë jam i fortë boll besa, por ama mendja nuk më ka shkuar në këto punë. Është si puna e asaj amvisës së mirë që e mbledh gjënë pika-pika e ti çuditësh kur të thotë: «Po kemi, mor burrë, ja ku e kemi». Të lumtë! Hajde tani se shokët po na lënë prapa.

26.

Mistoja nuk u çudit shumë që Orjeta s'kishte dalë ta priste: ajo ishte e rënduar nga barra. Në aeroport e priste, për çudi, Kiçoja. U përqaftuan.

— Më tha drejtori të të pres dhe, të them atë që është, mua ma kishte qejfi, — tha ai, duke e

shtrënguar fort pas vetes. — Na thanë që dole me sukses, — shtoi ai.

— Po. Ç'kemi ndonjë të re, nga shtëpia si janë?

Kiçoja u përtyp ca. Por, fundja, përderisa Orjeta tani ishte mirë, mund t'ia thoshte të vërtetën.

— Orjeta ka qenë ca ditë në maternitet. . .

— Si, pse?! — Në fytyrën e Mistos u pasqyrua frika dhe shqetësimi.

— Mos u shqetëso. Tani është fare mirë, dje bisedova me të në telefon, ishte tek i ati. Veçse fëmijën e dështoi.

Mistos i erdhi me të vërtetë keq; kishte sjellë tërë ato vogëlina, po foshnja nuk do të ishte më. Kushedi sa do të qe mërzhitur Orjeta. Për herë të parë, pas gjithë këtyre ditëve, ai mendoi për marrëdhëniet me të. Ai shpresonte se koha e shkurtër e ndarjes do t'i sheshonte mosmarrëveshjet dhe ata do të shkonin përsëri mirë. Ai ndiente akoma dashuri për Orjetën, aq më tepër kur ishte pranë saj, se çdo njeri ka nevojë për një grua, mendonte dëndur ai.

«Çudi me këta të dy, — mendonte ndërkohë Kiçoja, — ky u shqetësua, ndërsa së shoqes, kur i thashë se Mistoja do të kthehej sot, s'i bëri përshtypje fare. Ç'dreqin do të kenë? Apo ndoshta ka qenë e shqetësuar për dështimin. Çupërlina, çilimllëqe. Sikur nuk janë të rinj e nuk mund të bëjnë akoma një vatër fëmijë».

Rrugën e bënë pa folur. Edhe një shakaje të Kiços, Mistoja nuk iu përgjigj fare.

Mistoja i ngjiti me ngut shkallët e shtëpisë. Uli valixhet për tokë dhe i ra ziles. Ishte me të vërtetë i prekur që do të takohej me të shoqen. Që rrugës kishte thurur një plan të bukur për t'i hequr mër-

zinë Orjetës. Do të kërkonte disa ditë leje dhe do të udhëtonin të dy në bregdet. Kjo do të ishte çlodhëse jo vetëm për Orjetën, por do të ndihmonte edhe për të dy. I ra edhe një herë ziles, këtë radhë pak i shqetësuar. «Mos vallë nuk është, — mendoj. — Si ka mundësi? Ajo e dinte që sot do të kthehesha». Pa prituri i hipi një valë zemërimi. E hapi derën me çelësin që kishte me vete dhe hyri brenda. Këmba i zuri në një çelës. U ul i dërrmuar dhe e mori në dorë. E vërente me kaq kujdes sikur prej tij mund të zbulonte diçka. Ngeli në korridor pa ditur ç'të bënte. Pastaj bëri një përpjekje për të lëvizur nga vendi, po këmbët nuk po i bindeshin. U ul mbi valixhe dhe ndezi një cigare, pastaj, ashtu siç qe ulur, futi çelësin në bravë, dhe u vërtetua që ishte i Orjetës. Ai i hodhi një sy dhomës. Mbi tryezë vuri re një letër. . .

«Ne nuk mund të jetojmë më bashkë»

Letra qe shkruar pesë ditë pas ikjes së tij.

«Ja dhe jeta ime e lumtur bashkëshortore mori fund në mënyrën më të palavdishme», — mendoj Mistoja, duke liruar gravatën. Thellë në ndërgjegjen e tij nuk u prek për atë që ndodhi. Atij i dukej se qe çliruar nga një barrë tepër e rëndë, se kishte fituar përsëri atë lirinë e një njeriu të shpenguar, të rritur mirë e të pavarur nga jeta. Por, në të njëjtën kohë, e kuptonte fare mirë se tani do të niste për të një jetë plot peripeci, jo se ai do të martohej përsëri. Jo, Mistoja që tani mori vendim se martesë e parë qe një veprim prej axhamiu, por ai shqetësohej për fatin e tij. Gjyqet, përmbarimi, organizata e Partisë, kolektivi shokët, familja, të gjitha do të

merrnin pak nga lustra e tij dhe ai do të ngelej krejt lakuriq, në mëshirën e fatit. «Kushedi ku do të më degdisin? Me siguri, në ndonjë fshat të humbur, për riedukim dhe nuk do të kthehem dot kurrë më në këtë punë kaq të bukur, do të më marrë malli edhe për Tiranën e jo më të mendoj pastaj për të shkuar edhe jashtë shtetit». Dhe u rrëqeth. «Ah, sikur të më jepet mundësia të dal edhe një herë jashtë shtetit!», — ëndërroi ai dhe u ngrit të merrte shishen e konjakut. «Ja, për këtë duhet luftuar», i dha karar vetes dhe piu me shishe...

27.

Mistoja trokiti në derën e zyrës, po, siç duket, nuk e dëgjuan; brenda po diskutonin. Trokiti edhe një herë më fort e hyri. Kiçoja rrinte ulur në tavolinën e tij të punës dhe dukej i skuqur e i rrëmbyer nga diskutimi. Bisedat në dhomë u ndërprejnë. Me një të parë, Mistoja u bind se ishte i tepër aty. «Jam i tepërt këtu», — mendoi dhe i tha Kiços:

— Kur të lirohesh, më merr në telefon, kam diçka për të biseduar, — dhe doli.

Nuk i punohej. Kjo gjendje po e rëndonte që nga dita kur goditi me këmbë atë çelësin prapa derës. Ai bënte një përpjekje të jashtëzakonshme për të ruajtur në fytyrë atë pamjen e njeriut të vrullshëm, të gëzuar e punëtor, por aty, në zyrën e tij, e linte këtë maskë mënjanë dhe shndërrohej sakaq në një njeri të drobitur e të frikësuar për vdekje. Thirrjet telefonike i ngjallnin një frikë të jashtëzakonshme, por ai ishte zyrtar dhe detyrohej të

zgjaste dorën (që i dridhej shumë këto kohët e fundit) dhe të përgjigjej.

Në zyrë hyri Kiçoja, si gjithnjë i shkathët, por i përmbajtur e i vëmendshëm.

— Më fal që të lashë të prisje, por isha tepër i zënë. Kanë tri ditë rresht ata dy njerëz të çuditshëm që kërkojnë të sjellin nga importi edhe qiqra në hell. Janë me të vërtetë të çuditshëm. Kërkojnë materiale që i prodhojmë vetë në vend. Mirë literaturën shkencore që s'e lexojnë, por, të paktën, të lexonin rregullisht gazetat. Listën e tyre të kërkesave ia përcolla me një shënim Komitetit të Partisë. — Kiçoja heshti. E kuptoi që shoku i tij kishte ndonjë hall. — Nejse, — tha ai duke lëvizur dorën me vrull në ajër, — ti ke një hallë. Thuajma.

— Ti më flet sikur do të bëjmë ndonjë bisedë zyrtare, — u mundua Mistoja të buzëqeshte.

— Ke të drejtë, — pranoi tjetri, — le të vemi të bisedojmë diku...

Ata u ulën dhe porositën kafe.

— Dua të bisedoj me ty për çështjen e Orjetës.

— Pse, ç'ka ndodhur?

— Ajo ka ikur nga shtëpia — tha Mistoja, duke nxjerrë një rrip letre nga xhepi e duke e vënë mbi tavolinë. — Lexoje.

Kiçoja, i preokupuar, lexoi atë rresht të thatë pas të cilit nuk dukej pothuaj asgjë. Atij iu kujtua biseda telefonike me Orjetën dhe menjëherë e kuptoi që punët nuk ishin aspak mirë. Ai e njihte Miston, ia njihte dhe të metat dhe të mirat, por, ama, për Orjetën thuajse nuk dinte asgjë. Ç'qëndrim duhej të mbante? Natyrisht një qëndrim të drejtë, por ama, hajde gjeje atë! «Fundja, le ta dëgjoj njëherë Miston», — mendoi Kiçoja dhe ngriti sytë nga letra.

Mistoja atë kohë po ndizte cigaren. Ai i kishte matur mirë lëvizjet e tij. I duhej një mbrojtës, një njeri me kredi, që ta zgjidhte këtë konflikt të vogël pa i hyrë asnjë gjemb në këmbë. Para tri ditësh ai i kishte dhuruar Kiços një stilograf dhe një kravatë si kujtim. Në fillim Kiçoja s'kishte pranuar, por ai kishte ngulur këmbë, qe hequr si i fyer, i kishte thënë se ato ishin thjesht kursimet e tij dhe se ai nuk qe ndonjë i lënë që të përsëriste dy herë të njëjtin gabim. Tani, duke ndenjtur me të, kujtonte atë peshqeshin dhe e kuptonte se veprimi i tij kishte qenë mjaft i kujdesshëm dhe i efektshëm. «Se, po i dhe diçka tjetrit, ai nuk të pështyn në çorbë». Kështu i thoshte gjithnjë i ati, dhe këshillat e tij qenë për Miston një busull e pagabueshme.

— Përse e bëri ajo këtë, — e pyeti Kiçoja, me shumë kujdes.

— Nuk e di, nuk më ka thënë asnjë shkak. Kemi pasur, natyrisht, ndonjë mosmarrëveshje, siç ndodh rëndom midis bashkëshortëve, por jo të asaj natyre që të tronditnin rëndë jetën familjare.

Mistoja ngriti kryet i hutuar.

— A shkove tek ajo, a i kërkove shpjegime?

— Natyrisht, por ajo nuk doli fare të më takonte. E ëma më tha se nuk është mirë nga nervat. Punë dreqi!

Ra heshtje, një heshtje e rëndë dhe aspak e këndshme kur njeriu e ndien veten ngushtë dhe përpiqet ta thyejë atë, por nuk gjen ndonjë gjë të mençur, megjithëse shtrydhet.

— Më vjen keq, se ndodhi pikërisht tani që unë po plotësoj dokumentet për të hyrë në Parti, — tha Mistoja, i preokupuar.

— Kjo nuk është pengesë, natyrisht në qoftë se ti nuk ke asnjë lloj gabimi në qëndrimin tënd. Veçse, kam frikë se ti i zvogëlon gabimet e tua, se, ndryshe, kështu si e shpjegon ti, s'kish pse ikte Orjeta nga shtëpia. Ajo nuk është budallaqe, përkundrazi, duket mjaft e edukuar dhe ka një familje të mirë.

— Singerisht nuk kuptoj asgjë, — tha i fyer Mistoja, — ndoshta unë, siç thua ti, i zvogëloj gabimet e mia, por këtu nuk mund të bëhet fjalë për gabime.

— Si mund të ndihmoj unë, — i ra shkurt Kicoja për ta çliruar shokun nga druajtja, që ai ta bënte hapur kërkesën.

— Nuk do të ishte keq sikur të bisedoje njëherë vetë me Orjetën dhe me prindët e saj, — tha me të lutur Mistoja.

— Mirë, kështu e bëjmë. Po shkoj që sot. . .

— Ti si thua, ta vë në dijeni sekretarin e organizatës, apo të presim njëherë ç'do të bësh ti, — tha me kujdes Mistoja.

— Mendoj se, pavarësisht nga ajo që do të bëj unë, ti duhet të bisedosh me sekretarin e organizatës, bile je vonë. . .

— Nuk kam qenë hiç në vete, — u shfajësua Mistoja. — Do t'ia them që tani.

Dhe u ngritën.

28.

Antoni u kthye në shtëpi pa veturë. Zemra i rrihte me aq forcë, sa ai u shqetësua se mos e kishte të sëmurë. «Duhet të vizitohem», — tha me vete

dhe hapi derën e dhomës. Pas një ore do të shkonte në takim me ambasadorin. Ç't'i raportonte? Pasi hoqi vetëm këpucët, u shtri në krevat; donte të çlodhej pak dhe të sistemonte mendimet. Por rrahjet e shpeshta të zemrës e shqetësonin dhe i hyri frika se mos ndoshta i ndodhte gjë, aq më tepër në një kohë kur edhe e shoqja dreqi e di se ku mund të kishte shkuar për ndonjë vizitë. «Vend i tmerrshëm, vend-kasafortë, i mbyllur hermetikisht, — mendoj me urrejtje Antoni dhe ndezi një cigare, me shpresë se mund ta qetësonte. — Të paktën të kisha mundësi të nxirrja diçka nga shtypi! Po edhe shtypi këtu është i çuditshëm. Në vende të tjera mund të mbushësh faqe të tëra me informacione vetëm nga gazetat, radioja, televizioni. Ndërsa kjo propaganda e tyre ka një organizim krejt të ndryshëm. Dhe më e keqja është se çdo përpjekje për të liberalizuar pak jetën në vend, për t'i lejuar më tepër demokraci njeriut, demokraci që këta e kuptojnë së prapthi, ka dështuar që në embrion.

Megjithatë unë diçka nxora nga shtypi, — tha Antoni duke fikur cigaren në taketuke, — diçka për ndryshime kuadrosh. Ja, pikërisht ky informacion i futi ethet qendrës, u hapi orekset atyre që i kalojnë darkat të qetë në vilat e tyre dhe tani duhet të rropatem unë që t'u gjej materialin konkret politik. E ku ta gjej?! Se mos i mbaj unë çelësat e kasafortave të tyre. Pt, — pështyu ai dhe mori edhe një cigare tjetër, — dhe mburren se zbulimi ynë paska punuar për Shqipërinë «me perspektivë të largët». Ku është kjo perspektivë, xhanëm, pse s'e shikoj dot unë që jam vetë këtu? Posi, kanë rekrutuar ndonjë dështak që në vezë, ndonjë që bridhte pas lavireve (eh, sa është shtuar kjo farë djalli në vendin tonë!),

që, sapo u kthyen në Shqipëri, ranë në grackë si budallenj».

Antoni u ngrit nga krevati dhe bariste lart e poshtë qilimit të dhomës. Ai nisi të trembej nga qetësia e hapave të veta dhe mbathi këpucët. «Ja dhe takimi i sotëm me atë agjent prostitutë dështoi. E prita plot njëzet minuta, u rrezikova të më kapnin me presh në dorë. Ç't'i ketë ndodhur? Mos e kanë zbuluar? Jo, xhanëm, — e qetësoi veten ai, — po ta zbulonin, me siguri do të më shpallnin «non grata»». Dhe i shkoi një e rrëqethur nga ky mendim. Në të vërtetë, Antoni nuk ndiente ndonjë frikë se mund të largohej nga ky vend, përkundrazi, do ta priste me kënaqësi, posi do të veprohej me të në drejtorinë e zbulimit? Ja, kjo ishte gjithë e keqja. Dhe ai e dinte mjaft mirë si silleshin në drejtori me ca si ai që nuk shquheshin për lidhje solide me shefat.

Antonit i shkoi mendja përsëri tek agjenti i tij, «kafeja» (ç'emër pa fantazi!). Ai do të insistonte të lidhej me të, do të sillej në mënyrë brutale, të paskrupull, do ta detyronte të kryente detyrën. Në kasafortë ruante me kujdes mjetet e domosdoshme të shantazhit: disa shirita magnetikë dhe fotografitë komprometuese. U afrua te pasqyra dhe vuri re fytyrën e tij të skuqur, të irituar tej masës. Preku me dorë mjekrën, që iu duk tepër e rritur për një komandant toge, që do të paraqitej te gjenerali i brigadës dhe futi në prizë makinën e rrojes, megjithëse zhurma e saj ia shkatërronte nervat dhe ia rëndonte mundimet.

Në tren s'kishte shumë pasagjerë. Mistoja u rregullua në një të ndarë. Hapi çantën e udhëtimit dhe nxori një libër. Ndiante dëshirë të qëndronte krejt vetëm. Vetëm! Të paktën kështu i dukej, sepse gjatë gjithë kohës i shfaqeshin si copa filmi të montuara keq e pa radhë njerëz, ngjarje, fakte, fragmente bisdash. Ato nuk e linin të qetë. Mistoja vuante, mundohej t'i sistemonte, t'i vendoste sipas një radhe të caktuar, pastaj, t'i analizonte e të përcaktonte qendrimet dhe veprimet e tij. Po kjo qe krejt e pamundur. «Ja, — mendoi ai duke vënë librin mbi tavolinën portative, — le të marrim fundja, këtë lejen e zakonshme. Përse ma dhanë pikërisht tani? Mos ndoshta, duke marrë shkas nga ndarja me Orjetën, ata vendosën të më heqin qafe? Përse ta bëjnë këtë? Fundja, gjyqi e bëri ndarjen thjesht se ne kishim karaktere të kundërta. Kjo nuk është, pra, një arsye që të më heqin nga puna e të më çojnë gjetkë për riedukim».

E mori përsëri librin, po shkronjat sikur lëviznin, ngatërroheshin, bashkoheshin pastaj me njëra-tjetrën, duke formuar ca fjalë të gjata e pa kuptim. Ndezi një cigare dhe e flaku kutinë e zbrazur nga dritarja. Ajo iu zhduk menjëherë nga sytë. «Ja, kështu mund të më flakin edhe mua. Këtë e bëri në fillim Orjeta, tani dhe qendra e punës që më dha lejen të qetësohem. Po pastaj, pastaj kush e ka radhën? . . . Dhe papritur i lindi një mendim që iu duk plotësisht i arsyeshëm: mos vallë kam filluar të vuaj nga mania e persekutimit? Ku ta dish, edhe mundet, — u mundua të qetësohej, — me tërë këtë

tension nervor...» Iu kujtua Orjeta, gjyqi. «Ama, bukur ma punoi! Sa keq që s'e njoha dot që më parë. Kur po fliste në gjyq (sa e tmerrshme ajo salla e gjyqit, mbushur plot me njerëz që nuk kënaqeshin vetëm së dëgjuari, por kërkonin edhe të diskutonin), më dukej sikur më kishin shtrirë mbi një tavolinë anatomie dhe do të më bënin autopsinë. Si dreqin i kishte grumbulluar dhe si i lidhte e interpretonte ato fakte? Me siguri e kanë ndihmuar. Po kush? Ndoshta i ati, ndoshta edhe ndonjë nga shokët e mi. Të jetë Kiçoja... ai u soll aq ftohtë me mua, pasi bisedoi me Orjetën. Apo të jetë Iliri... atij sikur iu hapa shumë, si budalla, atje, jashtë shtetit. Dreqi, e merr vesh! Njerëzit janë të çuditshëm, shumë të komplikuar. Ja, edhe unë vetë jam i komplikuar. Hëm, trupit mund t'i bëhet autopsi, kurse mendimit jo. Ndryshe, për mua...»

Treni që ndaloi në një stacion, ia ndërpreu mendimet si me sopatë. Nga të dyja dyert e vagonit hynë me ngut udhëtarë. Mistoja u rudh e u mbyll më tepër në vetvete, nervat i kërcyen dhe ndjeu djersë në tër trupin. Në ndenjësën përballë tij u ulën dy vetë.

— Mirë se rri, o djalë! — i tha njëri prej tyre, një mesoburrë me mustaqe, veshur me rroba fshatari.

— Mirë se erdhët, — u përgjigj me një mirësjellje të shtirë Mistoja dhe lëvizti pak nga vendi. «Paskan dhe muhabet», — mendoi me vete.

Ai tjetri nuk fliste. Dukej moshatar me të parin, por ishte më i mbajtur edhe nga trupi, edhe nga veshja.

— Ja, edhe ca vjet sa të bëhet ky babaxhani, metalurgjiku, dhe ato veprat që kemi nisur dhe pastaj më ndryshe do t'i kemi punët, — i tha meso-

burri me mustaqe tjetrit. — Ata, si çdukej, vazhdonin bisedën e lënë përgjysmë.

— Po, — pohoi tjetri mendueshëm dhe mori kutinë e duhanit që i zgjati shoku, i cili tani po dridhte me një kujdes shumë të madh cigaren.

Mistoja shikonte ato duart e tij tërë kallo, të nxira nga dielli që, megjithëse të trasha, qenë çuditërisht të zhdërvjellta. Dhe instinktivisht i vajtën sytë te duart e veta të bardha e të brishta dhe u rrëqeth, kur mendoi se edhe atij, po të mos kishte ndjekur shkollën, kështu do t'i bëheshin nga hekurishtet. Në këto mendime e sipër ndjeu diçka të ftohtë në dorë. Ishte kutia e duhanit, që ia vuri në dorë burri i veshur më mirë. Mistoja deshi njëherë t'u thoshte se nuk pinte, sepse, po ta merrte, do të futej patjetër në bisedë me ta, në një bisedë vulgare, sigurisht, por, kur i vajtën sytë te paqeta që kish lënë mbi tavolinën portative, u kujtua se s'mund ta kthente.

— Është duhan i mirë, i kooperativës sonë, apo nuk e dredh dot, — i tha burri me mustaqe.

Mistoja gjithnjë kishte pirë cigare të shtrenjta, bile edhe në universitet. Nga vështrimi i tij i hutuar burri me mustaqe e kuptoi se ai nuk dinte ta dridhte dhe ia mori kutinë nga duart.

— Thashë unë, që nuk di ta dredhësh ti, dukesh që në të parë. Po të pish nga ky duhani ynë, me siguri do mësosh ta dredhësh. Është mjaltë, i uruari. Apo jo, more Betim. Ja, dhe ky birçja, kur na erdhi nga shkolla, na pinte ca palo cigare që doje një kuinal ta ndieje se ish duhan. Po ne ia punuam paqë këtij . . . e kemi kryeagronomin tonë. E thirrëm shitësin veç dhe e porositëm të mos i jepte nga ato me filtër. Posi, vetë e prodhonte duhanin, vetë e rriti

rendimentin e tij, nëpër suferinë e nëpër shi punonte me brigadën e donte të na hiqej si modern. — Ndërkohë burri me mustaqe ia bëri cigaren gati Mistos dhe ia dha ta lagte vetë. Betimi qeshi me gjithë shpirt. Qeshi edhe Mistoja.

«Ky na qenka kryeagronomi, — mendoj ai disi me përbuzje, — asgjë nuk e ndan nga ky lopçari, me përjashtim të atij kostumit dhe moshës më të re. Ky është ai prototipi i intelektualit të ri popullor. Dhe për duar që më paska, për kostum që paska veshur! Dhe mendo, edhe ky ka qenë në universitet. Po, me siguri, do të ketë vajtur nga ndonjë kooperativë bujqësore. Ai donte ta verifikonte supozimin e tij dhe, duke përmbajtur kollën që i shkaktoi duhani, e pyeti:

— Nga jeni?

— Jam nga Vlora, por familja që para Çlirimit banon në Tiranë. Ndërsa unë, siç e shikon, në fshat. Kam dhjetë vjet, që kur mbarova studimet.

— Bukur, — i tha Mistoja me një ton ironik, disi të përmbajtur. «Me siguri është nga ata tipat që pranojnë çdo sakrificë dhe nuk ndihen, derisa vjen çasti i tyre. Ndonjë ditë të bukur, pikërisht ky gjysmëfshatar e gjysmëqytetar mund të bëhet ndonjë drejtor drejtorie... mund të jetë dhe eprori im. Ja, si ai i sotmi, edhe ai ka punuar në një uzinë mekanike dhe arsimin e lartë tani, para tri vjetësh e mbaroi...» — Po ju, çfarë pune bëni?

— Është kryetari i kooperativës sonë të bashkuar, — u përgjigj në vend të tij Betimi. — E kemi dhe hero të punës socialiste...

— Na lër tani, o Betim... — e ndërpreu ai. Pastaj drodhi edhe një cigare tjetër për vete.

Mistoja nuk foli më. Sikur s'i rrihej me këta njerëz.

Mbasi përgatiti gjithçka, Georgi qëndroi për një çast në mes të dhomës dhe nisi të kujtonte me radhë të gjitha ato që kishte futur në valixhe. Kur bëhej gati për rrugë, ai përgatitej në mënyrë të tillë, që të bënte një përshtypje sa më të mirë. Aq më tepër në këtë udhëtim kaq të rëndësishëm për në Shqipëri. Georgi udhëtonte si përkthyes i delegacionit tregtar. Ai e kishte gjuhën shqipe, por në Shqipëri nuk kishte qenë ndonjëherë. Megjithatë, për njohuritë e tij mbi këtë vend, nuk mund të matej kushdo me të. Ai njihnte industrinë, bujqësinë, transportin, letërsinë. Bibliotekarja e drejtorisë së zbulimit ishte në hall me lexuesin e saj të përkëdhelur, Georgin. Atij i duheshin katalogë, manuale, albume, tregues bibliografikë, e ç'nuk i duheshin...

Georgi i nxori valixhet në korridor dhe kyçi derën. I ngarkoi plaçkat në portbagazh dhe u nis për tek Eva. Para së gjithash, do të takonte atë. Në raste të tilla ai tregohej tepër i kujdesshëm; kërkohej finesë, mbi të gjitha...

Kur Georgi hipi në aeroplan, anëtarët e delegacionit, gjithësej pesë vetë, e shikuan me admirim. Georgi e kuptoi që kish bërë përshtypje të mirë dhe iu bë qejfi. Buzëqeshja e tij prej çapkëni që po i kalonte pak mosha, sikur donte të thoshte: mos u shqetësoni, zotërinj, unë di të gjej rrugë edhe nëpër xhungël...

Ditët e para, te prindët, tashmë të plakur, Mistoja e ndjeu veten krejtësisht të lirë. Andrallat e punës kishin mbetur pas.

Tani, më shumë se kurrë, ai e kuptoi se martesë e kishte shkëputur nga prindët, megjithatë ja, po e ndiente përsëri këtë lumturi. Në fillim ata nuk ia zunë në gojë fare atë bisedë, por dalngadalë filluan t'i bënin ndonjë vërejtje ashtu si kalimthi. Babai e tha troç: «Ajo nuk qe mall për ty, mor djalë, por deshe dhe e more». Ndërsa nëna shkoi më tej: «Nuk e deshe Marizën, që ishte goxha çupë dhe nga derë e fisme, po vajte e more atë që dje zbriti nga fshati». Në fillim Mistos i erdhi mirë që ata e miratuan ndarjen, por shpejt iu desh të sillte në mend se tamam babai, ditën e dasmës, i kishte thënë: «të lumtë, or bir! Na lidhe me një familje të mirë dhe ke zgjedhur vajzë për kokë të vajzës». Ndërrojnë njerëzit, mendoj me dhembje Mistoja, ndërrojnë. Ja, edhe këta të shtëpisë i kanë fshehur kaq kohë ndjenjat e tyre të vërteta. Apo duan të më ngushëllojnë? Babai është njeri me të vërtetë i çuditshëm. Ai tërë jetën e vet e ka vërtitur. Në kohën e luftës e zgjeroi mirë dyqanin, por pas Çlirimit u fut i pari në kooperativën e artizanatit, ama, pasi i hoqi shumicën e veglave të punës e i solli në shtëpi. Punonte në kooperativë, punonte dhe në shtëpi e shiste nën dorë. Kur ai e pyeste të atin ç'i duheshin tërë ato vegla në shtëpi, ai përgjigjej: duhen bir, duhen. Duke hedhur vështrimin në shpirtin e tij, Mistoja gjente shumë shenja të përbashkëta me prindët. Por sidogoftë ata e rritën me gjithë të mirat. Copë u bë babai për ta çuar Miston në universitet, i kishte ruajtur

nja dy miq për ditë të ligë, për atë ditë ai qe rropatur një jetë të tërë. Por dhe ai, ama, nuk e turpëroi kurrë në mësimë.

Një ditë Mistos iu shkrep të zbriste në bodrum. Ai hyri me një ndjenjë kureshtjeje, si në fëmijëri. U habit. Atje qe instaluar një oficinë e vërtetë. Mjetet ishin të pastra e të sistemuara për punë. Takonte aty-këtu sende që i njihte, që diç i kujtonin, takonte edhe sende krejt të panjohura. Dukej që babai vazhdonte të kishte atë maninë për të futur në shtëpi çdo gjë, qoftë edhe të panevojshme. Mistos i shkoi ndër mend se në kohë tjetër ai mund të lidhte kontrata të leverdisshme për llogari të babait. . .

Mendimet ia shkëputi dera që u dëgjua të kërciste.

— Paske hyrë në mbretërinë time, — i tha babai, teksa i afrohej. — Qajnë, qajnë për punë këto vegla.

— Pse nuk i dorëzon? — i shkrep papritur Mistos.

— T'i dorëzoj? — Balli i tij u vrenjt, dhe Mistoja u tremb, si në vegjëli. — Thashë se të hanin duart, po ku ke duar ti për këtë punë. Ti i ke duart si të zonjave, mor djalë, — dhe e shikonte i menduar. . .

Të nesërmen ai rrinte shtrirë në dhomën e tij (sa kujtime i zgjonte kjo dhomë!) dhe po shfletonte një fjalor, kur papritmas hyri e ëma. E hollë, e thinjur dhe e vyshkur ajo qëndroi përpara të birit. Duart e saj të zbeta i kishte kryqëzuar në pëqi dhe në shikimin e saj ai lexoi ndjenjën e përmallimit.

Duart e nënës i kujtuan vitet e shkollës së lartë, kur ajo i dërgonte ca pako të vogla tërë përkujdesje, kur i shkruante ca letra gjithë përgjërime.

Me ato duar ajo i punonte triko aq të bukura, sa që edhe vajzave u mbeteshin sytë. Nëna dikur kishte qenë e bukur, tepër tërheqëse (apo ndoshta i dukej atij) dhe, po ta shikoje me kujdes, dalloheshin ende ato tiparet e bukurisë së vajzërisë. Befas, atij i erdhi ndohtë nga vetja, nga të gjitha ato që bluante në mendje, nga ato rrugëdalje... nga ato pikësnyime që kërkonte të arrinte...

— Ke një telegram, — i tha ajo duke i zgjatur me dorën që i dridhej lehtë një copë letër të palosur më katërsh, — duhet të nisesh.

— Si? — Tërë qenia e tij u përqendrua te ky lajm. «Ç'të ketë ndodhur vallë? Me siguri, — i shkrep-tiu atij — ata kanë vendosur fatin tim. Ndoshta do të më dërgojnë në kooperativën e atij njeriut me mustaqe...», — dhe mori telegramin. Teksti nuk të lejonte të kuptoje asgjë më shumë: «Nesër në orën 12.00 paraqitu në zyrë». Menjëherë u ngrit e nisi të mblidhte rrobat. E ëma ndiqte e shqetësuar ngutjen e tij. Asaj nuk i pëlqente kjo gjendje, kjo ngutje...

— Kur do nisesh?

— Që tani, — iu përgjigj pa i ngritur sytë; ai nuk guxonte të shikonte në sytë e vëmendshëm të nënës dhe ngjishte pa rregull rrobat në valixhe.

— Prit të të pregatis diçka për të ngrënë, — iu lut e ëma.

— Jo, nënë, nxitohem. Është më mirë të jem që nesër në mëngjes atje, ndoshta kanë nevojë të ngutshme për mua. Puna mbi të gjitha! — Kjo shprehje, që i tha s'ëmës për ta qetësuar, i ngjalli një ndjenjë të çuditshme, i krijoi një gjendje të tillë boshllëku, sa që ment iu muar fryma.

... Në orën tetë, para se të takohej me drejtorin, ai shkoi në zyrën e Kiços, të cilin, si gjithnjë, e gjeti të mbytur me punë. Mbi tavolinë nuk kishte asnjë kënd të lirë, një mori shkresash qenë përhapur andej-këndej.

— Je një burokrat tipik, — i tha Mistoja, në vend të përshëndetjes, duke fshehur me kujdesin e aktorit emocionet e kësaj thirrjeje urgjente.

— Po jo si ata të estradave, — qeshi Kiçoja duke u ngritur të përqafohej me të, — unë jam burokrat i vërtetë. S'kam kërkuar kot të shkoj në bazë.

Miston e dogji kjo fjalë. «Mos ndoshta ky po pregatit terrenin që të më ngushëllojë dhe mua?! Eh, sa gjëra di ky Kiçoja dhe sa bukur manovron!»

— Po dhe ti nuk je i paktë, — e ngacmoi Kiçoja, — s'bëjnë dot pa ty, edhe lejen ta ndërprejnë.

— Vërtet, përse më thirrën me kaq urgjencë? — pyeti si rastësisht Mistoja.

— Do të vijë një delegacion tregtar. Ti duhet të nxjerrësh disa materiale dhe do të shërbesh si përkthyes, — tha ai duke qeshur.

Edhe Mistoja qeshi me gjithë zemër, i çliruar tashmë krejtësisht. Gjunjët po e tradhtonin. U ul në karrige dhe ndezi një cigare.

32.

Bisedimet vazhdonin që prej mëngjesit. Kish mbetur prapa, shumë prapa ajo kohë e artë kur letrat mbi tavolinë rrinin të hapura, kur bëheshin shaka pa teklif, pihej ndonjë gotë dhe puna ecte vetë. Tani duhej studjuar çdo detal, çdo veprim çdo buzë-

qeshje; duhej analizuar mirë e me kujdes çdo anekdotë, çdo propozim, bile çdo fjalë e thënë ashtu kalinthi.

Georgi rrinte i qetë në vendin e tij, i qetë në dukje. Ai, para se të udhëtonte për në Shqipëri, kishte shfletuar gjithë praktikën e marrëdhënieve tregtare ndërmjet shteteve dhe, nëpërmjet dokumenteve, dalngadalë, kishte parë si zhvillohej politika e shtetit të tij në marrëdhëniet me shqiptarët. Por ai konstatoje, jo pa keqardhje, edhe qëndrimin dhe kundërpërgjigjen e palës tjetër. Interesant, si bëhet historia, mendonte Georgi. Sot më shumë se kurrë është koha që në palën tjetër të kesh syrin dhe veshin tënd. Ndryshe digjesh me gjithë ç'ke, ndryshe nuk ke asnjë vlerë. Georgi i nguli vështrimin Mistos, i cili gjatë bisedimeve mbante një qëndrim disi të ngurrosur, e druhej edhe ta shikonte në sy atë. Vetëm në njërin nga pushimet midis dy seancave tepër të ngjeshura ata kishin mundur të shkëmbenin pak fjalë. Pranë Georgit qëndronte Antoni, që bënte pjesë në delegacionin tregtar. Antoni mbahej me të madh, dhe kjo i bënte shumë përshtypje Georgit. Mos vallë kjo rridhte nga përmbajtja e çantës së tij? Natyrisht, ai kishte bërë një punë të mirë paraprake në interes të marrëveshjes, dhe këtë nuk mund ta vinte asnjëri në dyshim, por Georgi kërkonte t'i thoshte diçka atij. E përse të mos ia thoshte? Fundja, ai vetë ia pregatiti kushtet Antonit për të qenë në krye të detyrës. Ndryshe ai do të ishte sot, në këto bisedime, tamam një njeri pa pikë vlere. Kur mendonte këtë, Georgit i shkoi mendja te vetja. Ja, ai ndodhej në sferat e larta të pushtetit; megjithëse pa pozitë kushedi çfarë, ia kishin nevojën. Në ato vitet e para të pasçlirimit nga nazistët, Georgi ishte i qartë për pozitën e tij

të mëvonshme; babai i tij u kishte shërbyer me besnikëri pushtesve dhe që shpallur kriminel lufte.

Por më vonë dalngadalë kohët nisën të ndryshonin. I ati në fillim nisi t'i shkruante, pastaj t'i dërgonte pako, derisa një ditë u kthye si mijëra kriminelë të tjerë politikë, siç, i quanin. Georgi filloi të ecte me guxim, në saje të përkrahjes së miqve të babait dhe në gjithë ato pastrime, në fillim të pjesshme e më vonë më të përgjithshme nga organet e pushtetit, Georgi kishte zënë vendin që i takonte. Edhe vetë Antoni i përkiste së njëjtës shtresë, por ishte më i butë, më i kujdesshëm; ndoshta ai mund të dyshonte për ndonjë përmbysje të situatës. Të tillë njerëz janë të rrezikshëm, mendoj aty për aty Georgi, ata duhen zhdukur. Po sikur me të vërtetë të ketë një përmbysje të tillë, ç'do të bëhet me mua? — i shkrepri në mend papritur. Pa dyshim ai do të kërkonte rrugë të tjera për të ruajtur pozitën e tij; fundja, do të ndiqte shembullin e t'et.

Mistoja mbaroi së lexuari për palën e tij tekstin e plotë të marrëveshjes, dhe Georgi u ngrit në këmbë për të përmbushur detyrën e tij. Ai u përqëndrua aq fort në këtë punë, sa harroi gjithçka, harroi dhe veten.

33.

Vitin e Ri Iliri vendosi ta festonte së bashku me shokët e brigadës. Ishte data tridhjetë dhjetor. Ata u mblodhën në mensë, dhe bredhi, një bredh i madh e i bukur që e kishin sjellë vetë nga pylli, që zbukuruar hijshëm, me shumë kujdes. Ilirit i ta-

koi të rrinte pranë Lleshit, që atë natë dukej shumë i zënë me punë: e kishin caktuar të ndante pakot e kalamanjve dhe, si zëvendëssekretar i organizatës së Partisë, duhej të mbante fjalën e rastit. Lleshi u ul midis Ilirit dhe drejtorit të ri të ndërmarrjes, një ish-sharrëxhi që sapo ishte kthyer nga Shkolla e Lartë e Partisë, dhe, pas pak, kur pa orën në dorën e Ilirit, u ngrit. Në sallë zhurma gradualisht u fashit.

Iliri po ndiqte me shumë vëmendje çdo gjë përreth. Të gjithë ishin veshur thjesht, flokët i kishin krehur me kujdes dhe dukeshin të rruar taze. Aty-këtu Ilirit i ra në sy ndonjë medalje e varur me kujdes në anën e majtë të xhaketës, ndonjë dekoratë...

Dukej më shumë si një mbrëmje familjare, ku njerëzit nuk druheshin aspak nga njëri-tjetri, ashtu si atje në pyll kur nxirrnin bukën e i thoshin njëri-tjetrit: «urdhëro të hamë».

Lleshi e nisi fjalën me atë zërin e tij të fortë. Iliri vuri re se si një tis i kuq nisi t'i ngjitej Lleshit nga qafa në fytyrë. Ai foli për Partinë dhe shokun Enver, për rrethimin, për luftën kundër fesë dhe zakoneve, për planin, për rendimentin dhe për bukurinë e pyjeve. Ndonjëherë përplaste edhe grushtin mbi tavolinë, kur qe fjala për luftën kundër armiqve.

Në fund shpërthyen duartrokitjet, brohoritjet për Partinë e shokun Enver.

Iliri përplaste shuplakat me forcë, ishte i emocionuar.

— Gëzuar! — uroi Lleshi me zë të lartë. Ilirit kjo i erdhi papritur, sepse, ashtu i harruar pas mendimeve, thujse nuk dëgjonte e nuk shikonte asgjë

në sallë. — Lëri studimet, — i tha me të qeshur. — Sonte po përcjellim një vit dhe presim tjetrin, apo edhe ti po bën bilancin e shkencës?

Shokët qeshën me zë të lartë. Iliri, pak i skuqur në fytyrë, ngriti gotën dhe uroi Lleshin, drejtorin, pastaj të tjerët: «Gëzuar Dodë... suksese Gjetë... gjithë të mirat Selë...»

Të gjithë u gjallëruan. Gjeta i ra tri-katër herë telave të çiftelisë dhe u vendos qetësia. Ai u ngrit në këmbë, pastaj në sallë nisi të përhapej një melodi e ëmbël. Në fillim Iliri e pati të vështirë ta kuptonte atë melodi, por dalngadalë ai nisi ta jetonte atë... E pa veten në një luginë të bleruar. Ndaloi te një burim, pastaj ngjiti monopatin... Atje larg u duk një shtëpi nga ato me çati të lartë, si kullë... Në një nga dhomat ai dëgjoji një kujë grash, pa trupin e shtrirë të një djali të ri, plagën në gjoksin e tij, t'ëmën të përkulur mbi të, pushkën e varur në mur dhe vëllanë e të vrrarit, që, me buzët të shtrënguara e me sytë nga pushka, ndiqte gjithë këtë skenë...

Melodia pushoi. Në dhomë ra heshtja. Pas pak u dëgjua një zë:

— Jo, këto lloj melodish, mor Gjetë. Ndonjë nga të sotmet.

Gjeta nuk foli. Dukej se jetonte ende me atë melodi të përvajshme.

— Nuk e ka keq Gjeta, — u hodh e tha drejtori. — Po t'i harrojmë ato që kanë ndodhur para epokës së Partisë, nuk do të mund t'i ndiejmë këto që kemi sot dhe...

— Por Gjeta s'ka mbaruar, or burra, — e ndërpreu drejtorin Sela, — ai sapo filloi. Bukur e tha drejtori. Jepi Gjetë!

Dhe Gjeta nisi një melodi tjetër, që e shoqëruan

të gjithë me zë e me përplasje duarsh. Në orën dy-
mbëdhjetë Lleshi u ngrit përsëri në këmbë.

— Tani po ndajmë pakot. Ti, — tha duke iu drejtuar Gjetës, — mjaft i re çiftelisë. Tani kthe kur-
rrizin dhe, kur unë të them: «e kujt është kjo pako»,
ti do të thuash emrin. Mirë?

— Si urdhëron, — tha Gjeta prerë e duke qeshur.

— E kujt është kjo?

— E Blerinës së Tefikut.

— Ta gëzojë! Po kjo?

— E Sokolit të Selës.

— Ta gëzojë e suksese në mësim! Po kjo?

— E Gentit të Eminit.

— Po kjo?

— E Teutës...

Iliri shtangu një çast, dëgjoji emrin e së bijës.
«Interesant, — mendoj, — kujt ia quajnë vajzën
Teutë?». Askush s'u përgjigj.

— Babai i Teutës, — tha Lleshi duke u kthyer
nga Iliri. — Përse nuk përgjigjesh.

— Po unë... — u habit Iliri.

— E dimë ç'do na thuash, — ia preu Lleshi. —
Apo jo, Gjetë?

— Do na thotë se nuk është në këtë ndërmarrje
dhe se, në bazë të rregullave, nuk i takon... Po e
dimë ne atë punë...

Në mes të të qeshurave e duartrokitjeve Iliri
zgjati dorën dhe, si mori pakon, tha «ju falem nderit»,
por zëri s'i doli i plotë. Ai e ndjeu veten shumë të
prekur dhe atë çast pati përshtypjen se gjoksi iu
zgjerua dhe duart iu ndezën e iu bënë tepër të fu-
qishme. Pamja iu mjegullua, por nuk e uli kokën për
të fshehur lotët.

— Atë nuk mund ta heq nga mendja, — tha mendueshëm Mistoja.

— Kiçoja e vërejtë me kujdes në fytyrë. Vështrimi i tij ishte tepër zhbirues, megjithatë nuk i vuri re asnjë gjurmë shqetësimi. Mistoja s'e përballoi dot shikimin e tij dhe uli kokën.

— Ashtu, — i tha ai, disi natyrshëm, — po përse atëherë nuk vete të bisedosh me Orjetën? Ajo është vajzë e mirë. . .

— Ajo më shkatërroi jetën, më vjen turp nga shokët, nga të afërmit. . . Jo, do ta mbaj shqetësimin tim brendapërbrenda. Edhe ty ta thashë meqë erdhi fjala.

Ra heshtje. Ashtu të kredhur në mendime, nisën të gjerbnin kafen.

Miqësia midis tyre nuk qe më ajo e para, e ngrohtë. Kiçoja bënte përpjekje të zbulonte të vërtetën, por ai i vidhej me një mijë dredhira.

Papritur Mistoja uli filxhanin dhe u ngrit paksa nga vendi, duke buzëqeshur. Kiçoja ktheu kokën. Në hyrje u dukën një burrë me flokë të prerë shkurt, por me baseta të gjata, gjer në mes të faqes, e një grua leshverdhë, me veshje ekstravagante. Gruaja tregoi me kokë një tavolinë të lirë andej nga fundi.

— Janë të huaj, ai është atashe tregtar. Ishte dy muaj më parë në atë delegacionin. . . — shpjegoi Mistoja.

— Paskan dalë vetëm, — vërejtë Kiçoja, më tepër për të thënë diçka.

— . . .

Mistoja nisi të pinte kafen me dorën që i dri-dhej pak. Ai i mbante sytë ulur, për të mos i drej-

tuar nga ata dy të huajt që, për dreq, i kishin qëndruar përballë.

— Nuk më erdhi mirë për ty që s'kërkove të qarkulloje, — e nisi bisedën Kiçoja.

— Për këtë më paske ftuar? — tha Mistoja, duke ulur filxhanin e kafes disi me nervozizëm.

— Jo, nuk të ftova për këtë, por thashë mendimin tim për këtë çështje.

— Por unë sikur ta shpjegova një herë. Më duhet të qëndroj ca kohë për të vendosur qetësinë shpirtërore. Veç kësaj, ka edhe diçka që ti s'e kupton, ndërsa të tjerët e dinë mirë: unë kam ardhur nga baza, kurse ti drejtpërdrejt nga fakulteti. A nuk duhet kuptuar pak si tendencioz qëndrimi yt? Unë po ta them hapur... fundja, jemi shokë...

— Më pëlqejnë llogaritë e tua, — tha me ironi Kiçoja, — por desha të të them se ato përçapjet e tua për të shtrirë ca rrënjë sigurie sikur nuk janë të hijshme.

— Për se e ke fjalën?

— Mos e ngre zërin. Për peshqeshet, për qëndrimin disi servil, për oportunitetin në qëndrimin tënd ndaj atyre që gabojnë. Ja, edhe unë po të flas hapur.

— Ti Kiço, i fyen të tjerët, ti mbledh ca gjëra, ndoshta me qëllime të caktuara, dhe mundohesh t'u japësh mendimeve të tua ngjyrë parimore, për ndihmë «konstruktive». Tani po e kuptoj edhe thelbin e diskutimit tënd dy vjet më parë për atë ngatërresën time me doganën. Po ta them hapur, më ke fyer kur ma ktheve atë çakmakun që të dhurova...

— Sidoqoftë nuk është keq të mendohesh për këto që të thashë. Ndoshta do të lindë nevoja t'i

diskutojmë edhe në organizatën e Partisë. Mba parasysh se unë të dua, prandaj të këshilloj.

— Të dashur! Jo, unë kësaj nuk i them dashuri, as ndihmë.

Përsëri ra heshtje. Një heshtje e pakëndshme që nuk mund të thyhej më. Të dy mendonin se duhej të ngriheshin. Po kush duhej të propozonte i pari? Mistoja jo, sepse kishte dhe një takim tjetër, pikërisht këtu, një gjysmë ore më vonë. Ai do të heshte, derisa tjetrit t'i mbushej mendja të ngrihej i pari.

Kiçoja u ngrit dhe, pa folur, u drejtua për në banak. Si pagoi, u kthye të ndahej me Miston.

— Po shkoj, më presin në shtëpi, — i tha, dhe Mistoja vuri re se ai nuk ia shtrëngoi dorën fort, si zakonisht.

Kur mbeti vetëm, Mistoja ndjeu keqardhje. E përse duhej e gjithë kjo gjaknxehtësi? I vinte inat me veten. Ngriti sytë të shikonte Antonin. Ai dukej i përqëndruar në bisedën me të shoqen, por herë-herë kishin shkëmbyer nga një vështrim të shpejtë. Mistos i lindi një mendim i befasishëm: po sikur të shkonte të ulej në tryezën e tyre? Kushedi ç'mund të ndodhte të nesërmen me të! Por ky ishte vetëm një mendim i çastit, sepse për të ishte dyfish i ndaluar një veprim i tillë. Antoni vuri një cigare në buzë dhe nxori çakmakun, një çakmak të bardhë, dhe e shkrepiti dy-tri herë, duke parë nga Mistoja. Ky uli sytë dhe, pas një minute, kreu të njëjtin veprim. Pastaj porositi një gotë konjak dhe priti. Duheshin dhe pesë minuta të vinte Agimi. Kishte kohë të bisedonte me të. Gjer më tetë e gjysmë mbeteshin akoma dhe dy orë. Ndërkohë do të pinte dhe dy-tri gota të tjera me konjak dhe do ta ndiente veten më mirë. Kështu, do të përballonte atë ten-

sion të madh nervor që të shkakton një sjellje e dyfishtë. «Por a do të marrë fund ndonjëherë kjo gjendje?» — mendonte me vete, me vështrimin të mbërthyer nga dera.

35

Antoni doli nga kafeneja dhe i futi krahun së shoqes. Një copë rrugë e bënë pa folur. Ai mbështetej, si gjithnjë, tek aftësitë e saj; e kishte edhe si ndihmëse të denjë. Midis tyre kishin vendosur një marrëveshje të heshtur, që e respektonin pa asnjë rezervë. Për këtë arsye Antoni ia falte edhe ndonjë mëkat që bënte ajo me ambasadorin, atë njeri gjithnjë të çuditshëm që, në fund të fundit, edhe mund të zbutej.

Ata hynë në bulevard, midis njerëzve, dhe aty, si rastësisht, pasi lanë një pikë takimi, u ndanë. Antoni nisi të përgjonte. Pas pak u bind se nuk duhej të shqetësohej, askush s'e ndiqte. «A thua të punojnë me të vërtetë kaq keq këta shqiptarët?!

Sa nisi të ngjitej kodrës, këmbët i hynë në një pellg me ujë. Kjo iu duk si shenjë ogurzezë. Shtrëngoi fort çantën me thesaret e tij. Ky takim me «Kafënë» kishte karakter të jashtëzakonshëm. Në marrëdhëniet e tyre, kohët e fundit, kishte bërë vend frika e paniku, dhe, nga përvoja e tij, Antoni e kuptonte se këto nuk paralajmëronin asgjë të mirë, bile mund të sillnin dhe ftohjen e plotë. Prandaj ai kishte menduar t'i bënte «një gjilpërë për forcim zemre» «Kafesë»; kishte marrë me vete një shirit magnetik me një fragment të turbullt bisede, që do ta dëgjonin bashkarisht. Le të mendonte pastaj «Ka-

feja» për shkëputje! Sa për frikën Antoni nuk ishte i sigurt se do t'ia largonte. Mistoja, me sa dukej, do ta merrte me vete atë ndjenjë deri në varr. Për këtë Antoni ishte i bindur.

Në stolin ku kishin lënë takimin nuk kishte asnjëri. I duhej të priste. Ndezi një cigare, duke mbuluar me pardesy flakën e çakmakut. Pastaj Antoni lëvizi përreth vendit. Një fllad i lehtë i depërtoi në tërë trupin dhe ndjeu të rrëqethura. «Po sikur të më kenë ngritur ndonjë kurth? Jo. Edhe sikur të ndodhë, të paktën jo sonte», — mendoi ai me tmerr dhe shtrëngoi fort çantën.

Papritur ndjeu t'i afrohej dikush. E njohu. Kur u takuan, Antoni ndjeu erën e konjakut. Ai ia shtrëngoi fort e miqësisht dorën dhe mendoi se ky agjent po bëhej pijanec, dhe ata janë gjithnjë të pavlefshëm.

— Mos jam me vonesë? — zëri i «Kafesë» ishte i emocionuar.

— Jo, — u përgjigj ftohtë Antoni. — Ju jeni si gjithnjë i përpiktë. Ç'kemi?

— Ja informacioni, — tha me të njëjtën ftohtësi tjetri. — Merreni.

— Mos doni të ikni kaq shpejt? Ju më parë sillshit më ndryshe.

— Isha më naiv se tani, ky është ndryshimi.

— Si ta kuptoj këtë?

— Fare thjesht: më dhimbset lëkura. Ky quhet spiunazh.

— Mos quhej ndryshe më parë?

— Për mua, për rrethanat në të cilat ndodhesh, mund të quhej disi më ndryshe.

— Mos kanë ndryshuar gjë mendimet tuaja?

— Aspak. As qëllimet. Por, mos t'ju ngelet hatri, takimet duhet t'i rrallojmë ca. Po e them hapur: trembem.

— Mos mendoni se unë e kam më lehtë? Pa mendoni se ç'më gjen, po më kapën me presh në duar, siç thoni ju!

— Për ju është më e lehtë. Të'ikim.

— Jo.

— Pse?!

— S'kemi mbaruar... Mua nuk më interesojnë thjesht informatat, më interesojnë më tepër njerëzit. Në rastin konkret më interesoni vetë ju.

— Kuptoj.

— Por veproni ndryshe.

— Pse?

— Pse duhen rralloar takimet, pse nuk keni mundur akoma të tërhiqni pas vetes ndonjë person tjetër, siç kemi biseduar? Duhet të veproni më me vendosmëri dhe pa panik. Me këtë rast...

— Po më kërcënoni! Është në dorën time t'i mbaj apo t'i shkëpus marrëdhëniet.

— Ashtu? Unë mendoj ndryshe. Është pikërisht në dorën time.

— Gaboheni.

— Gaboheni ju. Kemi në dorë mjaft materiale komprometuese. Ne i kemi të regjistruara të gjitha bisedat, qoftë ato që kemi zhvilluar bashkë, qoftë dhe të tjerat, kur keni qenë te ne.

— Veçse ato biseda ju komprometojnë dhe ju.

— Aspak. Mjafton që «të më humbasë» një nga këta shirita dhe ju përfundoni në burg. Dëgjoni...

Ndërkohë, ashtu të zenë me bisedën e tyre, ata nuk mund të vinin re që disa njerëz sikur mbinë

nga dheu e i rrethuan. Kur u ndezën elektrikët e dorës, nën dritën verbuese të tyre, ata të dy mbetën si të shastisur.

— Jam diplomat, — tha ai me zë të lartë dhe kërcënueshëm.

— E dimë. Dimë që mbani me vete edhe një letërnjoftimi shqiptare.

Ndërkohë shkrepri disa herë rresht si rrufe një blic.

«Po më fotografojnë, — mendoi me fuqi të prera Antoni. — Ky është turpi», dhe iu kujtua krahasimi që i bënte pedagogu i shkollës ushtarake punës së zbuluesit: «zbuluesi, djema, është si ai negativi fotografik; nuk ka më asnjë vlerë kur e ekspozon në dritë».

— Ja dhe fundi yt, Misto. Kësaj i thonë: ne me bukë e ti me gurë. — Këto fjalë i tha një burrë i vjetër, i thinjur, me një trup të gjatë e të mbushur.

Mistoja diku e kishte dëgjuar atë zë, por në atë gjendje që ishte, qe tepër e vështirë ta kujtonte. Ai eci me këmbët që i dridheshin. Afër tyre u ndal një makinë dhe e futën brenda. Për Antonin ai nuk u kujtua, veç kur makina u nis me shpejtësi. «Po me të ç'bëhet? Me siguri ai do të shpallet «non grata», ndërsa mbi mua do të bien gjithë bataretë», — mendoi ai dhe përplasi fort kokën pas ndenjësës së parë të makinës. Nga balli nisi t'i rridhte një curril gjaku, që iu var pastaj deri në buzë.

Në derën e dhomës së gjumit u dëgjuan trokitje, në fillim të lehta e me intervale, ndërsa më vonë të forta e të shpejta. Ambasadori u zgjua nga një gjumë i thellë dhe lëvizi me hamendje nëpër dhomë. Nga hutimi harroi të ndizte abazhurin dhe, kur mbërriti në mes të dhomës, u përplas pas një kolltuku, dhe ndjeu t'i dhimbte fort gjuri.

— Kush është, — bërtiti ai fort, teksa po i afrohej me mundim derës.

— Jam unë, Gizi, — u ndie që prapa derës.

«Gizi! — mendoi ai me vete, tepër i çuditur. — Ç'do ajo këtu? Mos është grindur me të shoqin për shkakun tim, apo mos...» dhe menjëherë ndjeu gjakun t'i vërshonte fort në të gjithë trupin, ndjeu se kishte ende energji dhe shtrëngoi grushtat fort. Me vështirësi gjeti dorezën dhe hapi derën. Gizi qëndronte përballë tij e veshur me pardesynë e saj ngjyrë kremi. Ai nuk ia dallonte dot tiparet e fytyrës dhe nuk dinte ç'qëndrim të mbante.

— Ç'është? — tha ai, duke bërë një hap prapa dhe duke shtrirë dorën e majtë me pëllëmbë të hapur për të kërkuar çelësin elektrik.

— Unë e prita më shumë se një orë në vendin e takimit, po ai nuk erdhi.

— Si! — tha ai i çuditur, i friksuar deri në panik dhe ndezi dritën elektrike.

— Me siguri Antonit i ka ndodhur ndonjë fatkeqësi, — tha ajo me buzët që i dridheshin.

Ai zgjati dorën dhe kapi dorën e saj të ftohtë akull. E tërhoqi drejt dhomës dhe e uli në kolltuk. Ajo nuk ishte në vete. Ambasadori u çapit deri te bufeja dhe nxori prej andej një shishe e dy gota.

I mbushi asaj njërën gotë dhe ia zgjati. Ajo e ktheu me fund. Ai ia mbushi përsëri dhe ia la mbi tavolinë. Pastaj, duke ndenjur përballë saj, po e vërente me shumë kujdes.

— Pa më shpjego edhe një herë me qetësi.

Ajo seç bëri një lëvizje të pakuptueshme me duar dhe nisi t'i tregonte:

— Ai u fut nëpër turmë... e kishim lënë të shiheshim pas një ore në sallën e hotel «Dajtit». Unë shëtita më shumë se një gjysmë ore dhe e prita një orë e gjysmë... ai nuk erdhi. Edhe këtu nuk e gjeta. Atij me siguri i ka ndodhur fatkeqësi. — Ajo mori gotën dhe e vuri në buzë, po shpejt e uli përsëri, sepse duart i dridheshin dhe nuk i bindeshin. Ndjeu t'i mblidhej në fytyrë ai lëmshi që nuk shkrihet veçse me lotë.

— Hëm, domethënë nuk erdhi... — tha ambasadori më shumë me vete dhe u ngrit e nisi të lëvizte nëpër dhomë. — Sikur me të vërtetë të ketë ndodhur ndonjë fatkeqësi, kjo do të jetë katastrofike edhe për mua. Ç'të bëj? T'u telefonoj autoriteteve shqiptare? Jo, — u përgjigj vetë aty për aty, i frikësuar nga ky mendim dhe i hodhi një sy orës. Njëmbëdhjetë. «Duhet pritur dhe ca. Ndoshta është në ndonjë lokal, ndoshta në ndonjë ambasadë tjetër, sepse ata batakçinj shkëmbejnë informacione midis tyre. Jo, jo, — mendonte ai gjithë ankth, nuk duhet të nxitohem. Çdo veprim i pamatur, çdo alarm i kotë do të na bënte lolo në sytë e botës».

— Duhet të presim, — i tha ai Gizit dhe u ul kundruall saj. Ai druhej ta shikonte në sy, sepse, nëse me të vërtetë kishte ndodhur fatkeqësi, atij i duhej të mbante qëndrim ndaj Antonit, dhe qën-

drimi do të ishte i rreptë. Këtë e kërkonte detyra e tij.

— Kjo është e tmerrshme, — tha Gizi me dënesë, — e tmerrshme, — përsëriti ajo dhe u shtri në kolltuk. I gjithë trupi u tendos si ndonjë shufër thane, shtrëngonte fort dorezat e kolltukut, aq, sa duart iu zbardhën, përplaste fort kokën pas kolltukut dhe pas pak nga buzët nisi t'i dilte shkumë. Fytyra e saj mori një ngjyrë trëndafili, pastaj gradualisht po nxihej. Po kalonte një krizë histerie.

Ambasadori mbeti i tmerruar. Donte të lëvizte nga vendi e s'mundej. I dukej vetja si në një nga ato ëndrrat kur dëshiron të vraposh, të largohesh nga diçka e ligë, e tmerrshme, ireale dhe nuk mundesh e rrezikohesh nga çasti në çast të bëhesh pre e saj. Më në fund, doli nga ajo gjendje dhe nxitoi në kuzhinë për të marrë ujë. Atje përplasi fort një gotë që u thye me një krismë therëse dhe vrapoi përsëri për në dhomë. Ia hodhi Gizit të gjithë ujin në fytyrë dhe pas pak ndodhi mrekullia. Muskujt iu liruan, trupi iu bë si i qullët, dhe ajo uli kokën mbi tavolinë.

— Më falni, — tha ajo pas pak, — më falni, — përsëriti pa e shikuar në sy, me turp. Rregulloi fustanin që i qe ngjitur shumë lart mbi gjunjë dhe ndjeu shikimin e dikujt tjetër mbi të. Ishte e shoqja e ambasadorit. Me pizhama, me skufjen në kokë, pa tualet, ajo dukej e neveritshme.

— Ç'po ndodh këtu? — pyeti ajo kërcënueshëm, kur hyri brenda në dhomë.

Ambasadori ngriti sytë drejt saj.

— Antoni nuk është kthyer ende, — tha ai duke kthyer gotën me fund. — Gizi sapo kaloi një krizë. Qëndro me të. — Ai u ngrit dhe shkoi nga

dhoma tjetër. Pas pak u kthye i veshur e i krehur me kujdes.

— Me siguri e kanë kapur, — tha ajo me vështrimin të mbërthyer diku, — jetojmë në një vend të çuditshëm, të tmerrshëm. Të mjerët ne!

— Lëri këto, mjaft me këto, — tha ai dhe i hipi gjaku në kokë. — Nuk mjaftojnë telashet që kemi, po duhet të dëgjojmë dhe konkluzionet e tua. — Ai i tha hapur mendimet e tij për të shoqen. Fundja, Gizit ai nuk mund t'i mbante asgjë të fshehtë.

— Më zgjoi gota, — tha ajo, duke treguar kështu se e kuptonte që ishte e tepërt në atë bisedë dhe u ngrit e doli nga dhoma, ashtu e thatë si një cironkë.

37.

Pasi i bënë një kontroll të imtë, Antonin e lanë në dhomën e pritjes. Te dera qëndronte një civil me trup atleti. Antoni rrinte ulur në kolltuk dhe nuk po mësohej dot aspak me këtë gjendje. Ai e dinte mirë praktikën ndërkombëtare dhe ishte i sigurt se do ta lironin, e dinte mirë edhe praktikën që kishin ndjekur shqiptarët në raste të ngjashme. Fundja, do të shpallej «non grata» dhe do t'i jepnin një afat. Mirëpo kjo do të ndodhte pasi të nënshkruante një protokoll. Por ai nuk e kishte këtua hallin. E gjithë puna qëndronte te dokumentet komprometuese që i gjetën me vete dhe që ranë në dorë të kundërzbulimit shqiptar. Ato ishin diskredituese për shtetin e tij. Po përse po vonoheshin autoritetet shqiptare, përse nuk po e merrnin në pyetje?

Ai nxori paqetën, po në çast u kujtua se çak-

makun, ngaqë qe edhe aparat fotografik, ia kishin marrë. Antoni i bëri një shenjë civilit. Ky nuk u përgjigj, por dikujt i foli. Erdhi një burrë i thinjur me një trup të imtë dhe i ndezi cigaren.

Antonit iu kujtuan përsëri materialet komprometuese. Ai e kishte nënshkruar pa hezitur procesverbalin e kontrollit personal. Në të ishte përshkruar me shumë hollësi çdo gjë. «Si më ndodhi kjo?» — mendoi për të parën herë që nga koha e arrestimit. — Mos vallë «Kafeja» ma ka punuar dhe më ka ngritur një kurth? Jo, — kundërshtoi aty për aty, — «Kafeja» është komprometuar plotësisht. Fundja, këtu nuk është fjala vetëm për një rekrutim teknik, por për një rekrutim ideologjik. Ai u thye në mendimet e tij, në botëkuptimin e tij. Atëherë ç'është kjo që ndodhi? Me siguri, një incident, një rastësi, si të gjitha rastësitë. Por a më lejohet mua të mendoj për rastësi, qoftë edhe në këto rrethana? Ja dhe kundërzbulimi shqiptar, që unë e nënçmova aq tepër! Si ta marr vesh të vërtetën për këtë ngjarje? Për mua kjo ka shumë rëndësi. Fundja, duhen nxjerrë konkluzione për të ardhmen. Do të më duhet të bëj një raport edhe për hetimin që do të bëhet rreth meje».

Antoni u mbështet në kolltuk dhe e ndjeu veten si më të lirë. «Po Gizi! — i shkrepëtiu atij papritur, — Ç'bëhet me të?! Edhe ajo do ta pësojë për shkakun tim. Kushedi sa më ka pritur, kushedi sa është shqetësuar dhe...»

Fillin e mendimeve ia ndërpreu dera që u hap. Ai civilin me trup të imtë e ftoi t'i shkonte pas. Prapa Antonit ecte civilin tjetër me trup atleti. Këmbët mezi i bindeshin. E futën në një dhomë të mobiluar fare thjesht dhe i thanë të ulej në një karrige. E lanë

vetëm për një çast. Në korridor u ndien hapa. Pas pak u hap dera dhe Antoni nuk e përmbajti dot kureshtjen për të parë hetuesin e tij. Ktheu kokën si rastësisht. Te dera qëndronte një burrë i gjatë, mbi një e tetëdhjetë, me trup të drejtë si fidan. Në flokët e krehur me kujdes i spikatnin dendur fije të bardha. Antoni u ngrit instinktivisht në këmbë.

— Uluni, — i tha frëngjisht hetuesi dhe, si mbylli derën, erdhi e qëndroi përpara tij, në tavolinë. — Flisni frëngjisht? — e pyeti ai, duke vendosur çantën në anën e djathtë.

— Me vështirësi, — u përgjigj Antoni pa ia ndarë shikimin. Edhe hetuesi nuk ishte kundër që të zhvillonin një luftë të heshtur, sy më sy. Antoni vërente me kujdes sytë e zinj, nën vetullat e zeza, të dendura e harkore. Pastaj shikimi i tij zbriti nga balli i lartë e i gjerë te buzët, te mjekra e dalë pak përpara me një gropëz të vogël.

— Mos flisni më mirë rusisht? — pyeti tjetri me një ruishte të pastër.

Antoni pohoi me kokë.

— Le të bisedojmë, qoftë edhe rusisht, — tha hetuesi duke nxjerrë nga çanta ca letra të bardha. Midis tyre Antoni njohu procesverbalin e kontrollit personal.

— A nuk do të ishte më mirë të njoftohej ambasada ime, sepse ju e dini që unë kam imunitet diplomatik dhe e konsideroj të paligjshëm ndalimin tim, — u hodh në sulm Antoni.

— Këtu nuk është fjala për një ndalim. Po bëjmë thjesht një anketë. Dëshiroj të tërheq vëmendjen tuaj që në fillim se jemi përpara një rasti flagrant. Kjo na jep mundësi ligjore të plota.

Antoni e kuptoi fare mirë dështimin e manovrës së tij.

— Megjithatë, — vazhdoi hetuesi qetësisht, — ne kemi njoftuar për këtë ngjarje atje ku duhet. — Ai ngriti receptorin dhe tha shkurt: — Le të vijmë, — pastaj vazhdoi: — Por kjo varet ca edhe nga qëndrimi juaj. Ç'mund të na thoni rreth këtij fakti?

— Përse interesoheni?

— Për gjithçka që ka të bëjë me këtë takim konspirativ me një qytetar shqiptar.

— Është fjala, në të vërtetë, për një përpjekje nga ana ime. Thjesht një përpjekje në fazën më fillestare, më kuptoni.

— Ju kuptoj, po nuk jam aspak dakord me ju. Këtë e përgënjeshtrojnë informacioni që kishit në xhep nga agjenti me pseudonimin «Kafeja». Pra, nuk është fjala për fazën fillestare. Si thoni? — Shikimi i hetuesit ishte disi ironik. Ai ndiqte me kujdes taktikën e kundërshtarit dhe kapej fort pas thënieve të tij kontradiktore.

— Përgjithësisht arsyetoni drejt, por mendoj se informacioni që m'u gjet, nuk do të thotë se rrjedh nga ai njeri me të cilin më kapët.

— Ekspertët tanë e provuan këtë. Konkluzioni i tyre është kategorik. — Hetuesi u drejtua në karrige dhe i zgjati një cigare. Pastaj, duke vendosur dy pëllëmbët e duarve mbi mjekër, e pa me ata sytë e tij të zjarrtë për një kohë të gjatë. Antoni uli sytë. — A nuk do që më mirë të flisni më hapur? Natyrisht është tepër e vështirë pozita juaj e kjo vjen pikërisht nga faktet që kemi në dorë. Është fjala për spiunazh në kuptimin më klasik të fjalës. — Hetuesi heshti një hop, për të parë si do të reagoje

Antoni, pastaj vazhdoi: — Më duket se po ju flas fare hapur.

Antoni thithi cigaren. Dora iu drodh pak. «I zgjuar, — mendoi, — i zgjuar dhe tepër djallëzor. O zot! Si u katandisa kështu, si një nxënës, si një fillestar».

— Po, ju keni të drejtë, veçse desha t'ju bëj një pyetje të hapur...

— Mos po më propozoni të ndërrojmë rolet? — e ndërpreu hetuesi disi vrazhdë.

— Nuk është fjala aty, po kam të drejtë të bëj një pyetje të hapur dhe shpresoj në një përgjigje të sigurtë: mos më tradhtoi ai?

— Qetësohuni. Ai që tradhton atdheun e tij mund të tradhtojë këdo. Kjo nuk përbën asgjë shqetësuese.

— E qartë. Le të bisedojmë konkretisht, por dëshiroj t'ju kujtoj se jam njeri familjar.

— Vërejtje me vend, — tha hetuesi, duke bërë një shenjë nga dera. Ajo u hap dhe hynë brenda dy vetë. Antoni njohu një kolegun e tij të ambasadës dhe një përfaqësues të Ministrisë së Jashtme shqiptare. Ata zunë vend.

— Le të vazhdojmë, — i tha hetuesi Antonit.

Antoni lëvizi pak në karrige.

38.

Dera e dhomës u hap dhe brenda hyri mjeku, veshur me bluzë të bardhë dhe me një çantë në dorë. Ai ndenji një çast te dera pastaj u afrua pranë

Mistos. Ky nuk lëvizi nga vendi. Ishte në një gjendje të tillë paralize, saqë nuk e ndiente veten. Mjeku nisi t'i shikonte ballin që ia kishin lidhur dosido për t'i ndërprerë gjakun. Mistoja nuk ndiente asnjë dhembje. Pastaj mjeku i ngriti pak flokët që e pengonin dhe iu duk se diku e kishte parë atë fytyrë.

— Asgjë, — tha ai me zë të lartë, pa iu drejtuar njeriu. — Gjendje e mirë.

— Ndihem i mpirë, — pëshpëriti Mistoja, më shumë me vete.

— Do t'ju kalojë!

Mjeku u ngrit, shënoi diçka në një recetë dhe ia dha oficerit të rojes. Ai doli duke i hedhur një shikim kalimthi të arrestuarit tjetër, i cili ndoqi me vëmendje, por pa u ndier, gjithçka që ndodhte në atë dhomë të vogël. Mistoja ndenji shesh. Mbylli sytë dhe u mundua të kujtonte çastin e arrestimit. Në vesh akoma i ushtonin fjalët «Ne me bukë e ti me gurë». Çudi, si kishte ndodhur gjithë kjo? U mendua për një çast, pastaj tha me vete se kjo që një ngjarje krejt e rastit. «Jo, ata nuk mund të kenë asnjë të dhënë për mua. Fundja, ata më trajtuan mirë edhe pas incidentit me doganën tre vjet më parë, edhe pas ndarjes me Orjetën. . . Ku mund të jetë ajo tani? A e ka marrë vesh? Sigurisht jo. Ç'gjendje e papëlqyer. Pra, ata më hodhën në dorë krejt rastësisht. . . Me siguri rashë në kurth për shkak të Antonit. Këta e kanë ndjekur atë, dhe unë jam viktimë e tij». Mistoja e vendosi aty për aty: asnjë fjalë, asnjë pohim. «Vetëm kështu do t'u tregoj këtyre se ky që një takim i rastit atje në kodër. Po Antoni? Mos vallë ai ka treguar gjë? Jo, s'është e

mundur! Antoni nuk ka ç'të humbasë në këtë rast. Gjëja më e madhe për të është largimi nga Shqipëria. Punë e madhe!».

Truri i topitur nisi t'i punonte si në ethe. Dëshira për të jetuar, për t'u mbrojtur me thonj e me dhëmbë, për të dalë me çdo kusht prej këtij vendi iu ndez dhe po e përvëlonte. U ngrit në këmbë dhe lëvizi me çap tashmë të sigurt nëpër dhomë.

I arrestuari tjetër e shikonte pa i folur. Ai njeri i ngjallte neveri. Qe veshur mjaft keq dhe, i kruspullosur atje në qoshe, dukej si një qenie krejt pa jetë. «Me siguri, ndonjë hajdut ose ndonjë vrasës», — mendoi Mistoja. Por sytë e këtij njeriu ishin çuditërisht të qartë, të fortë e të përqëndruar. «Shikim karakteristik i një njeriu pa cipë», — mendoi përsëri Mistoja dhe vazhdoi lëvizjet nëpër dhomë. I pihej ujë. Shikoi nëpër dhomë dhe në qoshe pa një gotë alumini. U afrua, e mori në dorë. I erdhi krupë. «I shkreti njeri!», — mendoi Mistoja duke kërcëllitur dhëmbët. Në atë çast ai kishte një urrejtje të jashtëzakonshme, shtazarake ndaj gjithkujt që e kishte prurë këtu.

— Me këto gota pihet ujë? — e pyeti të dënuarin tjetër.

— Mos do ndonjë gotë floriri? — e thumboi tjetri.

Mistoja i ktheu kurrizin dhe, duke pirë ujë, mendoi: «Ç'kafshë!» E la gotën përsëri te qoshja. — Humba! — tha me zë të ulët, — humba gjithçka, — dhe aq s'e përmbante dot veten, sa nisi të griste këmishën e t'i binte kokës me grushta. I arrestuari tjetër u ngrit ngadalë, iu afrua me çap të kujdesshëm, e mbërtheu me të dyja duart dhe e shtriu në krevat.

— Qetësohu, — i tha ai me po atë notë përbuzjeje që i kishte folur më parë. — Kështu është në fillim. Do të mësohesh. Unë për vete e kam për të tretën herë. Jam i pandreqshëm. Më hanë duart, — tha ai, duke u ulur në cep të krevatit, — dhe nuk rri dot pa vjedhur. Edhe punë më gjetën, edhe mirë më trajtonte kolektivi, edhe shtëpi më dhanë, por s'vura mend.

Mistoja u qetësua disi. Mbylli sytë për të mos shkëmbyer asnjë fjalë me këtë njeri që e përcaktoi pa gabuar se ishte vjedhës.

— Po ty përse të kanë futur, — e pyeti tjetri, që e uli zërin dhe u përkul mbi të.

Mistoja nuk u përgjigj dhe nuk i hapi sytë fare.

— Me siguri për politikë, — tha tjetri, që priti më kot përgjigje për një kohë të gjatë. — Ju të politikës jeni budallenj të mëdhenj, s'ka më budallenj se ju. Mendoni se do ta përmbysni pushtetin popullor. Ehu, sa ka parë ky pushtet si ju! Në krahasim me ju, këto mëkatet që bëjmë ne janë hiçgjë. Ne jemi. . .

— Që të dy palët një lloj jeni, — tha roja që e kishte hapur derën pa u ndier. — Ti, — tha ai duke iu drejtuar Mistos, — eja me mua.

Mistoja u nis pas tij. Në kushte të tjera ai nuk do t'i hidhte as sytë këtij njeriu që mbante veshur uniformën blu të policit. Polici qëndroi te një derë.

— Futu brenda!

Georgi e mori vesh katastrofën e Antonit në mesnatë, kur e thirrën me urgjencë në drejtorinë e zbulimit. Kishte ardhur një informacion direkt me teleshkrues. Drejtori qe bërë bishë. Te dera e zyrës së tij Georgi u ndesh me shefin, që nuk guxonte të hynte brenda. Për një kohë të gjatë ata i mbërthyen vështrimin njëri-tjetrit dhe u morën vesh midis tyre: duhet të ishin të bashkuar në këtë futunë. Georgi trokiti. Kur dëgjoi t'i thoshin «hyr!», i hapi rrugën shefit dhe vetë u fut pas tij.

Drejtori u zgjati informacionin. Ata e lexuan me një frymë, por, sikur të mos kishin kuptuar asgjë, aq e pabesueshme iu duk, pa guxuar të ngri- nin as kokën, nisën ta lexonin edhe një herë.

— Është sjellë si diletant, ai idiot, — tha drej- tori me zë të lartë. — Shqiptarët na dhanë një go- ditje të tmerrshme. Ja dhe fryti i punës suaj «të zgjuar».

«Filloi, — mendoj Georgi me vete, — ai nuk merr pjesë në këtë punë, e gjithë barra do të bje- rë mbi ne». Dhe u kujtua se atëherë kur përfun- doi rekrutimi i «Kafesë», drejtori kishte thënë: «Kon- kluzionet e mia u vërtetuan në praktikë. Ju lumtë, djema! Ja, kështu duhet punuar». Ndërsa tani u shmang me marifet. Georgi nuk u ndje. Përvoja e kishte mësuar ta linte stuhinë të kalonte, por pa e rrë- zuar, dhe kjo do të thoshte që goditja nuk qe aq e fortë e ata akoma mund të qëndronin.

— Kush e lejoi atë idiot të merrte me vete material komprometues? Flisni, ju pyes unë. Kush e dubloi fragmentin e shiritit?

Georgi e kishte bërë vetë dublimin, sipas një anëshkrimi të vënë nga drejtori me kërkesën e Antonit, por ai nuk mund ta thoshte këtë. Kjo duhej shfrytëzuar më vonë, me shumë mençuri. Për çdo rast ai e kishte fotokopjuar atë dokument, sepse e dinte që drejtori mbante një kopje të çelësit të kafortës së tij dhe mund ta zhdukte.

— Ne e kuptojmë që nuk i shpëtojmë dot përgjegjësisë nga ky skandal, — nisi të fliste qetë-qetë Georgi, — por veprimi i Antonit ka qenë tepër naiv. Ai nuk ka zbatuar asnjë nga porositë që i dhate personalisht, se si ta takonte këtë agjent. Unë i kam fjalë për fjalë në bllok porositë tuaja, — gënjeu hapur Georgi.

Drejtori mori kutinë e purove, e ndezi për vetë dhe u zgjati edhe atyre nga një.

— Uluni, — tha ai, duke u rehatuar në kolltuk. — Ky dështim është i tmerrshëm, është incident shumë i rëndë, me përpjesëtime të mëdha. Ç'mendoni ju?

— Mos ndoshta dhe ne duhet t'u përgjigjemi në të njëjtën mënyrë? — pyeti shefi i Georgit, që e kishte mbledhur veten.

— Ç'thoni, — u nxeh gjenerali nga ky propozim idiot. — Kush do ta besojë këtë?! Aq më tepër që ne nuk kemi asnjë fakt për punonjësit e ambasadës shqiptare.

— Le t'u krijojmë, — guxoi të thoshte shefi.

— Lëri këto dhe mendohu mirë para se të flasësh. Gjyko më me zgjuarsi. Ky do të ishte një tjetër gabim nga ana jonë.

— Mua më duket se do të ishte e domosdoshme të shqyrtonim ku qëndrojnë gabimet tona dhe të

marrim ndonjë masë, hëpërhë te ne, pastaj të mendojmë për në Shqipëri, — tha Georgi me atë gjakftohtësinë e tij karakteristike.

Drejtori i mbërtheu shikimin dhe thellë në shpirtin e tij u ndje i gëzuar. «E qartë, — mendoj ai me vete, — ky kërkon shkaktarët, por jo këtu, midis nesh. Spostimi i problemit, ja rrugëzgjdhja».

— Mirë Georg, — tha rëndë-rëndë drejtori, — mendimi yt ka vlerë. Studjoje me kujdes çështjen dhe më raporto personalisht. — Këto fjalë i ranë si bombë shefit të Georgit. Kjo do të thoshte se viktima mund të ishte dhe ai vetë.

— Duhet menduar për zëvendësimin e Antonit, — mori pak kurajë Georgi, duke hedhur në fillim vështrimin nga drejtori, pastaj e ndaloi mbi fytyrën e shefit. — Tashmë në Shqipëri duhet dërguar një njeri tepër i kujdesshëm.

— Le të dërgojmë atë që kemi në Moskë, — tha shefi me nxitim, sepse e kuptonte ku rrihte çekani. Ai shikoi nga Georgi në mënyrë të tillë, sikur donte t'i thoshte: «të lutem, mbaje premtimin tënd, të bashkuar asgjë e keqe nuk na gjen». Por shikimi i Georgit ishte tepër i turbullt, pa mendim.

— Ai është specializuar vetëm për vodkë, — tha me ironi drejtori. — Këtë çështje do ta zgjidh vetë. Antoni do të vijë pasnesër, parashikoj unë. Të mbahet në arrest, do ta pyes unë vetë. Kup-tuat?

— Si urdhëroni, — u përgjigjën ata njëzëri, duke u ngritur në këmbë. Takimi kishte marrë fund.

Erikoja u shqetësua shumë kur dëgjoji trokitjen në derë dhe shkoi menjëherë te telefoni. Dy ditë më parë i kishte ndodhur diçka e tmerrshme. . .

...Ndërsa po lexonte gazetën, dëgjoji një krismë arme shumë afër dhe ndjeu vërshëllimën e plumbit pranë veshit. Plumbi shpoi gazetën dhe u ngul në gardërobë. Ai u shtri përdhe pa ndjenja. Në shtëpi qe fare vetëm. Pas një copë here, si u qetësua pak, u zvarrit deri te telefoni dhe formoi numrin. Menjëherë erdhën dy policë dhe një civil për ndjekjen e krimeve. Pasi studjuan çdo gjë me kujdes, e këshilluan të qëndronte me dritë fikur. Që nga ky çast ai kaloi një gjendje alarmi, një torturë të vërtetë shpirtërore. «Ç'të ishte kjo? Kush qe ky njeri që donte të më vriste?» Por Erikoja ishte krejtësisht i pafuqishëm t'u jepte udhë këtyre pyetjeve. . .

— Mos u frikësoni, — u përgjigj zëri në telefon, — janë njerëzit e mi.

Erikoja shkoi i qetë te dera. Polici hyri brenda pa folur.

— Kam një urdhër për t'ju komunikuar, — tha ai dhe nxori bllokun nga xhepi. — Nesër në orën shtatë të mëngjesit do të ngarkoni plaçkat. Makinën, hamallin dhe gjithçka të nevojshme i marrim përsipër ne. Kjo është e domosdoshme për sigurimin tuaj. Afati është i përcaktuar. Do të kujdesemi për punë e për strehim, — përfundoi polici.

Erikos kjo i ra krejt papritur. Megjithatë guxoi të bënte një vërejtje.

— Përse nuk e gjen policia fajtorin, ç'faj kam unë? Kjo është shkelje e kushtetutës, e të drejtave të mia si shtetas.

Polici e pa me ironi.

— Është e mbështetur në kushtetutë, është fjalla pikërisht për sigurimin e jetës suaj. Policia i njeh mirë ligjet. Nesër në orën shtatë.

Kur polici u largua, Erikoja mbeti ashtu si i ngrirë në mes të dhomës, i pafuqishëm për asgjë.

Ca më vonë e ndjeu veten më të qetë dhe filloi të arsyetonte me gjakftohtësi, por, sado që u mundua, nuk e gjente dot shkakun e kësaj ndodhie. Papritur një mendim i mirë feksi në trurin që kishite nisur të punonte si në ethe. Atij iu kujtua Georgi dhe mori vrull për te telefoni. Që nga çasti që i ndodhi ajo gjëmë, ai kishte dashur disa herë të lidhej me të, të kërkonte ndihmën e tij, por gjithnjë i dilte një zë monoton dhe i zvargur gruaje, që i shprehte keqardhjen që Georgi nuk ndodhej në zyrë. Edhe tani, po ai zë gruaje dhe po ajo përgjigje. Erikoja u ul përsëri në kanape i dërrmuar. Përse nuk përgjigjej Georgi? Dhe nisi edhe një herë kërkimet e lodhshme për të gjetur shkakun. Më në fund, arsyetimi i tij u ndal në një pikë, të cilën nuk donte t'ia mohonte as vetes...

Njëherë, natën, e kishin thirrur me urgjencë dhe e kishin porositur të shkonte në ambasadën shqiptare. Aty duhej të bënte çmos të shikonte disa fotografi të dy shqiptarëve, me të cilët nuk kishte mundur të njihej. Kështu, që të nesërmen, në një orë të përshtatshme, shkoi të takohej me Femiun, atë njeri të urtë e gojëmbël. Por që nga ai takim Femiun i qëndronte disi ftohtë, pa atë përzemërsinë e dikurshme. Duke kujtuar atë ngjarje me hollësi, nisi të bindej gjithnjë e më shumë se këtu e jo gjetkë duhej të kishte ngritur themelet fatkeqësia e tij.

Të nesërmen plaçkat e tij i ngarkuan në makinë me një shpejtësi të habitshme. Sikur policia të vepronte me po këtë përpikmëri, me siguri që do ta kishte gjetur fajtorin. Rrugës makina u kryqëzua me një veturë ngjyrëblu. Brenda ishte Georgi. Ai manovroi me shpejtësi dhe në pasqyrën e krahut të tij pa si i humbi nga sytë makina me gjithë ngarkesën. Ai buzëqeshi dhe, pa ulur shpejtësinë, ndezi një cigare, mjaft i kënaqur.

Në plazh ndaloi dhe ndenji një copë herë duke kundruar ujin duke thithur me gjithë mushkëritë ajrin e pastër me një erë të lehtë leshterikësh. Plazhi ishte i qetë, pa gjallërinë e zakonshme. Ai pa orën dhe, i shqetësuar, hodhi shikimin nga rruga e stacionit, po Eva s'po dukej. Ndezi dhe një cigare tjetër. Pas krahëve ndjeu zhurmën e rërës së imtë dhe ktheu kokën. Eva, e bukur si gjithnjë, i buzëqeshi në atë mënyrën e saj fëmijnore.

— Ky nuk ngjet si një takim pune, siç m'u zotuat në telefon, — tha ajo duke i zgjatur dorën, — ju jeni veshur kaq me gusto, saqë po më lini të dyshoj.

— Përse? — tha ai, duke e kapur me dorën tjetër mbi bërryl. Llëra e saj ishte e plotë dhe ai ndjeu ngrohtësinë e trupit të saj.

— Nuk di si ta shpjegoj, — u përgjigj ajo dhe iu drodhën flegrat e hundës.

— Ju ftova të kalojmë bashkë një mbasdite, — tha Georgi dhe ia zbriti dorën te beli. — Më duket se nuk jam sjellë mirë me ju.

— Unë thashë se mos kishte ardhur ai «miku» im, — tha ajo, duke theksuar fort dy fjalët e fundit.

Georgi qeshi, dhe u nisën drejt veturës.

— Por unë nuk kam marrë me vete rrobat e banjës, — tha ajo.

— Këtë unë e dija, — tha Georgi dhe buzëqeshi ëmbël.

Ajo e kuptoi dhe nuk kundërshtoi.

...Të nesërmen, në rubrikën e krimeve në gazetë, Georgit i zuri syri një shënim:

«Natën u gjet trupi i një vajze...»

dhe pasi e lexoi deri në fund, u nis pa humor për t'i raportuar drejtorit.

41.

— Ç'ndodhi me ju? — Këtë pyetje hetuesi e hodhi si rastësisht, por, nëpërmjet saj, ai do të ecte drejt një qëllimi të caktuar: drejt demaskimit të plotë të të pandehurit.

Mistoja i kishte qepur vështrimin e turbullt, dhe e gjithë frika që i ishte grumbulluar për kontaktin e parë me hetuesin, u davarit e humbi pa gjurmë. Ai lëpiu lehtë buzët e thara nga emocionet dhe, që të çlodhte pak shpatullat, që i dukeshin sikur kishin mbajtur një peshë të rëndë përsipër, i mbështeti të dyja duart mbi tavolinë.

— Me mua ndodhi diçka e çuditshme, — nisi të shpjegonte ai, duke ndier një si gëzim të brendshëm, sepse në fytyrën e hetuesit pikasi një ndjenjë shumë njerëzore, — ndoshta një kockqiptim.

Hetuesi lëvizi kokën në shenjë miratimi.

— Po, po, ndodhin edhe të tilla... por çdo

gjë do të sqarohet. Vazhdoni dhe më falni që ju ndërpreva.

— Këto kohët e fundit kam qenë tepër i zënë me punë dhe m'u shpif një dhembje e fortë koke. Ilaçet nuk më bënë gjë ndërsa shëtitjet në ajër të pastër më qetësonin. Kam dalë, pra, shpesh mbas punës, për të shëtitur nëpër park. Mbrëmë, pikërisht në shëtitje e sipër, më ndaloi një person. E fliste shqipen me një akcent disi të huaj, këtë e kuptova mirë. Më kërkoi të ndizte cigaren. Kur bëra të largohesha, ai më thirri në emër. U çudita dhe e pashë më me kujdes. Më në fund e njoha që ishte diplomat i huaj, e kam parë në përbërjen e një delegacioni. . . Nisëm të shkëmbejmë një bisedë të zakonshme dhe, sapo doja të largohesha, na arrestuan. Me siguri, organeve kompetente u interesonte vetëm ai, i huaji, por. . . unë e di që s'kishte rrugë tjetër. . . atyre u duhej të më arrestonin edhe mua. T'ju them të drejtën, u shqetësova shumë, aq sa humba kontrollin e vetvetes dhe, nga dëshpërimi, desha t'i jepja fund jetës. Ju e kuptoni dhe vetë pozitën time, shoku hetues. Unë jam njeri i këtij pushteti. Kam qenë edhe për specializim jashtë shtetit, edhe në përbërje delegacionesh. Do të ishte absurditet të mendohej që unë kam qëllime të këqija. Por unë shpresoj se do të sqarohet çështja.

Mistoja përfundoi dhe i hodhi një shikim të përvuajtur hetuesit; atij nuk i qe zhdukur ende ajo shprehja tepër njerëzore nga fytyra.

Hetuesi e dëgjoi me vëmendje e me durim. Mistoja po ecte në rrugën e tij pa asnjë lëkundje; në qoftë se në atë zyrë do të ishte edhe një njeri tjetër që nuk dinte asgjë rreth veprimtarisë së tij, me siguri do t'u zinte besë atyre fjalëve.

Hetuesi i shkroi në procesverbal thëniet e të pandehurit dhe, si i lexoi me zë, i tha të firmoste. Pastaj në zyrë hyri polici.

— Merreni, — tha hetuesi.

Kur Mistoja po dilte, te dera ai e ndaloi.

— Sidoqoftë mendohuni, do të kemi edhe një takim tjetër, ndoshta ju kujtohet ndonjë gjë që mund të na ndihmojë për atë të huajin. Ai duhet demaskuar plotësisht.

Mistoja pohoi me kokë dhe shkoi pas policit.

«Ja, pra, — mendonte disi i gëzuar, — u vërtetuan supozimet e mia. Këta ranë rastësisht tek unë, nuk më kanë ndjekur... kanë për të më liruar shpejt... Dhe di unë pastaj si të veprojmë...» Në dhomë ndeshi vështrimin e ndezur të të arrestuarit ordiner.

— Të shoh në humor, — i tha ai, sapo u mbyll dera.

— E pse të mos jem? Në jetë ndodhin plot keqkuptime. Më vjen keq që do të ndahem nga ti, — tha me një ironi të hapur Mistoja.

— Ndërsa mua nuk më vjen hiç keq. Ty të shkon më shumë ky rol. Si të durojnë ty përjashta, si të duron... gruaja?

Mistos iu kujtua Orjeta, ndaj e pa atë me urrejtje dhe mendoi me vete: «Ç'të jetë ky njeri? Vërtet bëj përshtypje kaq të keqe me sjelljet dhe paraqitjen time?» Këto mendime nuk iu ndanë deri natën vonë. Gjumin e bëri me copa, që një gjumë i shqetësuar, dhe i pihej shumë ujë, por ajo gota e aluminit i ngjallte neveri.

— Ç'thotë «i verbri»? — pyeti Lulëzimi duke buzëqeshur me çiltërsi.

Hetuesi nuk i dha përgjigje menjëherë. Ai shikonte diku gjetkë, por mendonte për Lulëzimin. «Ja, pra, — mendoj ai me vete, — Lulëzimi ynë dhe Mistoja janë gati të një moshe, të rritur në të njëjtat kushte, por kanë formim të kundërt, qëndrojnë në dy barrikada të kundërta». Duke studjuar dosjen që i kishte dhënë Lulëzimi, duke parë me kujdes ato prova të grumbulluara me aq kujdes e mençuri, atij i bëhej zemra mal për këtë djalë...

Iu kujtuan pastaj me radhë Iliri, Femi, Orjeta, doganieri plak, Kiçoja... «Ja ç'ka edukuar Partia!»

— Mirë venë punët, shumë mirë. Por neve na duhet që «të verbrit» t'i provojmë se është «Kafeja» e botës, të bëjmë një anatomi të plotë të tij, në mënyrë që të nxjerrim shkaqet që e shtynë në këtë rrugë të poshtër. Edhe për vetë atë ka rëndësi të kuptojë çfarë i ka ndodhur.

— Si qëndron në hetuesi? — donte të dinte Lulëzimi.

— Hëpërhë luan rolin e të paditurit, por nuk i shkon. Kjo përbën bazën për të kaluar në një fazë të re. Do të gjej çastin kur i duhet dhënë goditja e parë.

— Çfarëdo që të dalë, më njoftoni, aq më tepër për detyrat që më duhet të kryej lidhur me deponimet e tij. Në raste të tilla, këto të drejtojnë në njerëz të tjerë që janë llum ose që kanë nisur rrëshqitjen drejt humnerës. Me këta njerëz duhet punuar me kujdes.

«Me pjekuri mendon, — tha me vete hetuesi — Me të tillë ndien krenari të punosh».

— Keni të drejtë, — tha ai me zë të lartë, — ne duhet të na shqetësojë në radhë të parë njeriu. Gjithë puna jonë duhet përqëndruar në parandalimin e hyrjes në rrugë të rrezikshme... Presioni i rrethimit është i madh, është tepër i rrezikshëm. Për ta përballuar, duhet qartësi ideologjike, duhet dhe guxim. Ka njerëz që nuk kanë bindje të shëndosha, që verbohen nga shkëlqimi i rremë i jetës në vendet borgjeze e revizioniste. Në fillim të tillë njerëz i fshehin me kujdes simptomat e sëmundjes së tyre, ashtu si pjesët e turpshme të trupit, por është e pamundur t'i shpëtojnë vigjilencës revolucionare të njerëzve tanë.

Lulëzimi dëgjonte me vëmendje...

43.

Antoni, pasi trokiti, hyri në zyrën e drejtorit dhe qëndroi pa lëvizur, derisa ai i tha të ulej. Këmbeu një vështrim të shpejtë me Georgin dhe e ndjeu se situata që normalizuar. Atë, pasi e kishin pyetur hollësisht dhe i kishin paraqitur edhe prova për fajësinë e tij, e kishin lëshuar.

Kur që larguar nga hetuesi shqiptar, Antoni kishite formuar bindjen e patundur, por vetëm për vete, se nuk kishin të bënin me një kundërzbulim naiv, ashtu siç flitej shpesh në degën e tyre të zbulimit, por me njerëz që e mbronin me zgjuarsia e trimëri të pashoqe Atdheun e tyre. Ato ditë shpesh pyeste veten: Ku dreqin e gjejnë tërë këtë forcë? A thua e gjejnë pikërisht në ideologjinë e tyre, siç trumbetojnë, apo mos vallë janë të pajisur me këto dhunti nga vetë natyra?».

Sidoqoftë Antoni nuk mundi ta zgjidhte dot këtë problem; në fund të fundit, kjo s'kishte asnjë rëndësi. Ata e kishin kapur në flagrancë, «e dogjën», dhe ai tani nuk do të shkelte më kurrë në atë vend. Veçse nuk mund ta harronte për asnjë çast korrektesën që kishin treguar në marrëdhëniet me të, pavarësisht nga raportet në të cilat ndodheshin. «Po qe se do t'i kishte ndodhur diçka analoge një shqiptari këtu te ne, me siguri do t'ia merrnin shpirtin. Por ata janë tepër të matur dhe duket se nuk kanë ndër mend t'i bien në qafë njeriu. Ata kanë vetëm një ideal, Atdheun e tyre, dhe preke po të duash!».

Antoni u kujtua se ndodhej në zyrën e drejtorit dhe i largoi këto mendime të çuditshme. Ngriti shikimin nga ai dhe priti. Por dukej se drejtori nuk kishte ndër mend të fliste. Ai diç bluante. Pastaj lëvizti pak në kolltuk dhe mori një puro. E ndezi dhe nisi të nënvizonte me një laps të kuq flamaster diçka që qe shkruar në një fletë letre të bardhë. Por duket nuk e kishte mendjen tek ato që lexonte. Ai qe kredhur në mendime: ç'duhej të bënte me Antonin? «Sa është hequr, — mendoj ai. . . vepronte me urdhrin tonë. Ky njeri tani është i lidhur më fort me ne dhe ka një përbërje të mirë. Edhe budalla nuk është. . . Në dosjen e tij ka karakteristika mjaft të mira. Kur ka qenë në kundërzbulim, është shquar në luftën kundër elementëve antiparti, kundër stalinistëve, ndaj. . . ky njeri nuk mund të flaket. Ai do të punojë më shumë në të ardhmen. Njerëz të tillë nuk gjenden aq lehtë». Papritur i lindi një mendim. Po sikur Antonin ta dërgonte përsëri në kundërzbulim? Por e kundërshtoi aty për aty. «Jo, — tha me vete, — do të dobësohej shumë dega e zbulimit

për Shqipërinë. Aq më tepër që dhe shefi i saj do të niset për të zëvendësuar Antonin. Le të punojë me Georgin. Ata duket se shkojnë mirë me njëri-tjetrin. Aq më tepër që tashmë skandali u mbyll.»

— Duhet të nxirrni mësim nga kjo ngjarje, — nisi të fliste ai duke vendosur në kuti gjysmën e puros që i ngeli. — Ne nuk po marrim ndonjë masë.

Në sytë e Antonit drejtori lexoi një shkëndijë shprese. Ai hodhi shikimin nga Georgi dhe vuri re se atij sapo iu shuan shkëndijat e një nënqeshjeje të sapoçelur.

— Veçse duhet të jesh i kujdesshëm dhe ta shlyesh me punë fajin tënd... gabimin tënd, — korrigjoi ai. — Për shkakun tënd Ministria e Jashtme e Shqipërisë ka bërë një notë të ashpër dhe ti e kupton që u servire një material shumë të pasur.

Drejtori heshti, ndërsa Antoni u ngrit në këmbë i mallëngjyer. E tërë qenia e tij tregonte besnikëri. Edhe Georgi heshti dhe mendoi se në këto çaste Antoni ishte i mbushur në të njëjtën kohë me dy ndjenja, me servilizmin ndaj eprorit dhe me egërsinë gjithnjë në rritje ndaj Shqipërisë. Që të dyja këto ndjenja ishin mjaft pozitive, dhe kjo ishte autokritika më e mirë që mund të bënte ai.

Pritja mori fund. Duke zbritur me ashensor, Antoni i shtrëngoi dorën fort Georgit.

— Të jam shumë mirënjohës. Sa t'i telefonoj Gizit dhe do shkojmë bashkë diku. Duhet festuar kjo ngjarje me të vërtetë jetike për mua.

Georgi lëvizi kokën në shenjë miratimi. Ai nuk mund të ishte kundër kësaj ideje që shkreppte rrallë në kokat e njerëzve të rrethit të tij, shumica e të cilëve ishin kopracë.

— Të shkuara të paharruara, — tha Georgi, duke ngritur për të dhjetën herë të njëjtën dolli.

Antoni ngriti gotën dhe shikoi në mënyrë të vagëlluar nga salla pak e ndriçuar dhe me mure të palyera kushedi prej sa kohësh. Ky lokal ishte tashmë i modës. Aty dëgjohej gjithnjë një organo e vjetër, nën tingujt e së cilës të dukej sikur ishte në kishë. Antonit gradualisht po i shlyheshin kujtimet e asaj jete pa zhurmë në Shqipëri dhe po mësohej gjithnjë e më shumë me erën e vendit të tij, me zhurmën, me xhazin... me...

— Të pimë për miqësinë, — i propozoi ai Georgit duke ngritur gotën.

— Të pimë, — tha Georgi, — por për miqësinë e vërtetë, në kuptimin më të ri të fjalës.

Antoni e ktheu gotën me fund, pastaj ndezi një cigare. Ai e kuptoi domethënien e fjalëve të Georgit. Sipas tij, kjo miqësi duhej kuptuar në një mënyrë të tillë që mos të të prekeshin interesat. Antoni s'kishte si të kundërshtonte. Fundja, edhe ai nuk qe kundër, veçse i duhej të përpiquej më tepër për të arritur hapin e të tjerëve sepse e kuptonte edhe vetë që kishte ngelur ca prapa.

Antoni e nguli shikimin te një njeri shtatlartë, që i kishte kthyer shpinën. Diçka i kujtonte ai njeri, ai qëndrim i drejtë i trupit, zhdërvjelltësia e tij, ajo tufë flokësh të verdhë të rrebeluar pas koke. Njeriu, sikur ta ndiente shikimin, u kthye në profil. Ai dikë kërkonte.

— Peter, — thirri Antoni, i habitur.

Tjetri ktheu kokën pak i hutuar, pastaj shikimi i

tij u çel dhe nga buzët shpërtheu një buzëqeshje prej babaxhani.

— Antoni?! — Edhe Peteri u habit. Pastaj u afrua e u përçafua me të.

— Po si je, Peter, si shkon, ç'thotë shkenca, — nxitoi ta pyeste Antoni.

Peteri i zgjati dorën Georgit pa dëshirë.

— Mirë, mirë, po ju si jeni? — Toni i tij ndryshoi papritur. Antoni e vuri re menjëherë.

«Ndryshojnë njerëzit, — mendoj ai me vete, — duhet treguar më tepër kujdes».

Peteri u përshëndet me ta dhe doli nga lokali me atë të ecurën e tij energjike. Antoni, sa për të thyer heshtjen, tha:

— E kam pasur shok në shkollën teknike, ishte një djalë me të vërtetë i talentuar.

— Ishte, — foli ashpër Georgi, — por s'është. Nguli këmbë të ikte nga instituti dhe tani punon diku si punëtor i thjeshtë në industri. Mendjefyçkë... dhe i shikonte ata dy shqiptarët si i përulur, si qen i zgjebosur.

«Shqiptarët» kujtoi Antoni. «Në dreq e kaluara, në dreq dhe Peteri...»

— Ta pimë për miqësinë, — propozoi edhe një herë Antoni.

45.

— U menduat? — pyeti hetuesi duke thyer kështu heshtjen.

— Megjithëse pata mjaft kohë, nuk kam ç't'ju them tjetër.

— Hëm, bëri hetuesi dhe u ngrit në këmbë.

Trupi i tij i gjatë iu duk Mistos sikur po e shtyp-te.

Mistoja nuk e ndiqte drejtpërdrejt, por me bisht të syrit. Ai qysh në fillim vuri re se hetuesi nuk qe me humor të mirë. «Të ketë zbuluar gjë? — mendoj Mistoja dhe nisi të kafshonte thoin e gishtit të vogël, zakon i fituar gjatë atyre ditëve. Nga ky mendim iu larguan gjithë shpresat që kishte. Megjithatë ai do të duronte e do të priste. Qe e pamundur të kishin ndonjë provë.

Hetuesi eci sa eci nëpër dhomë, pastaj ndaloi përpara të pandehurit. Mistoja ngriti kokën; sa shumë urrejtje vuri re në sytë e tij... Tani parashikonte furtunën.

— Domethënë ju nuk keni asgjë për të thënë! Kështu? — tha hetuesi dhe zuri vendin e vet. — Ti mendon se ne të kemi sjellë këtu drejt e nga rruga dhe se të gjitha ato që na thua janë fjala e fundit e arsyes.

— Më kuptoni, ju lutem, unë nuk di asgjë, por, po qe se ju keni diçka, më pyetni, — tha Mistoja me nxitim.

— Ne kemi dhe kemi shumë, përderisa të kemi sjellë këtu. Ja, na thoni: përse u takuat me atë diplomatit e huaj?

— Jua kam thënë. Ajo qe krejt e rastit.

— Edhe informacioni me pseudonimin «Kafeja» që i gjetëm diplomatit, është krejt e rastit?

— Unë nuk di asgjë, nuk njoh asnjë «Kafe».

— Po si shpjegohet që është shkruar nga ju?

— Kjo s'është e mundur. Ndoshta shkrimi im ngjet me të ndonjë tjetri...

— Dhe këtë e thotë një njeri që pretendon të jetë marrë me shkencë? — e ndërpreu hetuesi. — Flisni, — tha ai duke ulur tonin dhe duke i rënë me gisht tavolinës, — kjo gjë është provuar. Ne dimë më shumë se ç'mendoni ju. Mos harroni Antonin, ne biseduam me të.

Mistoja uli kokën. Kur kujtoi magnetofonin që kishte Antoni me vete, i hynë të dridhura. Ai e kishte dëgjuar edhe një herë atë bisedë të incizuar, e kishte dëgjuar në një nga ato takimet me Evën, kur Georgi me Antonin hynë befasisht në dhomën e tyre. Ai e dinte përmbajtjen e shiritave. «Me siguri, këta i kanë — mendoi me vete. Edhe sikur unë të mos them asnjë fjalë, po të dëgjojë shiritat, trupi gjykues do të më dënojë dhjetë herë me pushkatim». Dhe nisi të dridhej akoma më shumë, derisa e ndjeu veten krejt të pafuqishëm. «E tmerrshme dhe e turpshme, — mendoi Mistoja dhe ngriti sytë nga hetuesi, po atë po e shihte turbull; lotët i kishin mjegulluar shikimin, pastaj zunë t'i rridhnin faqeve.

Hetuesi, sa i pa lotët, ktheu kokën. I vinte ndohtë. Ai e kuptoi që tani Mistos do t'i kalonte një krizë e shëmtuar dhe pas kësaj ai do të kërkonte të hapej, të nxirrte tërë helmin e tij...

46.

— E kam të hekurosuar kostumin e ri, — e pyeti Iliri të shoqen, sapo vuri shishet e qumështit mbi tavolinë.

— Po. Ti më porosite që dje. Po ç'e do? — e pyeti ajo duke e shikuar me kërshtëri, se e dinte që ai nuk kishte ndonjë kujdes të veçantë për t'u veshur.

— Më duhet, — tha ai pa i dhënë ndonjë shpjegim dhe shkoi të rruhej.

Ilirit i kujtohej një nga ato ditët, kur punonte me sharrëxhinjtë. Ai e kishte stilografin dhe kish-te dalë në dritare. Jashtë frynte një erë e fortë që ngrinte nga toka një re të hollë bore dhe e ngjish-te rrëzë barakave. «Nën borën e portës fshihen plot gjëra, midis tyre edhe të papastra — kishte menduar, — dhe ja, duhet të fryjë me vrull kjo erë ose ta zerë dielli që ato të zbulohen». I kishte ardhur ky mendim sepse e dinte që pranë shtyllës elektrike ishte një gropë plehrash, tashmë e mbuluar nga bora. . .

— Të rri shumë bukur ky kostum, — i tha Diana, — të tregon si të mbështjellë me një vel misterioz.

— Jam thirrur në gjykatë, — u përgjigj ai, duke e kuptuar mirë pse i hodhi ato fjalë Diana.

— Pse, — tha ajo pa shqetësim, — çne ti në gjyq?

— Atje shkojnë të gjithë, kur është nevoja. Do të jem dëshmitar për çështjen e Mistos.

— Ah, të atij maskarait, — shau ajo, duke i lidhur shallin së bijës.

«Maskara! Mirë e tha Diana, — mendoi Iliri. — Ja pra, ç'ndodh në jetë, si zërthehet e konkretizohet ideja e luftës së klasave. Dhe unë e kam konsideruar atë si mik. Kushedi si do të jetë tallur ai në fillim me miopinë time. — Dhe iu kujtua se në ta-

kimin e fundit me Lulzimin i kishte thënë që për ta vënë në gjumë zbulimi i huaj kishte përdorur narkotikë. Kështu shpjegohej ai gjumi i pavullnetshëm i asaj nate në hotel, kur Mistoja që vënë në shërbim të të huajve...

Ata dolën të tre nga shtëpia. Dukej e bukur ajo ditë pranvere. Dielli sapo kishte filluar të dilte.

Iliri u nda me Dianën dhe vajzën e i hodhi një sy orës. Kishte edhe një orë kohë. I pihej një kafe...

Njerëzit lëviznin gjithkush në punë të vet. Ai që përfshirë nga vrulli e nga gazi që vihej re në fytyrat e tyre. Kur hyri në gjykatë, në sallën e pritjes vuri re shumë të njohur. I zgjati dorën Orjetës, Femiut dhe Kiços e ndenji në vendin që i hapën ata. Donte dhe dhjetë minuta të fillonte seanca. Ata vazhduan bisedën që kishin nisur, dhe Iliri u orientua shpejt. Kiçoja u fliste për hidrocentralin. Atëherë e kuptoi Iliri përse duart e tij ishin ashpërsuar...